

Universi i Jusufit a.s.



Nexhat Ibrahimimi



0 [U N I V E R S I T I J U S U F I T A - S -]

UNIVERSI I JUSUFIT A.S.

Nexhat Ibrahim

© L O G O S - A
2 0 0 8



S H K U P
P R I S H T I N Ě
T I R A N Ě

Nexhat Ibrahim

UNIVERSI I JUSUFIT A.S.

Boton: Logos-A

Biblioteka: Mendimi Islam

Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor gjuhësor: Rexhep Zllatku

Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi

Redaktor teknik: Afrim Gashi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

Shtypi: Focus - Shkup

Copyright©Logos-A, 2008

Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet në

Bibliotekën Kombëtare Universitare

ISBN 9989-58-282-3

www.logos-a.com.mk

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit

apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.

Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi

pa lejen paraprake të Logos-A.

UNIVERSI I JUSUFIT A.S.

Nexhat Ibrahimi



Përmbajtja:

Në vend të parathënies 7

Refleksion i shkurtër në kaptinën 'Jusuf' 13

Kaptina Jusuf është shpallur në Mekë 17

Hyrje në rrëfim 21

Ëndrra e Jusufit 25

Tragjedia si pasojë e komplotit

të vëllezërve të Jusufit 32

Hedhja e Jusufit në bunar 36

Jusufi shitet si skllëv në Egjipt 43

Bukuria e Jusufit dhe dredhia e Zulejhasë 48

Jusufi në burg fton në besim të vërtetë 60

Ëndrrat e Mbretit 67

Jusufi a.s. nga burgu në pallatin e mbretit 73

Vëllezërit e Jusufit në Egjipt 78

Vëllezërit e Jusufit a.s. e sjellin Benjaminin 83

Takimi i Jusufit a.s. me Benjaminin 85

Inskenimi i gotës së sunduesit të barra e Benjaminit –

Suva'ul-Melik 87

Jusufi zbulon identitetin e tij 93

<i>Këmisha e vërtetë e Jusufit dhe dija e Jakubit a.s.</i>	97
<i>Nga tragjedia në gëzim</i>	100
<i>Vdekja e Jusufit a.s.</i>	104
<i>V. Pashënie</i>	106
<i>VI. Shtojcë</i>	108
<i>Shtojca 1: Porositë nga kaptina Jusuf</i>	108
<i>Shtojca 2: Karakterizimi i personazhëve</i>	110
<i>Shtojca 3: Ndikimi i kaptinës kur'anore 'Jusuf' në kulturën dhe qytetërimin islam në hapësirën gjithëshqiptare</i>	112
<i>Shtojca 4: Tabela e të dhënave krahasuese në rrëfimin mbi Jusufin a.s.</i>	120
<i>Shtojca 5:</i>	125
<i>Përkthimi i sures Jusuf:</i>	134
<i>VII. Literatura</i>	147
<i>A. Literatura në gjuhën arabe:</i>	147
<i>B. Literatura në gjuhët joarabe:</i>	149
<i>VIII. Treguesi i emrave</i>	155

Në vend të parathënies

Falënderimet janë vetëm për All-llahun, Krijuesin e gjithësisë, Mëshiruesin e pashembullt, Dhuruesin e pashoq, Zotëruesin e Ditës së gjykimit; vetëm Atij i lutemi dhe vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë!

Paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi të dashurin tonë, Muhammedin a.s., familjen dhe shokët e tij, dhe mbi të gjithë besimtarët!

* * *

Kur'ani është fjalë e All-llahut të madhëruar, i dërguar si udhëzues absolut për njerëzit. Në të gjenden udhëzimet dhe përgëzimet më të mira, qortimet dhe shtegdaljet më të drejta. Kur'ani është fjalë e All-llahut të madhëruar që së pari duhet të lexohet, ajetet e tij të meditohet dhe të studiohet, dhe sipas tyre të veprohet. Çdo ajet, çdo sure është përplotë urtësi, përplotë margaritarë, që presin mendjen e njeriut dhe njëmendësimin e tij.

Nga një anë, Kur'ani duke shtruar pjesë nga fjalët dhe jeta e të dërguarve të All-llahut gjatë historisë, ofron urtësi dhe rrugë si të kuptohet e kaluara, si të jetohet e tashmja dhe si të mësohet për të ardhmen.

Një nga këta të dërguar është edhe Jusufi a.s. dhe jeta, meditimi, misioni dhe vepra e tij. Shembulli i Jusufit a.s. është një *univers* në vete, perlë e mirëfilltë që do të rrezatojë gjatë tërë historisë njerëzore.

Nga ana tjetër, edhe perëndimorët pajtohen se kriza epokale e kohës së re dhe moderne ka filluar me shkretërimin metafizik, me redukimin e njohjes së njeriut në shkallën më të ultë, me zbritjen e supra-unit në ultësi të unit. Si datë merret epoka e renesansës, e cila edhe pse celebrimet si epokë e orientimit drejt vetëvetes, paralajmëron “vdekjen e shumë gjerave”.¹ Në këtë periudhë filluan të zhduken dituritë tradicionale të Mesjetës, kurse galeritë të zëvendësojnë tempujt. Njeriu që me shekuj ka luftuar të lirohet nga autoriteti i të gjitha llojeve, në agimin e renesansës u rrënoqeth nga frika prej lirisë individuale, që e arriti në turma drunjësh.

Kriza e autoritetit solli me vete izolim, shumë risi dhe shumë (ideologj)izma, solli nepsin kulturor të Perëndimit dhe nepsin kanibalist për pushtet, shfrytëzim dhe dominim. Kjo krizë e kulturës është krizë e fuqisë së njeriut, si pasojë e shikimit të thjeshtësuar, të zhveshur mbi/në njeriun. Njeriu gjithnjë e më shumë po bëhet makinë, kurse gjithnjë e më pak qenie që don dhe dashuron. I paaftë ta dojë ambientin dhe jetën, vetveten dhe të tjerët, ai po e shkatërron atë. Ndoshta pika më e dobët e gjithë kësaj është pikërisht atje ku epshi është më intenziv, fusha e jetës intime, jetës seksuale. Këtë e thekson edhe Kur’ani në dialogun ndërmjet Krijuesit dhe shejtanit, duke e apostrofuuar sprovën seksuale si problemin më të shpeshtë dhe më të rreptë të njeriut në rrugën e dëgjueshmërisë

¹ Rene Genon, sipas: Dzermaludin Latic, Postperiod seksualne revolucije, në: *Etika u islamu*, Zbornik radova Treceg Simpozija 1410/1990, Zagreb, 1991, fq. 198.

ndaj Zotit të madhëruar.² Në këtë aktualitet konfuz, në këtë gjendje të rrëmujës dhe raskapitjes morale, sureja / kaptina Jusuf dhe pastërtia morale e personalitetit të Jusufit a.s. është shembulli më i mirë praktik dhe oferta më përmbajtësore për dalje nga kriza. Këtë e thekson edhe Kur'ani:

لَقَدْ كَانَ فِي يُوسُفَ وَإِخْوَتِهِ آيَاتٍ لِلْمُتَلَكِّينَ

"...Njëmend te Jusufi dhe vëllezërit e tij ka shenja (mësime) për ata që pyesin." (12, 7).

لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِأُولِي الْأَلْبَابِ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَى وَلَكِنْ تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ

"Në rrëfimet e tyre ka mësime për njerëzit e mençur. Kur'ani nuk është bisedë e trilluar, por është pohim i shpalljes që ishte më parë dhe shpjegim i çdo gjëje, dhe udhërrëfyes e mëshirë për popullin që beson." (12, 111).

Pajtohem me mendimin e Imam Vehbiut se kjo kaptinë te populi shqiptar ka nevojë të hulumtohet më tepër se kurrë, që të "ndikojë në nxjerrjen e popullit tonë nga pellgu në të cilin e kishte zhytur komunizmi enverian"³, do të thoshim në të cilin e kishte zhytur shekullarizmi dhe shekullarizimi i të gjitha fushave të jetës për një kohë të gjatë.

Kjo çështje ka motivuar shumë mendje të larta, shumë studiues dhe letrarë, shumë filozofë dhe sufi, shumë poetë dhe artistë. Ky është edhe motivi ynë

² Dz. Latic, *Postperiod ...*, op. cit., fq. 198 dhe 201.

³ Imam Vehbi Ismaili, *Jusufi i drejt*, botimi I, Michigan, USA, 1415-1994, fq. VI.

kryesor për shqyrtimin e kësaj sureje. Të vetëdijsëm se përpjekja jonë është vetëm një përpjekje modeste, një perceptim individual, i lutemi All-llahut për ndihmë dhe falje!

Prizren,
12. 06. 2006

Universi i Jusufit a.s.

- Refleksion i shkurtër në kaptinën 'Jusuf'
 - Kaptina Jusuf është shpallur në Mekë
 - Hyrje në rrëfim
 - Ëndrra e Jusufit
 - Tragjedia si pasojë e komplotit të vëllezërve të Jusufit
 - Hedhja e Jusufit në bunar

لَقَدْ كَانَ فِي يُوسُفَ وَإِخْوَتِهِ آيَاتٍ لِلِّسَّائِلِينَ

“Njëmend te Jusufi dhe vëllezërit e tij ka shenja (mësim) për ata që pyesin.”

(Kur'ani, Jusuf /12/: 7)

Refleksion i shkurtër në kaptinë 'Jusuf'

Kaptina e dymbëdhjetë e Kur'anit mbanë emrin e pejgamberit të Zotit, *Jusufit a.s.*, për të cilin Muhammedi a.s. pohon se është “pasardhësi fisnik i fisnikëve”.⁴

Kjo kaptinë kur'anore⁵ në shumë pikëpamje është e veçantë. Veçanësia e kaptinës mund të vërehet në disa rafshe Do të vërejmë se si Kur'ani thekson rrëfimet mbi pejgamberët, njerëzit, popujt; vërejmë se Kur'ani jep një pasqyrë të shkurtër apo një shkëputje nga jeta e ndonjë pejgamberi, që kjo të ndërpritet për të vazhduar në ndonjë kaptinë tjetër apo në ndonjë kontekst tjetër. Në këtë mënyrë Kur'ani na ofron shumë aspekte të një njëmendësie, duke lundruar me ne kështu nëpër *universin e rrëfimeve kur'anore*.⁶ Kapti-

⁴ Hadithin e transmeton Buhariu, sipas: El-Hafidh Imadu'd-din Ebu'l-Fida Ismail Ibn Kethir, *Tefsir'ul-Kur'an'il-adhim*, Dar'ul-endlus, botimi II, pa vend botimi, 1980/1400 h., libri IV, fq. 8-9. Ose: *Tefsir Ibn Kesir – Version i shkurtuar në gjuhën boshnjake* (më tutje: Ibn Kethir-B), botimi II, Sarajevë, 2002/1423 h., fq. 639.

⁵ Shkrimin tonë konsiderueshëm e kemi mbështetur në: M. A. Kovač, shkrim ky që është botuar në *Novi Horizonti*, ose në: <http://islam.dzemat.org/modules.php?name=News&file=article&sid=366>. Edhe titullin por edhe një pjesë të skemës së shkrimit e kemi huazuar nga ky shkrim.

⁶ Kjo kaptinë është dëshmi e shkencës së bazuar mbi komentimin e ënd-

na Jusuf gjithnjë është në atmosferë shpirtërore, e cila ndjehet në veprimet dhe fjalët e individëve të cilët vënë në lëvizje skenën kur'anore. Jakubi kur'anor është më shumë *i dërguar* se sa *baba*, ai ka më shumë zjarr fetar se sa zjarr prindi në të folur dhe ndjenja. Kjo sidomos manifestohet me rastin e lajmit se Jusufi është zhdukur⁷ apo Jusufi është gjetur.

Kaptina Jusuf tematikisht trajton rrëfimin për Jusufin a.s. dhe është rrëfimi më i gjatë dhe më i bukur:

1) Gjerësisht trajtohet ndodhia;

2) Kaptina përmban shumë lumturi dhe fatkeqësi, ngërthen në vete edhe meshkujt edhe femrat e të gjitha shtresave të popullit;

3) Në mënyrë të gjallë rrëfen jetën e Jakubit a.s. në moshë të shtyrë dhe të të birit të tij më të dashur, Jusufit, rrëfenë për zilinë e djemve të Jakubit ndaj vëllait Jusufit, kurthën e tyre dhe pikëllimin e babait, shitjen e Jusufit, akuzën e rrejshme ndaj Jusufit, qëndrimin dinjitoz të Jusufit në burg etj.⁸

Muhamed Asadi, në anën tjetër pohon se tema qendrore që tërhiqet si lajtmotiv në tërë kaptinën Jusuf është "*...Përcaktimi i përket vetëm All-llahut ...*". (Jusuf, 67).⁹

rrave. Komentimi i ëndrrave është dituri me rëndësi kurse mësohet nëpërmjet dijes së Zotit që ia jepë ndonjë njeriu të tij të zgjedhur. Shih: Abdu-rrahman ibn Nasir Es-Saadi, *Tejsiru'l-kerimi'rr-rahman*, në: *Glas islama - List za vjeru, društvo i kulturu*, Novi Pazar, nr. 112/2006, fq. 13.

⁷ Malik Ibn Nebi, *Kur'anski fenomen*, Sarajevë, 1986, fq. 173.

⁸ *Prijevod Kur'ana sa tefsiirom i komentarom na bosanskom jeziku* (më tej: *Prijevod Kur'ana-RA*), përkthimi i Ramo Atajic, libri 3, Munchen, 2001, fq. 879.

⁹ Muhammed Asad, *Poruka Kur'ana*, Sarajevë, 1425 h./2004, fq. 327. Është për keqardhje se si autorët e fushave të ndryshme islame kalojnë mbi porositë e kaptinës Jusuf. Përpiqen të gjejnë burime nga çdo vend, por

Mirëpo, rrëfimi për Jusufin a.s. nuk është shtruar sikurse rrëfimet në kaptinat tjera kur'anore dhe në këtë pikëpamje paraqet përjashtim. Deri sa në kaptinat tjera personazhët dhe sizhetë kur'anore janë të shpërndarë në shumë vende, në këtë kaptinë sizheu është shtruar në një kaptinë dhe është quajtur me një emër. Është shtruar tërë rrëfimi për jetën e tij, nga rinia e hershme deri në plotninë e misionit pejgamberik¹⁰, duke e ndarë këtë rrëfim në njëzet e tetë skena.¹¹

Në këtë kaptinë, sikur edhe në disa të tjera, përsëriten disa shprehje të caktuara të cilat e përbëjnë atmosferën e vetë kaptinës dhe veçanësinë e saj. Karakteristike janë fjalët علم - *ilm*, dije kundrejt جهل - *xhehl*, padije (12: 6, 21, 22, 34, 37 etj.)¹².

Në këtë kaptinë janë përkufizuar edhe disa veçanësi të Hyjnisë. Në rend të parë është *gjykimi*, qoftë nga këndi i Jusufit a.s. në kuptim të sovranitetit mbi robët nga këndi i nënshtrimit të tyre vullnetit, qoftë nga këndi i Jakubit a.s., në kupëtim të sovranitetit mbi robët nga këndi i nënshtrimit të tyre All-llahut në formën e paracaktimit.¹³ Nga tërësia e ajeteve shihet qartë se besimi është jokorrekt nëse nuk bëhet për hir të All-llahut.

Kaptina Jusuf “edhe pse ka ngjashmëri me rrëfimin biblik për Jusufin, ajo nuk është e njëjtë. Të njëjtë

neglizhojnë porositë psikologjike, sociologjike, ekonomike, politike, e tj.

¹⁰ Veçanësinë e sures *Jusuf* e miraton edhe Sejjid Kutub, *Ilustrimi artistik në Kur'an*, Shkup, 2001/1421, fq. 230.

¹¹ Shih gjerësisht aspektin artistik të sures *Jusuf*, por edhe të disa sureve tjera: Sejjid Kutub, *Ilustrimi*, op. cit., fq. 237-239.

¹² S. Kutb – B, 12, op. cit., fq. 223-225.

¹³ S. Kutb – B, 12, op. cit., fq. 225.

kanë vetëm bazën historike. Vetëm hulumtimi krahasues i kësaj kaptine zbulon elementet vetjake që karakterizojnë veçanërisht çdonjërin version.¹⁴ Deri sa rrëfimi biblik është rrëfim popullor pa vend për moralin dhe shërben për t'i dhënë vend qendror njeriut hebraik, rrëfimi kur'anor është më pak tregim e më shumë predikim moral ose alegori në të cilën shpjegohen kundërthëniet natyrore në jetë, esenca permanente e virtytit në një botë e cila gjithnjë ndryshon dhe veprimi i çuditshëm i vullnetit të All-llahut para përditshmërisë sonë...".¹⁵

¹⁴ Shih Shtojcën nr. 4 në fund të librit tonë ose: Malik Ibn Nebi, op. cit., fq. 173.

¹⁵ Jusuf Ali, *The Holy Qur'an, Text, Translation and Commentary*, Maryland, USA, 1983, fq. 548.

Kaptina Jusuf është shpallur në Mekë

Sipas shumicës së komentatorëve të Kur'anit, kjo kaptinë është shpallur në Mekë. Në këtë pajtohet edhe Ibn Abbasi dhe Katade, por shtojnë se katër ajete nuk janë mekase. Kurtubiu pohon se këta katër ajete janë numëruar të Tefsirin e Rraziut (ajeti 1, 2, 3 dhe 7).¹⁶ Këtë mendim e argumenton shkaku i zbritjes së kësaj sureje, të cilin e theksojnë mufesirët e kjo është pyetja e hebraikëve drejtuar Muhammedit a.s. përndodhinë e Jusufit. Me fjalë të tjera, shkak i zbritjes së kësaj kaptine kanë qenë pyetjet e shpeshtuara të hebraikëve drejtuar Muhammedit a.s. lidhur me Jusufin dhe vëllezërit e tij.¹⁷

Pas një kohe, sipas Ibn Xheririt kurse e transmetuar nga Ibn Abbasi, pasoi shpallja e kaptinës Jusuf.¹⁸ Hebraikët si bashkëqytetarë lajmërohen tek në Medi-

¹⁶ Krahas Kurtubiut edhe Ibn Kethiri mendon se ajetet 1, 2, 3 dhe 7 janë zbritur në Medinë. Sipas: Ibn Kethir-B, op. cit., fq. 639. M.Asad mendon se tërë kaptina është zbritur në Mekë dhe këtë e mbështet tek Sujutiu. Sipas: M. Asad, op. cit., fq. 327. Edhe Shewkani mendon se kjo sure është zbritur e tëra në Meke. Sipas: Muhammed Sulejman Abdullah El-Eshkar, *El-Kur'an'ul-kerim we bi'l-hamishi zubdet'ut-tefsiri min feth'il-kadir* (më tej: El-Eshkar), botimi II, Kuvait, 1999/1420 h., fq. 302.

¹⁷ Ibn Kethiri gjerësisht fletë për shkakun e zbritjes së kësaj kaptine kur'anore duke transmetuar rastin e Umerit a.s.. Shih gjerësisht: Hafidh Imaduddin Ebi'Fida' Ismail bin Kethir El-Kureshij Ed-Dimishkij, *Tefsir'ul-Kur'an'il-adhim*, (më tej: Ibn Kethir-Ar), libri IV, botimi II, 1980/1400 h., fq. 5 e tutje. Ose: Hafiz Ibn Kesir, *Kazivanja o vjerovjesnicima*, Zenica, 1420 – 1999, fq. 258.

¹⁸ Jusuf Ramic, *Povodi Objave Kur'ana*, Sarajevë, 1984, fq. 139.

në, që t'u lajmërojë për Jusufin. Vetëm pas këtij rasti është kjo kaptinë kompletuar.¹⁹

Historianët e Kur'anit pajtohen se kaptina Jusuf është shpallur menjëherë pas vdekjes së Ebu Talibit dhe tri ditë pas tij edhe të bashkëshortes së Muhammedit a.s., Hatixhes r. anha. Muhammedin a.s. e përshkoi pikëllimi dhe dëshpërimi.²⁰ Po ashtu, zbritja ndodhi ndërmjet takimit të parë dhe të dytë në Aka-be. Kjo ishte një kohë kritike për muslimanët por edhe për vetë Muhammedin a.s..²¹ Pikërisht në këtë kohë zbriti kaptina Jusuf, përplotë leksione, këshilla dhe mësim: "*Pa dyshim në vështirësi ka lehtësi.*" (El-Inshirah, 6).²²

Autorët rastin e Jusufit a.s. e lidhin me rastin e Pejgamberit a.s.. Sikur Jusufi që fali vëllezërit e tij pas gjithë atyre mundimeve, ashtu edhe Muhammedi a.s. i fali mekasit me rastin e çlirimit të Mekes.²³

Kjo kaptinë ndryshe quhet edhe kaptina *e ngushëllimit* (تسلية / teslijeh), nëpër të cilën kaluan thujtë të gjithë të dërguarit e Zotit, por sidomos Jakubi dhe Jusufi a.s.. Kjo ishte edhe një porosi e All-llahut se të da-

¹⁹ Abdulvehhab En-Nexhhar, *Kasas'ul-enbija*, botimi III, Bejrut, pa vit botimi, fq. 120.

²⁰ Imam Vehbi Ismaili, *Historia e pejgamberëve*, libri II, botimi II, Michigan, USA, 1419-1988, fq. V.

²¹ Sayyid Qutb, *U okrilju Kur'ana*, libri 12, Sarajevë, 1998, fq. 191. (më tej: S. Kutb – B).

²² Tarik Suvejdani, *Vjerovjesnici i njihovi narodi* (Kasas'ul-enbija', 1997), Zivinice, 2003, fq. 178. M. A. Sabuni kohën e shpalljes së sures e përshkroi si të rëndë për Muhammedin a.s. për shkak të pikëllimit për vdekjen e Ebu Talibit dhe të gruas së tij hazreti Hatixhes. Muhammed Alij Es-Sabuni, *Safvet'ut-tefasir*, libri II, botimi IV, Bejrut, 1981/1402 h., fq. 39.

²³ Imam Vehbi Ismaili, *Historia*, II, op. cit., fq. VI.

shurit (pejgamberët) e Tij gjithnjë janë nën mbrojtjen dhe shpëtimin e Tij, përkundër ngatërresave, intrigave, thurjeve e shthurjeve, territ, përçmimeve etj.²⁴

Kaptina Jusuf fillon me tre ajete hyrëse të cilat flasin për vetë Kur'anin si mrekulli, vijojnë rreth 100 ajete tjera për jetën e Jusufit a.s. dhe përfundon me disa ajete të cilat përmbajnë konfirmimin e pejgamberisë së fundit si përfundimtare.²⁵

Ibn Kethiri thekson se një numër hebraikësh pranuan Islamin pasi e dëgjuan Pejgamberin se si e lexon këtë kaptinë, pasi që kjo e lexuara pajtohej me atë që ata e dinin nga librat e tyre fetare. Këtë e transmeton Ibn Abbasi.²⁶

Kurtubiu na sjellë edhe qëndrimin e dijetarëve të cilët thonë: *"All-llahu në Kur'an në mënyrë të përsëritur na përmend rrëfimet mbi pejgamberët me një kuptim por me disa mënyra të shprehur, me shkallë të ndryshme të eloquencës së shprehur. Rrëfimin për Jusufin e ka përmendur por nuk e ka përsëritur. Theksimi i nduarnduart të rrëfimit të njëjtë nuk është kundërshti e asaj që theksohet në mënyrë të përsëritur por është fjala për i'xhazin (mrekullinë) të cilin e vërejnë ata të cilët meditojnë."*²⁷

Kaptina Jusuf është një mu'xhize vetvetiu por edhe një dëshmi e pejgamberisë së mirëfilltë të Muhammedit a.s.. Kjo është e qartë edhe nga fakti se rrë-

²⁴ Dzermaludin Latic, *Stil kur'anskoga izraza*, Sarajevë, 2001, fq. 368.

²⁵ El-Menar, sipas: *Prijevod Kur'ana-RA*, op. cit., fq. 879.

²⁶ Sipas: Ibn Kethir-B, op. cit., II, fq. 615.

²⁷ Ebu Abdullah Muhammed b. Ahmed El-Ensari El-Kurtubi, *El-Xhamiu li ahkam'il-Kur'an*, Bejrut, 1966, IX, fq. 122. Krhs.: Muhammed Alij Es-Sabuni, op. cit., fq. 40.

fimi i një tregimi kaq të gjatë pa pasur njohuri dhe njoftime mbi historitë e mëhershme pejgamberike nga ana e Muhammedit a.s. dhe e as'habëve.²⁸

Muhammedi a.s. ka pasur një mendim të lartë për këtë kaptinë. Sipas transmetimit të Ubej bin Ka'bit r.a., Pejgamberi i All-llahut a.s. porositi: "Mësonjani skllëvërve tuaj suren Jusuf. Nëse një musliman e shkruan atë dhe ua mëson të vetëve e skllavit, All-llahu ia lehtëson agoninë. Dhe nuk i jep rast të ketë smirë ndonjë muslimani."²⁹

Me të drejtë mund të pohohet se nëse Isai a.s. është i madh në varfëri, sikur që Ejubi a.s. është i madh në sëmundje, Ibrahim i a.s. në rezistencë idhujtarisë, Sulejmani a.s. në urtësi dhe pushtet, ashtu edhe Jusufi a.s. është i madh në pastërtinë morale: bukuri në fizike dhe shkëlqimin moral.

²⁸ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

²⁹ Osman Nuri Topbash, op. cit., fq. 30.

Hyrje në rrëfim

Tre ajetet e para të kaptinës *Jusuf* janë hyrëse. Kaptina fillon me shkurtesën (siglën) ال - elif-lam-ra. Në Kur'an 29 kaptina fillojnë me sigla të tilla, me një apo me disa shkronja. *Siglat*, respektivisht *el-hurufu'l-mukatta'at*,³⁰ në veprat e tefsirit zakonisht shpjegohen me rastin e paraqitjes së parë të tyre, gjatë komentimit të kaptinës El-Bekareh, e cila po ashtu fillon me siglën elif-lam-mim.

Komentuesit e Kur'anit japin disa kuptime të këtyre siglave, shkronjave të ndërprera, respektivisht "të shkronjave që shqiptohen ndarazi". Disa këto sigla i grupëzojnë në ajetet më pak të qarta (el-muteshabihat), "*kuptimin e të cilave e di vetëm All-llahu*" (Ali Imran, 7), kurse disa të tjerë mendojnë se këto shkronja janë emra të kaptinave me të cilat kanë filluar, pastaj se janë emra të bukur të All-llahut, se në një sigël përmbahen disa emra të bukur të All-llahut, si për shembull: *Elif* për *All-llah*, *Lam* për *Latif* (I buti), *Mim* për *Mexhid* (I Lavdëruari).³¹

Pas siglës pason pjesa e dytë e ajetit:

³⁰ Për siglat shih: Jusuf Ali, op. cit., fq. 118. Për siglat lexo gjerësisht edhe: M. Asad, op. cit., fq. 1023-1024.

³¹ Ibn Kethir, op. cit., I, fq. 61-62. Abdurrahman bin Nasir Es-Sa'dij pohon se me "qartësi" kuptohet qartësia e shprehjeve dhe kuptimeve. Sipas: Abdurrahman bin Nasir Es-Sa'dij, *Tejsir'ul-kerim'ir-rrahman fi tefsiri kelam'il-mennan* (më tej: Es-Sa'dij, Tejsir), libri I, botimi IV, Kuvait, 2000/1420 h., fq. 522.

تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ الْمُبِينِ

“Këto janë ajetet e librit të qartë!” (Jusuf, 1)³².

Kurtubiu thekson se me këtë togfjalësh “librit të qartë” mendohet në përshkrimin e Kur’anit si libër në të cilin janë sqaruar gjerat e lejuara nga të ndaluarat, dispozitat dhe rregullat etj.³³

Pastaj pason ajeti në të cilin theksohet shpallja e Kur’anit në gjuhën arabe

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

“Pa dyshim Ne e shpallëm si Kur’an në gjuhën arabe, që ta kuptoni!” (12, 2),

dhe në vazhdim jepet përgjigjja për pyetjet e as’-habëve dhe lutjet e tyre që ia kanë dërguar Pejgamberit a.s. që “diç t’ju rrëfejë”, dhe se sipas traditës është shpallur ajeti:

نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ وَإِنْ كُنْتَ مِنْ قَبْلِهِ لَمِنَ الْغَافِلِينَ

“Ne ty të rrëfejme rrëfimet më të bukura duke ta shpallur këtë Kur’an, edhe pse para tij, me të vërtetë, ti nuk ke ditur asgjë.” (12, 3).

Këtu togfjalëshi أَحْسَنَ الْقَصَصِ “rrëfimet më të bukura” mund ta kuptojmë se si ajo pikërisht ka të bëjë me rrëfimin për Jusufin a.s.. Sipas T. Suvejdanit fjala *el-kasas* do të thotë radhitja e lajmeve, apo përmendja e një lajmi pas tjetrit.

³² Për përkthimin e ajeteve janë konsultuar të gjitha përkthimet në gjuhën shqipe, por edhe ato boshnjake, natyrisht duke i pasur parasysh edhe tefsiret në gjuhën arabe që theksohen në literaturë.

³³ Sipas: El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 188.

Vetë shprehja “*قَصَصٌ* – *kasas-un*”, në bazë vjen nga folja “*قَصَّ* - *kassa*”, e cila ka kuptimin “të ndiqet gjurma”. Së këndejmi, rrëfyesi ndjek gjurmat dhe për to na njofton. Fjala *kassa* d.m.th. *tâbe`a*, të pasojë, të pasohet, të ndiqet dikush, të ndiqet hap pas hapi, shkallërisht.³⁴

Dijetarët sjellin argumente të shumta për ç’arsye kjo kaptinë është quajtur me shprehjen “*أَحْسَنَ الْقَصَصِ*” - *rrëfimet më të bukura*. Mendimet sillen nga ajo se në Kur’an nuk ka rrëfim i cili është shtruar në mënyrë më të përgjithësuar, duke bartur me vete mësimin, këshillën dhe urtësinë, deri te mendimi se kaptina është quajtur kështu për shkak të sjelljes së mirë të Jusufit ndaj vëllezërve të tij dhe durimit të tij përballë vështirësive të cilave iu qe ekspozuar, e të cilat ia paten shkaktuar vëllezërit e tij dhe për shkak të faljes bujare nga ana e tij pasi u takua me ata.³⁵

Sipas Raziut pa dyshim mund të parashtrohet se mbiemri “*أَحْسَنَ* - *më të bukura*” nuk ka të bëjë me përmbajtjen “e asaj që shpjegohet”, por më tepër “me mënyrën me të cilën Kur’ani (kjo kaptinë) shpje-

³⁴ Tarik Suvejdani, op. cit. fq. 180. M. Asad, op. cit., fq. 328, fus. 5.

Raziu mendon se shprehja *kissa* në Kur’an është “shprehje e përplotësuar përmbajtja e të cilës përudhë në fe, shpie në të vërtetën dhe imponon kërkimin e shpëtimit.” Sipas: Dzamaludin Latic, Stil..., op. cit., fq. 285.

³⁵ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 119.

Përkthyesit boshnjakë Panxha-Çausheviq theksojnë se *Kamus* dhe *Taxh’ularus* “më të bukurin” e shpjegon ashtu që me shpalljen e Kur’anit shtrohen në mënyrën më të përkryer nevojat shpirtërore dhe morale të njeriut. Sipas: Kur’an Casni – prevod i tumac, përkthyen dhe përgatitën: Hafiz Muhammed Pandza dhe Dzamaluddin Causevic, Sarajevë, 1937, fq. 348.

gon”³⁶, kurse M. A. Halefullahi mendon se All-llahu e ka quajtur këtë kaptinë “më të bukura” nga aspekti i ndërtimit të poetikës së tij.³⁷

Është e njohur tashmë se Jusufi kishte bukuri të jazhtëzakonshme fizike, e cila i detyroi gratë e Egjiptit ta quanin *melek* (“...Ky nuk është njeri, por ky është një engjëll fisnik!”, 12, 31). Por, dijetarët nuk kanë lënë pa vënë re edhe një kuptim tjetër pse është quajtur ky rrëfim më i bukuri, dhe pohojnë se bukuria fizike e Jusufit është simbol i bukurisë së tij të shpirtit.³⁸

Sipas Kurtubiut, një nga arsyet është edhe ajo se në këtë kaptinë përmenden: peygamberët, njerëzit e mirë, engjëjt, djajtë, xhinët, sundues e mbretër, tregtarët, dijetarët, injorantët, gratë intriguese, por edhe tevhidi (njësia) në një All-llah, jeta e peygamberëve, shpjegimi i ëndrrave dhe tema të tjera.³⁹

Fundin e ajetit “...ti nuk ke ditur asgjë”, Sabuni dhe Enes Kariq e kuptojnë ashtu që pohon se Muhammedi a.s. ka qenë analfabet, nuk ka ditur shkrim-lexim dhe se për këtë ngjarje nuk ka ditur, dëgjuar apo lexuar më parë, që paraqet mrekulli dhe dëshmi tjetër për peygamberinë e tij.⁴⁰

³⁶ M. Asad, op. cit., fq. 328.

³⁷ Muhammed Ahmed Halefullah, *El-Fennu'ul-kasasi fi'Kur'an'il-kerim*, Kairo, 1965, fq. 314.

³⁸ Jusuf Ali, op. cit., fq. 550. Përkthyesit boshnjakë Panxha-Çausheviq theksojnë se në “Kamus” dhe “Taxh'ul-arus” “më të bukurin” shpjegohet se “Kur'ani në mënyrën më të përsosur ekspozon nevojat shpirtërore dhe morale të njeriut ...”. Shih më gjerësisht: Pandza-Çausevic, op. cit., 349.

³⁹ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 119.

⁴⁰ Muhammed Alij Es-Sabuni, *Safvet'ut-tefasir*, libri II, botimi IV, Bejrut, 1981/1402 h., fq. 41. Krhs.: *Kur'an sa prijevodom na bosanski jezik*, preveo Enes Karic, Sarajevë, 1995, fq. 235, fusnota 3.

Ëndrra e Jusufit

Jusufi a.s. i përket familjes së të dërguarve të Zotit.⁴¹ Babai i tij është Jakubi, gjyshi i tij është Is'haku, i biri i të përkëdhelurit të All-llahut, pejgamberit Ibrahimit a.s.. Edhe vetë ishte i Dërguar i All-llahut.⁴²

Lindja e Jusufit a.s. lidhet edhe me një ndodhi historike dhe hyjnore. Pikërisht në vitin e lindjes së Jusufit Jakubit i erdhi pejgamberia nga All-llahu. All-llahu e bëri përgjegjës për përhapjen e fjalës së Zotit.⁴³

Personaliteti dhe jeta e Jusufit a.s. është nga ndodhitë më këshilluese, më të qarta dhe më bukur të rrëfyera në historinë e njerëzisë! Jeta e tij është gërshetim i të gjitha rrethanave të mundshme. Kemi sprovë pas sprove, zgjidhje dhe rënie, ndërlikim dhe lehtësim, nga përçmimi në dinjitet, nga robëria në pushtet dhe mbretërim, nga rrëmuja dhe ndarja në unitet dhe përbashkësi, nga pikëllimi dhe dhembja në përfundim të lumtur, nga ngushtia shpirtërore në zemër dhe horizonte të hapura.⁴⁴

Qysh si djalosh, Jusufi ndiente se është afër All-llahut, ndiente se ishte më afër babait të tij, pejgambe-

⁴¹ Për historinë familjare të Jusufit a.s. shih: Harun Yahja, *Jusuf a.s.*, Sarajevë, 2004, fq.12-18.

⁴² Abdulvehhab En-Nexhxhar, op. cit., fq.120.

⁴³ Osman Nuri Topbash, *Vargu i profetëve në dritën e Kur'anit*, 2, Stamboll, 2001, fq. 28.

⁴⁴ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

rit Jakub a.s.. Ndoshta pikërisht ashtu sikur Jakubi që kishte trashëguar babain Is'hakun a.s.. Në një çast, All-Ilahu i lartësuar vendosi t'ia dërgojë një vizion të bukur, një sihariq.⁴⁵

Pas disa ajeteve hyrëse pason rrëfimi⁴⁶ i Jusufit para babait të tij. Në të rrëfen për ëndrrën e tij të pazakontë në të cilën kishte parë 11 yjë, Diellin dhe Hënën se si i përulen atij. Jusufi i vogël u befasua, sepse nuk e kuptoi këtë ëndërr.

إِذْ قَالَ يُوسُفُ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ إِنِّي رَأَيْتُ أَحَدَ عَشَرَ كَوْكَبًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ
رَأَيْتُهُمْ لِي سَاجِدِينَ

"Kur Jusufi i tha babait të vet: 'O babai im!, kam parë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, edhe Diellin, edhe Hënën; dhe i kam parë (në ëndërr) se si më bënëin sexhde mua!" (12. 4).

Pason përgjigjja e babait për Jusufin a.s.:

قَالَ يَا بُنَيَّ لَا تَقْصُصْ رُؤْيَاكَ عَلَىٰ إِخْوَتِكَ فَيَكِيدُوا لَكَ كَيْدًا إِنَّ الشَّيْطَانَ
لِلْبَإْسَانِ عَدُوٌّ مُّبِينٌ

"Ai (babai) tha: 'O biri im, mos ua rrëfe ëndërrën tënde vëllezërve tu, që mos të ta bëjnë ndonjë të keqe (kurthë); s'ka dyshim se djalli është armik i hapët i njeriut!" (12:5).

⁴⁵ Muhammed El-Gazali, *Tematski tefsir kur'anskih sura*, Sarajevë, 1424 h./2003, fq. 247. Ky tefsir është botuar nga Logos-A edhe në gjuhën shqipe, të përkthyer nga arabishtja nga Sadush Tahiri: Muhammed El-Gazali, *Komenti Tematik i Kur'anit Famëlartë, Shkupë, 2007*). Ose: Shejh Muhammed El-Gazali, *Nahwe tefsirin mewdu'ijjin li suweri'l-Kur'ani'l-kerim*, Botimi I, Daru'sh-shuruk, Bejrut-Kairo, 1414 h./1993.

⁴⁶ Lënda rrëfyese është elementi themelor i rrëfimit, i cili është i pavarur, i veçuar nga tërësia e tregimit në atë mënyrë se është i kuptuar pavarësisht, por ai është, nga ana tjetër, pikërisht i pandarë nga struktura e tërësishme e tij në të cilën funksionon si një prej fijeve strukturale.

Përshkrimi i 11 yjëve dhe Hënës e Diellit do të mund të kuptohet edhe si dekor i qiejve dhe bukuri e tyre dhe se në këta trupa qiellorë ka dobi të madhe. Kjo është e njëjtë edhe me pejgamberët dhe dijetarët, të cilët janë dekorë të tokës. Po ashtu, përshkrimi dhe krahasimi i nënës me Hënën dhe i babait me Diellin tregon⁴⁷ se ata janë rrënjë kundrejt vëllezërve që, përshkruhen si yjë, që tregon se ata janë degë. Respektimi i Jusufit nga Hëna, Dielli dhe yjët tregon se ata që përulen janë më pak të vlefshëm dhe më pak të rëndësishëm krahasuar me atë të cilit i përulen. Kjo tregon se Jusufi do të respektohet edhe nga prindërit por edhe nga vëllezërit.⁴⁸

Vetë emri "Jusuf" fletë mjaft. Ka mendime se ky emër është me prejardhje të huaj. Por, dominon mendimi se fjala **Jusuf** është nxjerrë nga fjala arabe **أَسْف** - **esef** që domethënë "dëshpërim, ankim, vajtim, pikëllim, hidhërim, dhembje, sëndisje, brengosje"⁴⁹, dhe se për shkak të dhembjes dhe pikëllimit për djalin e tij ai është quajtur kështu – *Jusuf*, që do të thotë "i qajturi, i vajtuari". Në këtë aludojnë edhe fjalët nga ajeti 84 i kësaj kaptine "... يَا أَسْفَى عَلَى يُوسُفَ ... - jâ esefâ 'alâ Jûsufe ..." d.m.th.:

يَا أَسْفَى عَلَى يُوسُفَ وَأَبْيَضَّتْ عَيْنَاهُ مِنَ الْحُزْنِ فَهُوَ كَظِيمٌ ...

"Dhe ua ktheu shpinën atyre dhe tha: "O dëshpërimi im (O i mjeri unë) për Jusufin; sytë iu kishin zbardhur prej pikëllimit, ka qenë shumë i dëshpëruar." (12, 84).

⁴⁷ Ibn Kethir-A, op. cit., fq. 10 e tutje. Ibn Kethir-B, op. cit., fq. 640.

⁴⁸ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

⁴⁹ Teufik Muftic, *Arapsko-srpskohrvatski jezik*, I, Sarajevë, 1973, fq. 65.

Një autor tjetër nga fjala *esef* nxjerr dy kuptime:

1) Kuptimin *pikëllim* dhe merrë si shembull ajetin 84 të sures Jusuf, të cilin e kemi theksuar me herët dhe;

2) Kuptimin *hidhërim*, *zemërim* dhe merrë si shembull ajetin 55 të sures Ez-Zuhruf (فَلَمَّا أَسْفُونَا – E kur ata nxitën hidhërimin tonë).⁵⁰

Këtu paraqitet edhe fenomeni i ëndrrës, për të cilën Kurtubiu gjerësisht diskuton, duke lidhur ëndrrën me misionin pejgamberik.

Dijetarët pajtohen se ëndërra paraqet pjesë të shpalljes pejgamberike⁵¹, por dijetarët dallojnë në interpretimin e hadithit të Muhammedit a.s.:

“Pas meje shpallje nuk do të ketë pos ëndrrës së mirë dhe të vërtetë që e sheh njeriu i mirë ose i dëftohet në ëndërr.” (Bejhekiu).

Kurtubiu thekson hadithin që e shënon Muslimi:

“Ëndrrat më të vërteta në mesin tuaj i ka ai i cili më së shumti e fletë të vërtetën.”

Pastaj pason hadithi që e shënon Buhariu:

“Resulullahu, s.a.v.s., ka komentuar se ëndërra është pjesa e 46-të e pejgamberisë.”

⁵⁰ El-Husejn bin Muhammed Ed-Damegani, *Kamus'ul-Kur'ani ew islah'ul-wuxhuhî we'n-nedhairi fi'l-Kur'an'il-kerim*, Bejrut, botimi III, 1980, fq. 32, dhe fusnota 2.

⁵¹ Ëndrrat janë tri llojesh: 1) *Realiteti i vetvetes*: njeriu sheh në ëndërr punën dhe artin e tij; i dashurti sheh të dashurën ose e dashura të dashurin, etj. Kjo ëndërr është rezultat i imagjinatës; 2) *Frikësime të djallit*: Ëndërra të ngatërruara që shqetësojnë shpirtin; 3) *Lajmet e mira*, myzhdet e ardhura nga Zoti: Engjëlli i ëndrrës i tregon personit gjëra prej Tabelës së Kujtesës (Levhi Mahfudh). Këto lloj ëndërrash janë të vërteta e të mira. Të tjerat veç këtyre janë ëndërra të përzjera.” Sipas: Osman Nuri Topbash, op. cit., fq. 34.

Në trajtesat që i shqyrton Kurtubiu trajtohet problemi se cilat mendime janë më relevante, pjesa e 46-të apo 70-të apo e 40-të etj.⁵²

Kurtubiu, në bazë të haditheve që i sjellë Buhariu dhe Muslimi përfundon se shkalla e vërtetësisë së të pamurit ëndërr varet nga fuqia e besimit të njeriut, nga veprat e tij të mira...⁵³.

Trajtimet janë të gjera dhe nuk mund të ndalemi në shqyrtimin e tyre, pos të theksojmë se prekin çështjet që janë shtruar në hadithet e përmendura: a kanë të bëjnë këto edhe me ëndërrat e pabesimtarëve? Pastaj shtohen qëndrimet se si duhet vepruar pas ëndrrës së mirë dhe si pas ëndërrës së keqe, duke i cekur veprimet dhe sugjerimet e Muhammedit a.s., sikurse: *“Kur dikush nga ju ëndërron diç të keqe, le të pështyjë nga e djathta dhe le të kërkojë strehim tek All-llahu nga shejtani i mallkuar tri herë, pastaj le ta ndërrojë anën në të cilën ka fjetur.”* (Muslimi).

Në disa hadithe të tjera rekomandohet marrja e abdestit dhe falja e namazit nafile, kur njeriu sheh ëndërr të keqe.

Pasi që Jusufi a.s. ia rrëfeu babait të tij ëndrrën, babai i tij, Jakubi a.s. e parandjeu ardhmërinë e të birit

⁵² El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 122.

⁵³ Pasi trajtesat janë shumë të gjera nuk do të ndalemi në to, pos të theksojmë se a kanë të bëjnë këto shpjegime edhe me ëndërrat e jobesimtarit? Pastaj shtohen qëndrimet si duhet vepruar pas ëndrrës së mirë e si pas ëndërrës së keqe dhe rekomandimin e Muhammedit a.s. në të cilin ka thënë: *“Kur dikush nga ju ëndërron diç të keqe, le të pështyjë nga e djathta dhe le të kërkojë strehim tek All-llahu nga shejtani i mallkuar tri herë, pastaj le ta ndërrojë anën në të cilën ka fjetur.”* Këtë hadith e shënon Muslimi. Në disa hadithe rekomandohet marrja e abdestit dhe falja e nafileve, kur njeriu sheh ëndërr të shëmtuar, të keqe. El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 128.

të tij, u gëzua për këtë por e porositi Jusufin që këtë ëndërr mos t'ia tregojë vëllezërve të tij. Ai këtë e bëri nga frika që vëllezërit mos t'i përgatisin ndonjë kurthë. Jakubi ishte i vjetër dhe e njihte natyrën e njerëzve. E dinte se si djalli luan me njerëzit. Jakubi a.s. ishte i udhëzuar në shpjegimin e ëndrrave dhe ishte i qartë shpjegimi i saj. 11 yjet ishin vëllezërit e Jusufit. Dielli ishte babai i tij deri sa Hëna ishte nëna e tij (apo tezja, të cilën e kishte martuar Jakubi pas vdekjes së nënës së Jusufit).

Abdulvehhab En-Nexhari në veprën e tij kapitale *Kasas'ul-enbija'* thekson gjendjen psikike të Jakubit duke shpjeguar se ai më shumë frikësohej prej të keqes së vëllezërve të Jusufit se sa prej të keqes së ujkut.⁵⁴

Kjo ëndërr njëkohësisht ishte edhe paralajmërim i një jete dhe fati të gjallë që e priste Jusufin e ri. Sipas Kurtubiut, sendërtimi i kësaj ëndërre ka zgjatur 40 vitet e ardhshme.

Para rrëfimit mbi kurthën që e planifikuan vëllezërit e Jusufit, Kur'ani e konfirmon misionin peygamberik të Jusufit por edhe tërheq vërejtjen që këto ndodhi janë mësim për njerëzit⁵⁵:

⁵⁴ Abdulvehhab En-Nexhar, op. cit., fq. 121.

⁵⁵ El-Gazaliu pohon se peygamberët posedojnë veçanësinë imagjinate shumë më të fuqishme se sa te njerëzit tjerë, që nuk do të thotë se ata janë subjekte të veçanta të iluzionit, por se imagjinata e tij në masë të barabartë është në funksionin intelektual dhe shpirtëror, e cila i përcakton si peygamberë: shpallja përqëndrohet në rendin ndijimor, apo edhe më saktë, në imagjinatën e cila përbrenda puthitet me shpalljen. Sipas: Resid Hafizovic, në M. Ibn Arabi, Dragulji ..., op. cit., fq. 114, fusn. 4.

وَكَذَلِكَ يَجْتَبِيكَ رَبُّكَ وَيُعَلِّمُكَ مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ وَيُتِمُّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ وَعَلَىٰ آلِ
يَعْقُوبَ كَمَا أَتَمَّهَا عَلَىٰ أَبَوَيْكَ مِنْ قَبْلُ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ إِنَّ رَبَّكَ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

“Por, ashtu Krijuesi yt ty do të zgjedh, dhe me shpjegimin e ëndrrave do të mësojë dhe dhantinë e Tij ty dhe familjes së Jakubit do t’ia plotësojë, ashtu siç ua ka plotësuar më parë dy të parëve tu, Ibrahimit dhe Is’hakut. Krijuesi yt, pa dyshim, është i gjithëdijshtëm dhe i urtë!” (12, 6).

لَقَدْ كَانَ فِي يُوسُفَ وَإِخْوَتِهِ آيَاتٍ لِّلْمُتَلِّينَ

“Njëmend te Jusufi dhe vëllezërit e tij ka shenja (mësim) për ata që pyesin.” (12, 7).⁵⁶

⁵⁶ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 129-130. Për motivet e vëllezërve të Jusufit për eliminimin e Jusufit duhet pasur parasysh edhe faktin se Jakubi kishte pasur 4 gra. 10 femijet e parë i kishte me gratë e para, kurse Jusufin dhe Benjaminin e kishte me Rahelën, dy fëmijët e fundit. Pra, Jusufi dhe Benjaminin ishin vetëm vëllezër prej babe me vëllezërit tjerë. Jusuf Ali, op. cit., fq. 550. Thuhet se Rahilja vdiq në ditën e 40 pas lindjes së Benjaminit. Osman N. Topbash, op. cit., fq. 28.

Tragjedia si pasojë e komplotit të vëllezërve të Jusufit

Vëllezërit e Jusufit fillojnë të planifikojnë se si ta eliminojnë Jusufin. Disa propozuan ta mbysin që ta fitojnë simpatinë e plotë të babait, kurse disa propozojnë të braktiset në ndonjë vend të shkretë. Një nga djemtë e Jakubit, më i vjetri, Jehudha, propozoi që Jusufi mos të mbytet, por të hedhet në ndonjë bunar të braktisur, e ndoshta ndonjë karvan do ta gjejë dhe do ta marrë me vete.⁵⁷ Me këtë veprim do ta zgjidhnin problemin e Jusufit por edhe gjak nuk do të derdhej.⁵⁸ Motivet e veprimit të tyre nuk mund të shikohen vetëm në zilinë e tyre kundrejt Jusufit për shkak të simpatisë që babai Jakubi ushqente ndaj Jusufit. Motivet duhet gjetur edhe në interesin material. Babai Jakubi ishte plakur dhe së shpejti do të duhej ndarë trashëgiminë. Për më tepër që Jusufi dhe Benjamini ishin vëllezër vetëm nga babai e jo edhe nga nëna.⁵⁹

Pas kësaj vëllezërit e Jusufit kërkuan prej babait të tyre që ta lëshojë Jusufin të shkojë me ta në shkretëtirë që "të zbavitet dhe të luajë":

⁵⁷ Gjerësisht: Imam Vehbi Ismaili, Historia e pejgamberëve, vëllimi i dytë, botimi i parë, Michigan, USA, 1419-1998, fq. 2-3. Opcioni fitues tregon se të gjithë djemtë e Jakubit nuk kishin një mendje, por më tepër ishte çështje koncenzusi, pajtimi me shumicën. Mendimi për mosmbytjen e Jusufit tregon se ende kishte mëshirë në zemrat e tyre.

⁵⁸ Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 121.

⁵⁹ Dzemaaludin Latic, Stil ..., op. cit., fq. 374.

إِذْ قَالُوا لِيُوسُفُ وَأَخُوهُ أَحَبُّ إِلَيْنَا مِمَّا نَحْنُ عُصْبَةٌ إِنَّ أَبَانَا لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ اقْتُلُوا يُوسُفَ أَوْ اطْرَحُوهُ أَرْضًا يَخْلُ لَكُمْ وَجْهُ أَبِيكُمْ وَتَكُونُوا مِنْ بَعْدِهِ قَوْمًا صَالِحِينَ قَالَ قَائِلٌ مِنْهُمْ لَا تَقْتُلُوا يُوسُفَ وَأَلْقُوهُ فِي غِيَابَةِ الْجُبِّ يَلْتَقِطْهُ بَعْضُ السَّيَّارَةِ إِنْ كُنْتُمْ فَاعِلِينَ

“Kur ata (vëllezërit) thanë: “Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashur për babain tonë se sa ne, edhe pse ne jemi një grupim i fuqishëm. Njëmend babai ynë po gabon haptazi. Mbyteni Jusufin apo dëbonie në ndonjë vend të largët, e babai juaj do t’u kthehet juve dhe pas kësaj ju do të bëheni njerëz të mirë. Njëri nga ata tha: “Mos e mbytni Jusufin, por hedhnie në fund të ndonjë bunari, do ta gjejë ndonjë karvan – nëse njëmend dëshironi të bëni diçka me të.” (12, 8-10).

Nga pjesa e ajetit *“do ta gjejë ndonjë karvan”* (يَلْتَقِطْهُ - *jeltekit’hu ba’du’s-sejjaleti*) vërehet se Jusufi ishte shumë i ri, sepse vetëm një djalosh i ri mund ta *“gjendet”*. Po ashtu, është evidente edhe nga fjalët e Jakubit ku ai thotë se frikësohet që mos ta hajë ujku, por edhe nga fjalët e vëllezërve të tij të cilët përgjigjen se ata do ta *“ruajnë”* nga ujku.⁶⁰

Pasi që tefsiri i Kurtubiut është me orientim juridik vërehet se ai hynë gjerësisht në shqyrtime juridike kudo që ka mundësi. Kështu gjatë komentimit të termit *jeltekit’hu* respektivisht *el-iltikatu*, që do të thotë të marrësh diç ose të mbledhësh diç nga rru- ga, Kurtubiu jep shembull, mes’ele për sendin e *gjetur el-luktah*.⁶¹

⁶⁰ Ahmet Behxhet, *Enbija’ull-llah*, Kairo, 1977, fq. 56. Krhs.: Es-Sa’dij, Tejsir, op. cit., fq. 524.

⁶¹ Gjerësisht: El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 132-138.

Pason ajeti në të cilin vëllezërit e Jusufit e bindin Jakubin a.s. ta lëshojë me ta Jusufin e ri:

قَالُوا يَا أَبَانَا مَا لَكَ لَا تَأْمَنَّا عَلَى يُوسُفَ وَإِنَّا لَهُ لَنَاصِحُونَ أَرْسَلَهُ مَعَنَا غَدًا يَرْتَعُ وَيَلْعَبُ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

“Ata (vëllezërit) thanë: O babai ynë, ç’është me ty që nuk ke besim te ne për Jusufin. Ne pa dyshim jemi nga ata që do ta këshillojmë. Dërgoje nesër me ne që të argëtohet e të luaj, kurse ne, me siguri, do ta ruajmë atë.” (12: 11, 12).

E para që vërehet në këtë ajet është që Jakubi hamendet a ta lejojë Jusufin me vëllezërit e tij. Jakubi ka dyshim në qëllimet e djemve të tij.

Përgjigja pason në ajetin tjetër:

قَالَ إِنِّي لَيَحْزُنُنِي أَنْ تَذْهَبُوا بِهِ وَأَخَافُ أَنْ يَأْكُلَهُ الذَّنْبُ وَأَنْتُمْ عَنْهُ غَافِلُونَ

“(Kurse Jakubi) tha: “Do të brengosem nëse e merrni, dhe frikësohem se mos do ta hajë ujku kur ju nuk do të kujdeseni për të.” (12:13).

Jakubi a.s. këtu parandjenë arsyetimin që do t’ia japin djemtë e tij pasi ta eliminojnë Jusufin. Kurtubiu sjellë transmetimin sipas të cilit Jakubi a.s. kishte ëndërruar se si ai vetë gjendet në shpat të një kodrine kurse Jusufin e shihte në rrafshirë të rrethuar me dhjetë ujqë dhe një i cili e kishte lënë dhe ishte ndarë nga turma e ujqëve. Ujqit i kishte parë të zemëruar, të gatshëm ta shqyejnë Jusufin. Pastaj në ëndrrën e tij kishte parë se si u hapë toka para Jusufit dhe i ofroi strehim Jusufit nga ujqit ku Jusufi mbeti tri ditë, kurse njëri nga vëllezërit që ishte ndarë ishte vëllai i tij më i vjetër që ishte kundër këtij veprimi. Sipas traditës Jusufi mbeti në bunar tri ditë deri në ardhjen e karvanit

i cili do ta marrë dhe çojë me vete.⁶² Kurtubiu këtë transmetim e konsideron të dobët. Arsyeja për këtë mendim është se Jakubi a.s. ishte peygamber, kurse ëndërra te peygamberët është shpallje dhe në këtë rast ai do të duhej të reagoje dhe t'i pengonte djemtë e tij në këtë synim. Pos, nëse kuptimi i fjalëve “*dhe frikësohem se mos do ta hajë ujku*” nuk është në kontekst të kujdesit të Jakubit sepse kishte parë se si ujqi befasisht sulmojnë, por këtu nuk është ky rast.⁶³

Vëllezërit e Jusufit megjithatë e bindën Jakubin që ta lëshojë Jusufin e ri në shkretëtirë për të luajtur e për rekreacion. Si do të ndodh dëmtimi i Jusufit, u arsyetuan ata, kur ne jemi shumë:

قَالُوا لَنْ نَأْكُلَهُ الذَّنْبُ وَنَحْنُ عُصْبَةٌ إِنَّا إِذًا لَخَاسِرُونَ

“Ata thanë: “Si do ta hajë ujku kur ne jemi grup i fuqishëm! Ne atëherë më mirë mos qofshim!” (12:14).⁶⁴

⁶² Imam Vehbiu pohon se bunari “kishte plot ujë, por Zoti me mëshirën e Tij e ruajti, se aty u gjet një gur i madh në të cilin zuri vend. Jusufi në fillim pati frikë, por Zoti, qoftë lavdëruar, e inspiroi që mos të kishte frikë se dikush së shpejti do të vinte ta shpëtonte. Kështu që ai u qetësua.” Imam Vehbi Ismaili, *Historia*, II, op. cit., fq. 5.

⁶³ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 140.

⁶⁴ Hafiz Ibn Kesir, *Kazivanja ...*, op. cit., fq. 261-262.

Hedhja e Jusufit në bunar

Pason ajeti që e përshkruan aktin e tyre:

فَلَمَّا ذَهَبُوا بِهِ وَأَجْمَعُوا أَنْ يَجْعَلُوهُ فِي غِيَابَةِ الْجُبِّ وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِ لَتُنَبِّئَهُمْ
بِأَمْرِهِمْ هَذَا وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ

“Pasi e morën dhe vendosën ta hedhin në fund të bunarit, Ne i shpallëm atij: “Ti për këtë veprim të tyre do t’i njoftosh, kurse ata ty as nuk do të njohin”. (12:15).

Komentuesit e Kur’anit përmendin shumë transmetime në të cilat përshkruhet veprimi i vëllezërve të Jusufit. Kurtubiu thekson transmetimin në të cilin Jakubi a.s. ia ka besuar Jusufin vëllait Rubelit, duke i thënë se Jusufi është i ri, që të kujdeset mirë, t’i japë ujë, ta ushqejë. Mirëpo, posa u larguan nga Jakubi, po ky vëlla e përplasi Jusufin për toke sa nuk e theu. Cilitdo vëlla që i afrohej Jusufi, secili e refuzonte në mënyrë të egër e të vrazhdë. Sërish iu kthye Rubelit që ta mëshirojë dhe shpëtojë, por ai i tha që të kërkojë ndihmë nga “njëmbëdhjetë yjet”. Kështu Jusufi e kuptoi se kjo intrigë po ndodh për shkak të ëndrrës që kishte parë.⁶⁵

Disa transmetime pohojnë se duke shkuar rrugës Jusufi është ofenduar, është goditur nga vëllezërit. Atë e urrenin shumë, sa dëshironin ta mbysnin. Të

⁶⁵ Kurtubiu mendon se këto transmetime nuk kundërshtojnë Kur’anin ndaj edhe mund të gjenden nëpër tefsire të Kur’anit. El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 141-142.

gjithë u pajtuan ta hedhin në bunar.⁶⁶ Imam Vehbiu pohon se bunari ku është hedhur Jusufi gjendej në një shkretëtirë pranë Jerusalemit.⁶⁷

Më tej përmendet se megjithatë vëllai Jehudha i bindi të tjerët që mos të derdhin gjak e të bëjnë mëkat të rëndë.

وَجَاءُوا أَبَاهُمْ عِشَاءً يَبْكُونَ قَالُوا يَا أَبَانَا إِنَّا ذَهَبْنَا نَسْتَبِقُ وَتَرَكْنَا يُوسُفَ عِنْدَ
مَتَاعِنَا فَأَكَلَهُ الذِّبَابُ وَمَا أَنْتَ بِمُؤْمِنٍ لَنَا وَلَوْ كُنَّا صَادِقِينَ وَجَاءُوا عَلَى قَمِيصِهِ بِدَمٍ
كَذِبٍ قَالَ بَلْ سَوَّلَتْ لَكُمْ أَنْفُسُكُمْ أَمْراً فَصَبْرٌ جَمِيلٌ وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ عَلَى مَا
تُصِفُونَ

“Dhe në mbrëmje ata erdhën te babai i tyre duke qarë. Ata thanë: “O babai ynë, patëm shkuar të garojmë në vrap, kurse Jusufin e lamë të teshat tona, ashtu që atë e hëngri ujku. Ti nuk do të na besosh, edhe pse ne të vërtetën e flasim.” Dhe ia sollën këmishën e tij të njomur me gjak të rrejtshëm. Ai tha: “Jo, por epshet tuaja ua zbukuruan punën tuaj, dhe mua më mbetet vetëm durim i mirë. Nga All-llahu kërkoj ndihmë kundër kësaj që ju e përshkruani.” (12, 16-18).

Se sa është i përkryer Kur’ani tregon edhe vetë mënyra e leximit të ajetit të 16 të sures Jusuf. Janë të pranishme zanoret e gjata: *وَجَاءُوا أَبَاهُمْ عِشَاءً يَبْكُونَ* - (*ve xhâû ebâhum ishâen jebkûn*), të cilët me lexim paralajmërojnë dhe figurativisht skicojnë gjendjen e arsytimit të vëllezërve të Jusufit, paraqesin tonin e pikëllimit të tyre të rrejtshëm të cilin u përpoqën t’ia shprehin Jakubit.⁶⁸

⁶⁶ Tarik Suvejdani, op. cit., fq. 184. Sjelljen jokorrekte dhe të vrazhdë të vëllezërve ndaj Jusufit e përshkruan edhe Imam Vehbiu. Shih: Imam Vehbi Ismaili, *Historia*, op. cit., fq. 5.

⁶⁷ Imam Vehbi Ismaili, *Historia*, II, op. cit., fq. 18.

⁶⁸ Hafiz Ibn Kesir, *Kazivanja...*, op. cit., fq. 263.

Terri i natës në këtë rast shkonte në favor të djemve të Jakubit që ta mbulojnë fitnen të cilën e kishin bërë. Kurtubiu e thekson Ibn Hibbanin se Jakubi pas marrjes së lajmit mbi zhdukjen e Jusufit ka klithur dhe ka rënë në pavetëdije. Djemtë ia sollën këmishën të lagur me gjak, të zhytur në gjak të rrejshëm, apo nëse (بَدْمٌ كَذِبٌ) e lexojmë ashtu si e ka lexuar Aishja r.a. (بَدْمٌ كَذِبٌ) do ta arsyetojmë mendimin e Taberit se gjaku ka qenë gjak i qengjit (sipas disave gjaku i dhisë) të prerë diç më herët.⁶⁹

Kurtubiu shtron edhe mendimin e El-Maverdit se nga *këmisha* mund të nxirren tri mësimë:

1) Ardhja e djemve me këmishën me gjak të rrejshëm;

2) Këmisha e shqyer (grisur) nga ana e pasme nga gruaja e Ministrit dhe;

3) Kur sillet këmisha para Jakubit tashmë të verbër dhe kur atij i kthehet të pamurit të cilin e kishte humbur duke qajtur dhe nga pikëllimi për Jusufin e tij.

Vazhdimi i rrëfimit sqaron shumë gjera:

“Jakubi pas këtij lajmi ka qajtur, pastaj u tha djemve: ‘Ma tregoni këmishën e tij!’ Dhe ata ia treguan. Ai i mori erë dhe e puthi, pastaj vazhdoi ta puthë, por hetoi se në të nuk ka të grisura as që këmisha është e shqyer. Pastaj tha: ‘Për Zotin, që nuk ka hyjni tjetër përveç Atij, nuk kam hasur në ujk më të mençur se sa ky i fundit. E ka ngrënë djalin tim, e nxorri nga këmisha e tij e që gjatë

⁶⁹ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 149. Krhs.: *Prijevod Kur’ana-RA*, op. cit., fq. 888-889. M. A. Sabuni, op. cit., fq. 44.

kësaj as nuk e ka shqyer! Nga kjo u bind se kjo nuk është e vërtetë ajo që djemtë e tij ia kanë sjellë si arsyetim.⁷⁰

Pas kësaj intrige Jakubi heton se gjerat nuk janë të qarta dhe mbështetet në "durim i mirë" (فَصَبْرٌ جَمِيلٌ - *sabrun xhemil*) për shkakun që i kishte ndodhur. Durimi (sabri) sikurse në togfjalëshin "Vërtet durimi është gjë e mirë" do të paraqitet si përgjigje kur djemtë më vonë ia sjellin lajmin për humbjen e djalit të dytë, Benjaminsit, i cili mbeti i burgosur në Egjipt.⁷¹

Burgimi në të vërtetë ishte skenar i Jusufit në mënyrë që vëllain e tij, Benjaminsin, ta mbajë afër vetes.

Mësimin mbi durimin që nxjerr Kurtubiu nga përgjigjet e Jakubit a.s. është se ai që mashtron njëherë, thenë premtimin dhe gjënë e besuar nuk mund t'i besohet as më vonë, edhe pse mund të ndodh që mos të jetë fajtor, sikurse është rasti me vëllezërit e Jusufit që në rastin e dytë nuk ishin fajtorë për burgosjen e Benjaminsit.⁷²

Nga intrigat dhe veprimet e djemve të Jakubit ndaj Jusufit mësojmë edhe diçka. Xhelozia dhe pesimizmi i shfaqur te ata shpie nga gabimi në gabim, nga një mëkat në shumë mëkate të reja, sikurse:

Kur vëllezërit e Jusufit vendosën ta ndajnë Jusufin nga babai dhe nga vëllai i vogël Benjaminsin, në rrugën e sendërtimit të synimit të tyre u shërbyen me mëkate të ndryshme:

- Gënjen nga disa herë, duke u mbrojtur rrejshëm;

⁷⁰ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 150.

⁷¹ Prijevod Kur'ana-RA, op. cit., fq. 889.

⁷² El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 149-151.

- Babait të tyre ia treguan këmishën e të njomur me gjak të rrejshëm;

- Te babai i erdhën natën, duke qajtur, që terri i natës t'ua mbulojë disa rrena.⁷³

Po ashtu, rrëfimi mbi Jusufin tregon se një e keqe mund të jetë më e vogël se një e keqe tjetër, sikurse është rasti i hedhjes së Jusufit në bunar, e cila është e keqe me e vogël se sa ta kishin mbytur Jusufin. Ky parim, që njihet edhe në të drejtën islame, se ndërmjet dy të këqijave duhet të zgjedhet e keqja më e vogël, duhet të shërbejë si model për jetën e njerëzve. Kjo ishte edhe një arsye që mëkati i vëllezërve të Jusufit të jetë më i vogël.⁷⁴

Nga tërë kjo e theksuara mund të përmbledhet si vijon:

- Jusufi ndjeu përçmim për shkak të vëllezërve të tij tradhtarë;

- Jakubi i qe dhënë pikëllimit për shkak të humbjes së djalit;

- Vëllezërit e Jusufit triumfuan kundrejt vëllait Jusufit;

- Tregtarët llogaritën në fitimin e tyre.⁷⁵

⁷³ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

⁷⁴ Ibid.

⁷⁵ M. A. Sabuni përmend edhe një sprovë për Jusufin, robërimin dhe shitjen e tij. Shih: M. A. Sabuni, op. cit., fq. 44.

Universi i Jusufit a.s.

- Jusufi në Egjipt
- Zulejhaja entuziazmohet para bukurisë së Jusufit dhe shpifja ndaj tij
- Jusufi në burg fton në besim të vërtetë
 - Ëndrrat e Mbretit

وَكُلًّا نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ
وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ

"Të gjitha këto që t'i rrëfyem ty nga lajmet e pejgambereve, janë që të forcojnë zemrën tënde dhe në to të ka ardhur e vërteta e këshilla si dhe vërejtje për besimtarët." (Kur'ani, Hud /11/, 120)

Jusufi shitet si skllëv në Egjipt

Pas prezantimit të komplotit, intrigës të cilën vëllezërit ia bënë Jusufit të ri, Kur'ani vazhdon rrëfimin mbi Jusufin. Jusufin në bunar e gjenë karvani. Në këtë kohë funksiononte sistemi skllavopronar. Tregtarët që e gjetën Jusufin synonin ta shesin atë, por ndonëse tregtarë, ata megjithatë nuk i kushtuan kujdes shitjes së levërdishme.⁷⁶ Të kënaqur që e gjetën, ata e marrin dhe e dërgojnë në Egjipt.⁷⁷ Sigurisht ky ishte vullneti hyjnor.

وَجَاءَتْ سَيَّارَةٌ فَأَرْسَلُوا وَارِدَهُمْ فَأَدْلَى دَلْوَهُ قَالَ يَا بُشْرَى هَذَا غُلَامٌ وَأَسْرُوهُ
بِضَاعَةً وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِمَا يَعْمَلُونَ وَشَرَوْهُ بِثَمَنٍ بَخْسٍ دَرَاهِمَ مَعْدُودَةٍ وَكَانُوا فِيهِ مِنَ
الزَّاهِدِينَ

⁷⁶ Mahlufi (fq. 304-305) mendon se ujëmbushësi i karvanit dhe shokët e tij më të ngushtë e fshehën Jusufin nga pjesa tjetër e karvanit, për t'iu shmanhur ndarjes së parave nga shitja e tij. Sipas: Enes Karic, op. cit., fq. 237, fusn. 4.

⁷⁷ M. A. Sabuni, op. cit., fq. 44-45.

“Dhe erdhi një karvan, dhe e dërguan ujëmbushësin e tyre që të mbushë ujë me kovë. “Sihariq”, bërtiti ai, “ja një djalosh”! Dhe ata e fshehën si mallë tregtar, kurse All-llahu e dinte mirë se ç’bënë ata. Dhe e shitën me një çmim përbutës, për disa dirhem; mezi pritën që atë ta heqin qafe.” (12:19-20).

Nëse teksti analizohet me vëmendje do të shohim se tashmë ekziston paralajmërimi në fjalët e njërit prej vëllezërve të Jusufit, i cili kundërshtoi planin e vëllezërve që Jusufi të mbytet⁷⁸ (...*Mos e mbytni Jusufin, por hedhnie në fund të ndonjë bunari, do ta gjejë ndonjë karvan – nëse njëmend dëshironi të bëni diçka me të...*), sikur që ekziston edhe paralajmërimi në fjalët e vëllezërve të Jusufit kur arsyetohen para babait të tyre në fjalët e Jakubit (... *dhe frikësohem se mos do ta hajë ujku ...tha Jakubi*). Është evidente lidhshmëria e fuqishme dhe intenzive e tekstit dhe rrjedhës së rrëfimit që e shpreh Kur’ani.

Kemi edhe disa momente relevante të ndodhia dhe shitblerja e Jusufit, që kanë rëndësi shumë të madhe për ardhmërinë e tij. Sikur Jusufi të shitej si fëmijë i ndonjë personaliteti, do të kalonte shumë më keq. Mirëpo, ai u shit si mall tregtar. Po ashtu, egjiptianët i përçmonin popujt e feve të tjera. Edhe kjo çështje ndikoi që Jusufi të kalojë lehtë. Edhe momenti vijues është interesant. Edhe pse Jusufi dallohej me bukuri të jashtëzakonshme, këtë tregtarët nuk e vërejtën. Tregtarët po ashtu e cilësuan Jusufin vetëm “si

⁷⁸ Ibn Abbasi pohon se këto fjalë janë të vëllait më të vjetër jehudhës. Muxhahidi mendon se ky quhej Shem’un, kurse Katade thotë se quhej Rubejl. Edhe Ibn Kethir mendon se quhej Jehudha. Sipas: Dzermaludin Latic, Stil..., op. cit., fq. 374.

një fëmijë”, që mendoj, është shprehje e Urtësisë së All-llahut, për ta mbrojtur Jusufin.⁷⁹

Kur arritën në Memfis, kryeqytetin e Egjiptit të atëhershëm, tregtarët Jusufin e pastruan dhe e veshën me rroba të reja, e qitën në treg për ta shitur. Tregu ishte pikëtakim i tregtarëve nga Siria, Bizanti, Abisinia, Jemeni etj. Aty shitej mëndafsh, argjend, bakër, flori, por edhe robër, sklevë. Këtë trajtim e pati edhe Jusufi.⁸⁰ Jusufin e bleu nëpunësi i lartë i pallatit të mbretit, i quajtur Aziz,⁸¹ sipas Biblës Potifari, që pajtohet me disa transmetime që i sjell Kurtubiu.⁸² Jusufi në këtë familje siguroi qenien e vet, por edhe edukimin e mirë.

Sipas Suhejlit dhe Ibn Abbasit ky zotëri i lartë emrin e kishte Katfir.⁸³ Ceket se ai ishte ministër i thesarit të mbreti⁸⁴, kurse gruaja e tij quhej Zulejha. Emri Zulejha nuk përmendet në Kur’an, por tradita e njeh me

⁷⁹ Harun Yahya, op. cit., fq. 39.

⁸⁰ Imam Vehbi Ismaili, Jusufi i drejt, op. cit., fq. 34.

⁸¹ Imam Vehbi Ismaili, Historia, II, op. cit., fq. 7-8.

⁸² El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 155 e tutje. Sipas burimeve mendohet se ‘aziz’ quheshin njerëzit me ndikim në mbretëri. Më vonë, kur u bë ministër, edhe Jusufi quhej *aziz*. Shih: El-Menar, sipas: *Prijevod Kur’ana-RA*, op. cit., fq. 891. Sipas burimeve biblike, mendohet se Jusufin e gjetën në bunar tregtarët migjanas, dhe ia shitën Potifarit, komandantit të rojes trupore të sunduesit. Disa Potifarin e quajnë Zafir, e disa Katfir, kurse gruan e tij e quajnë Zulejha. Disa mendojnë se emri Zulejha është pseudonim e jo emri i vërtetë i saj. Hafiz Ibn Kesir, *Kazivanja...*, op. cit., fq. 265 ... Mendohet se në Egjipt atë kohë kanë sunduar Hiksët, kurse sunduesi quhej Ibn Rejjan Velid, amelikan-semit. Sipas Biblës Jusufi ka jetuar rreth vitit 1647-1564. Sipas: Mustafa Spahic, *Povijest islama*, Travnik, 1997, fq. 64-65. Edhe Abdulvehhab En-Nexhhar pohon se sunduesi ishte amelikan. Ibid.

⁸³ Edhe Zamahsherij e përmend sunduesin e Egjiptit me emrin Katfir. Shih: Ez-Zamahsherij, *El-Keshshaf*, libri II, Bejrut, pa vit botimi, fq. 248.

⁸⁴ Walter Beltz, op. cit., fq. 104. Krhs.: S. Kutb – B, op. cit., fq. 211.

këtë emër. Zulejha ishte vajza e motrës së Rejjan bin Velidit, mbretit të Egjiptit.⁸⁵ Ky zyrtar i lartë administronte me depot e mbretit dhe kishte fuqi dhe ndikim të jashtëzakonshëm. All-llahu bëri që ky njeri ta dojë Jusufin dhe t'ia besojë punët e shtëpisë së tij.

وَقَالَ الَّذِي اشْتَرَاهُ مِنْ مِصْرَ لِمَرْأَتِهِ أَكْرِمِي مَثْوَاهُ عَسَىٰ أَنْ يَنْفَعَنَا أَوْ نَتَّخِذَهُ
وَلَدًا وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ وَلِنُعَلِّمَهُ مِن تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ وَاللَّهُ غَالِبٌ
عَلَىٰ أَمْرِهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

“Kurse ai njeriu nga Egjipti që e bleu i tha gruas së tij: “Bëni qëndrim të këndshëm! Ndoshta na bëhet i dobishëm por edhe mund ta birëzojmë”. Ja kështu ne Jusufit në Tokë vend të mirë i dhuruam dhe me shpjegimin e ëndrrave e mësuam – All-llahu ka fuqi ta zbatojë vendimin e Tij, por shumica e njerëzve këtë nuk e dijnë.” (12: 21).

Pasi që zyrtari i lartë e pranoi mirë dhe në bisedë me gruan e tij paralajmëroi se ndoshta do ta birëzojë, sepse nuk kishte fëmijë⁸⁶, Kur’ani tregon se All-llahu i ka dhënë begati Jusufit, jetë komode dhe qëndrim të sigurtë dhe e përmbushi atë që më herët i ka paralajmëruar se do të mësohet me shpjegimin e ëndrrave, që e konfirmon ajeti kur’anor:

وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُ آتَيْنَاهُ حُكْمًا وَعِلْمًا وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ

Dhe kur ai arriti pjekurinë, dhe e pajisëm me urtësi⁸⁷ dhe dituri. Ashtu ne i shpërblejmë mirëbërësit. (12:22).

⁸⁵ Abdu-l-Mun’im El-Hashimijj, *Mu’dzize vjerovjesnika*, Sarajevë, 2003, fq. 142. Disa autorë emrin e Zulejhasë e përdorin në trajtën Zelihaja. Fjala është për një person.

⁸⁶ Harun Yahya, op. cit., fq. 40.

⁸⁷ Ndonëse Sherif Ahmeti shprehjen حُكْمًا (*hukmen*) e përkthen si “pushtet”, thuajse të gjitha komentet në origjinal, por edhe përkthimet në shqip dhe boshnjakisht këtë shprehje e përkthejnë si “urtësi”. El-Eshkar shprehjen

Në këtë ajet duhet ta kemi parasysh togfjalëshin " وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ – *ve kedhalike nexhz'il-muhsinin*", sidomos në fjalën e fundit "muhsinin" (në njëjës "muhsin"), e cila do të thotë: ai i cili bënë mirësi, respektivisht *mirëbërësi*. Këtë atribut Jusufi do ta bartë gjithnjë dhe këtë do t'ia pranojnë të gjitha palët në historinë e tij jetësore.⁸⁸

hukmen e shpjegon si el-nubuvvetu – peygamberi dhe *ilmen* e shpjegon si: dituria në fe dhe dituria në ëndrra. Sipas: El-Eshkar, op. cit., fq. 305. Edhe M. A. Sabuni shprehjen حُكْمًا (*hukmen*) në këtë kontekst e shpjegon si "urtësi, mençuri", e jo si pushtet. Sipas: M. A. Sabuni, op. cit., fq. 45.

⁸⁸ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 191 e tutje. Shprehjen الْمُحْسِنِينَ (*muhsinîn*) Jusuf Ali e kupton si "ata që sillen mirë dhe bëjnë vepra të mira". Jusuf Ali, op. cit., fq. 558. Sabuni shprehjen الْمُحْسِنِينَ (*muhsinin*) e kupton si "bëmirësi në veprat e tyre". M. A. Sabuni, op. cit., fq. 45.

Bukuria e Jusufit dhe dredhia e Zulejhasë

Kultura dhe qytetërimi islam, sidomos letërsia, e frymëzuar me ajetet e kësaj kaptine, do të shkruajë dhe këndojë skena të shumta dashurie.⁸⁹ Jusufi, kështu, do të bëhet simbol i besimit, i dëlirësisë, virgjërisë, fuqisë djaloshare në All-llahun dhe këtë para sprovës më të madhe për njerëzit e ri. Sprova para të cilës gjendej Jusufi ishte e madhe edhe për shkakun se Jusufi ishte shumë i bukur por edhe nga shkakun se Zulejhaja ishte vështirë të refuzohej. Sepse, jo vetëm që ishte shumë e bukur, por edhe kishte ndikim të madh politik, si gruaja e njeriut më të fuqishëm në pallat pas vetë Mbretit.

Ibn Kethiri thekson se gruaja e ministrit ishte dashuruar tmerrshëm në Jusufin për shkak të bukurisë, sjelljes dhe edukatës së tij dhe kjo bëri që Jusufin ta bëjë për vete.⁹⁰ Kjo do të thotë se besimtari me shpirt do të ndiejë dëshirë për diç që me fe është e ndaluar, por thelbësore është që njeriu mos të bie nën ndikimin e epsheve dhe me vullnetin e tij të mos shkel kufijtë e caktuar nga Krijuesi.

S. Kutbi pohon se “rrëfimi sheshoi shumë dobësi njerëzore, ndër të cilat edhe ato seksuale, pa kurrfarë

⁸⁹ Edhe Ahmed Gazali është shërbyer me Tregimin e Jusufit dhe Zulejhasë në Kur’an. Kjo lehtë vërehet në librin e tij *Sewanih: Ahmed Gazali, Knjiga o ljubavi*, Sarajevë, 2003/1424 h., fq. 18.

⁹⁰ Ibn Kethir, op. cit., II, fq. 622.

zbukurime në pasqyrimin e shpirtit njerëzor, realisht në të gjitha vendet dhe pa braktisjen e cilitdo tipar apo qëndrim njerëzor. Mirëpo, përkundër kësaj gjendjeje, rrëfimi nuk është shndërruar në moçalë neveritës për natyrën e shëndosh njerëzore, çfarë ndodh në kohën e xhahilijetit të shekullit XX dhe XXI në kohën e realizmit dhe naturalizmit.⁹¹

Kur'ani këtë skenë e përshkruan në ajetet 23-30:

وَرَأَوَدْتُهُ الَّتِي هُوَ فِي بَيْتِهَا عَنْ نَفْسِهِ وَغَلَّقَتِ الْأَبْوَابَ وَقَالَتْ هَيْتَ لَكَ قَالَ
مَعَاذَ اللَّهِ إِنَّهُ رَبِّي أَحْسَنَ مَثْوَايَ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ

“Dhe ajo në shtëpinë e së cilës gjendej ai, filloi ta nxisë atë në mëkat; i mbylli të gjitha dyert dhe i tha: “Eja ti!” Ai tha: “Ruajna Zot!” “Zotëriu im është kujdesur ndaj meje dhe me siguri të padrejtët nuk do të shpëtojnë.” (12: 23).

Fillimi i ajetit 23 tregon joshjen dhe spitullosjen e ngadalshme e të lehtë nga ana e gruas së Ministrit.⁹² Sipas Kurtubiut, këtë na dëshmon rrënja e foljes (r-v-d), në këtë rast të përdorur në llojin e tretë (*râvede – murâvedetun*) që me parafjalën (عَنْ - 'an) në konstrukcionin me fjalën (نَفْسِهِ - *nefsihi*) domethënë tërë këtë ta bësh “kundër vullnetit të dikujt”.⁹³

⁹¹ S. Kutb – B, op. cit., fq. 196-197.

⁹² Mendohet se Jusufi erdhi në shtëpinë e ministrit në moshën 14 vjeçare, sepse Kur'ani e cilëson me shprehjen *gulam*. Kjo fjalë dmth. 14 vjeçar, as më shumë as më pak. Pastaj vjen cilësimi *feten* – djalosh, pastaj *shab* - burrë i ri dhe *rexhul* – burrë i pjekur. Mendohet se dashuriçkat e gruas së ministrit filluan nga puberteti i Jusufit e deri kur ndodhi ngjarja e pakëndshme, kur Jusufi kishte rreth 25 vjet. Sipas: S. Kutub, *Fi dhilal'il-Kur'an*, apo: S. Kutb – B, op. cit., fq. 246.

⁹³ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 162.

Pason thirrja e hapur nga ana e gruas së Ministrit me fjalët (هَيْتَ لَكَ – *hejte leke*) që do të thonë: eja, hajde, ecë, përpara, afrohu ... Kurtubiu thekson se ky konstrukcion mund të lexohet në shtatë kiraete (lexime) të pranuarra të Kur'anit.⁹⁴

Pason ajeti:

وَلَقَدْ هَمَّتْ بِهِ وَهَمَّ بِهَا لَوْلَا أَنْ رَأَى بُرْهَانَ رَبِّهِ كَذَلِكَ لِنَصْرِفَ عَنْهُ السُّوءَ
وَالْفَحْشَاءَ إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُخْلَصِينَ

“Dhe ajo e dëshiroi atë, por edhe ai ate do ta dëshironte sikur të mos e kishte parë dëshminë nga Krijuesi i tij⁹⁵. Dhe kështu nga ai të keqen dhe imoralitetin e mënjanuam, sepse ai me të vërtetë ishte nga robërit tanë të sinqertë. (12:24).

Për këtë çast Kur'ani nuk ofron hollësi. Në çfarë mënyre dhe ç'bëri gruaja e Ministrit për ta joshur dhe përvetësuar Jusufin. Kurtubiu shtron disa transmetime lidhur me këtë çështje:

“O Jusuf, çfarë fytyrë të bukur të formësuar ke!”
“Në bark e ka formësuar zotëriu im” – u përgjigj ai.
“Jusuf! Ke flokë të bukura” - shtoi ajo. Në këtë ai u përgjigj: “Kjo është gjëja e parë që do të kalbet në varrë.” Pastaj ajo vazhdoi: “Ke sy të bukur, o Jusuf!”
“Me ta shikoj Krijuesin tim” – iu përgjigj ai. Ajo bërtiti: “Jusuf! Ngrite shikimin tënd, më shiko në sy.” “I frikësohem verbërimit në Ahiret!” – u përgjigj ai. Pastaj i tha ajo: “Jusuf, unë ty të afrohem, ndërsa ti nga unë shmangesh!?” “Me këtë dëshiroj ta arrijë afërsinë

⁹⁴ Ibid. Shih edhe: Enes Karic, op. cit. 238, fusn. 1; Shih edhe: *Mexhmu'u Fetawa shejh'ul-islami Ahmed Ibn Tejmijeh*, libri XV, Kairo, 1404 h., fq. 111.

⁹⁵ Zamahsheri mendon se domethënia morale e virtytit qëndron në faktin që dëshirat e gabueshme të ngadhënjehen në vete e jo në mungesën e dëshirave të tilla. Muhammed Asad, op. cit., 331, fusn. 23.

e Krijuesit tim!” – u përgjigj Jusufi. Pastaj ajo vazhdoi: “Jusuf, dhomën e kam shtruar për ty, eja, hy me mua, askush nuk do të shehë!” “Ajo dhomë nuk do të më mbulojë nga Krijuesi im” – u përgjigj ai. “Jusuf, ta kam shtruar shtratin nga mëndafshi. Ecë! Plotësoje dëshirën time.” – tha ajo ...⁹⁶

El-Mewdudi mendon se “dëshmia e Zotëriut të tij do të thotë frymëzimin hyjnor i cili e ka zgjuar ndërgjegjen e tij dhe i ka shpjeguar se nuk ia vlen nëse pranon provokimin e saj. Kjo shpjegon edhe parimin se të dërguarit e All-llahut janë të pagabueshëm, por shpjegon faktin se ata edhe pse janë njerëz dhe mund të gabojnë, ata janë aq të ndershëm dhe të dinjitetshëm për lidhjen e tyre me Zotin sa që kurrë nuk mund të kultivojnë qëllime të këtilla të këqija.⁹⁷ Por, edhe nëse ndodh që joqëllimisht të jepet pas ndjenjave të tij, All-llahu do ta kthejë në rrugë të drejtë me shpalljen e Tij.⁹⁸

Ndonëse ekzistojnë edhe disa transmetime të paqëndrueshme për personalitetin e një peygamberi, atë që thekson Kurtubiu, ato nuk kundërshtojnë Kur’anin dhe Sunnetin, por pasqyrojnë gjendjen nëpër të cilën ka kaluar Jusufi a.s.⁹⁹

⁹⁶ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 162 e tutje ose: <http://islam.dzemat.org/modules.php?name=News&file=article&sid=330>.

⁹⁷ Jusufi ishte rritur, edukuar dhe arsimuar në ambient të ngrohtë peygamberik, por në çast ai ndjeu dobësi para ofertës së femrës. Mirëpo, diç e tërhoqi, e shpëtoi nga ky gabim dhe mbeti i fuqishëm. Shih: S. Kutb – B, op. cit., fq. 201.

⁹⁸ El-Mewdudi, sipas: *Prevod Kur’ana –RA*, op. cit., fq. 895.

⁹⁹ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq.165 e tutje.

Këshillat dhe mësimet e këtyre rrëfimeve mbi Jusufin a.s. përshkruajnë mënyrën se si duhet të ruhet besimtari i mirëfilltë me mëshirën e Zotit nga e keqja, gabimi dhe mëkati.

Këtu kemi disa çështje të rëndësishme:

- Edhe pse njerëzit pretendojnë për bukuri, bukuria e Jusufit a.s. është e patejkalueshme;

- Edhe pse provokimet, sfidat para njerëzve janë të mëdha, provokimet dhe sfidat e Jusufit janë më të mëdhatë, sepse refuzoi një ofertë aq joshëse, siç ishte oferta e gruas së njeriut më të fortë, pas mbretit, në mbretërinë e Mbretit.¹⁰⁰

Jusuf Ali komenton se dashuria e Zulejhasë ishte e kalueshme, botërore dhe e padenjë për Jusufin. Dashuria botërore e Zulejhasë ishte dashuri e ulët, e interesave vetjake, kurse dashuria e Jusufit ishte shpirtërore dhe e pakufizuar në aspektin botëror. Jusufi tashmë ishte i pjekur për detyra më të mëdha, por jo edhe Zulejhaja, e cila vetëm më vonë do ta arrijë një shkallë më të lartë.¹⁰¹

Sipas El-Kurtubiut, me transmetim të Ibn Abbasit r.a., epshi i paraqitur te Jusufi është vënë nën kontrollin e kriterit të *pagabimësisë peygamberike* (...*el-ma'sûmîne min'ez-zinâ`*).¹⁰² Epshi i paraqitur, sipas komentimit të tyre, është përplotësimi i kriterit tjetër që duhet ta

¹⁰⁰ Shih mendime interesante: Abd Al-Wahab Bouhdiba, *Seksualiteti në Islam*, Gjilan, 2001, fq. 26 e tutje.

¹⁰¹ Shih observime interesante: Jusuf Ali, op. cit., fq. 558.

¹⁰² Ebu Tahir Muhammed Ibn Jakub El-Fejruzuabadi Esh-Shafii, *El-Kur'an'ul-kerim we bi hamishihî Tenvir'ul-mikbasi min tefsiri Ibn Abbasi*, botimi I, Katar, 1409/1988, margjina e faqes 238.

plotësojë çdo peygamber, e ai është *ruxhulijeti* (burrëria). Mendoj se komentuesit e Kur'anit kanë të drejtë që theksojnë këtë kriter, sepse vetëm me plotësimin e këtyre kritereve Jusufi a.s. do të meritonte të bëhet peygamber i All-llahut.¹⁰³

Pagabimësia te Jusufi a.s. është intervenim i drejtpërdrejtë i All-llahut të madhëruar. Ky intervenim është manifestuar nëpërmjet *burhanit* (argumentit) të cilin e pa Jusufi a.s.. Hazreti Aliu r.a. mendon se *burhani* i përmendur në Kur'an është veprimi i Zulejhasë duke e mbuluar idhullin e që gjendej në shtëpinë e saj. Jusufi e pyeti: "Ç'bën?" Ajo u përgjigj: "Më vjen turp nga zoti im nëse më sheh kështu çfarë jam!" Në këtë klithi Jusufi: "Për mua është përparësi t'i turpërohem All-llahut!" Kurtubiu mendon se ky është shpjegimi i *burhanit*, të cilin dijetarët e mbështesin në komentimin e hazreti Aliut r.a..

Shtrohet edhe një çështje, çështja e gjykimit të dëshmitarit. Me çka dëshmoi ai, nga prova apo nga indicioni? Sipas të gjitha gjasave, dëshmitari (shahid) dëshmoi sipas indicionit. Në rastin konkret, duke analizuar këmishën dhe vendin e ngjarjes, dëshmitari gjykon në anën e Jusufit a.s. Ndonëse ka tentime të thuhet se dëshmitari ishte një i afërm i Zulejhasë, Kur'ani nuk e lejon këtë shpjegim, sepse *dëshmitari* në islam nuk mund të jetë fëmijë, por i moshës madhore dhe i pjekur.¹⁰⁴

¹⁰³ Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 124. Muhammed El-Gazaliu, Jusufin e përshkruan si personifikim të nderit dhe burrërisë, të edukatës së shpirtit dhe të kënaqësisë së All-llahut të lartësuar. Sipas: Muhammed El-Gazali, op. cit., fq. 253.

¹⁰⁴ Imam Vehbi Ismaili, *Historia, II*, op. cit., fq. 11. Ibn Kethir-Ar, op. cit., fq. 30.

Kjo edhe për arsye sepse në problemin e kurvërisë, zakonisht femra merrë nismë. Këtë e provon edhe Kur'ani por edhe psikologjia.¹⁰⁵

Kurtubiu vazhdon të theksojë se Jusufi a.s. në momentin e pranimit të provokimit të Zulejhasë, të mashtrimit të tij, në tavan ka shikuar të shkruar ajetin kur'anor "*Dhe mos iu afroni kurvërisë (zinasë), sepse vërtet ajo është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.*" (El-Isra, 32).

Ibn Abbasi thekson se meleku Xhibrili nga *Pllaka e ruajtur mirë* (Lewhi mahfudhi) ka sjellur ajetin kur'anor "*Kurse ndaj jush kanë përcjellësit*", (El-Infitar, 10), të cilin ia dëftoi Jusufit a.s.. Transmetohet se Jusufi a.s. ka dëgjuar zërin: "*O Jusuf, Ti je i shkruar në librin e peygamberëve.*" Madje theksohet se Jusufi a.s. pa edhe fytyrën e babait të tij, Jakubit a.s..¹⁰⁶ Pas të gjitha këtyre Jusufi a.s. iku.¹⁰⁷ Mahlufi faktin se Jusufi e pëlqeu Zulejhanë e shpjegon të pa pasion, të pa mëkat, sepse kjo është sikurse që njeriu gjatë agjërimit sheh dhe e dëshiron ushqimin, por nuk e shijon atë.¹⁰⁸

¹⁰⁵ Shih për këtë: Mustafa Mahmud (mjek), *Dialog me mikun ateist*, Prizren, 2000, fq. 91-92. Krhs.: Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

¹⁰⁶ Gjerësisht: El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 169 e tutje. Shih edhe: Ebu Tahir Muhammed Ibn Jakub El-Fejruzuabadi Esh-Shafii, op. cit., fq. 238.

¹⁰⁷ Krahas abstenimit të Jusufit nga gruaja e Ministrit për shkak të besimit të mirëfilltë ndaj Zotit, edhe pse edhe ai ra në dashuri me te, faktori që ndikoi të largohet nga ajo ishte edhe paraqitja e pamjes së Jakubit a.s., babait të tij, para syve. Shih: Walter Beltz, op. cit., fq. 104. Sipas po këtij burimi, Jusufi e martoi Zulejhanë me dëshirën e mbretit, dhe jetuan një kohë të gjatë. W. Beltz, op. cit., fq. 105. Sipas burimit tjetër, mbreti, pas vdekjes së Ministrit, Zulejhanë e martoi me Jusufin dhe nga kjo martesë kishte dy djemë: Efrasimin dhe Menshain. Abdu-l-Mun'im El-Hashimij, op. cit., fq. 162. Shih gjerësisht për këtë: Osman Nuri Topbash, op. cit., fq. 67-68.

¹⁰⁸ Mahlufi, fq. 305, sipas: Enes Karic, op. cit., fq. 238, fusn. 2.

Komentohet se refuzimi i Zulejhasë nga ana e Jusufit a.s. është bërë për tre arsye, të cilat përmbledhur me gojën e Jusufit a.s. do të ishin:

- Jo vetëm unë (Jusufi) por edhe ti (gruaja e Ministrit) duhet përmbushur detyrimet ndaj burrit tënd (Ministrit);

- Njerëzia dhe kujdesi me të cilin më ka pranuar Ministri më obligojnë me mirënjohje të madhe;

- A nuk sheh se kjo është vetëm epsh i keq dhe se e keqja nuk shpie në të mirë.¹⁰⁹

Është interesant që këto shpjegime të përcillen me vazhdimin e rrëfimit kur'anor:

وَاسْتَبَقَا الْبَابَ وَقَدَّتْ قَمِيصَهُ مِنْ دُبُرٍ وَأَلْفَيَا سَيِّدَهَا لَدَى الْبَابِ قَالَتْ مَا جَزَاءُ مَنْ أَرَادَ بِأَهْلِكَ سُوءًا إِلَّا أَنْ يُسْجَنَ أَوْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“Dhe ata të dy vrapuan kah dera, kurse ajo nga prapa e grisi këmishën e tij – dhe burrin e saj skajë derës e takuan. Ajo tha: “Çfarë është dënimi për atë i cili dëshiron t’i bëjë keq familjes tënde, (çka) tjetër pos burgosje apo edhe dënim më të dhembshëm!” (12: 25).

Filluan arsyetimet dhe akuzat e gruas së Ministrit se atë e ka sulmuar Jusufi. Mirëpo, meqë faktet e pafajësisë ishin në anën e Jusufit, problemi për një kohë u heshtë. Këmisha e shqyer nga shpina dhe dëshmitari që dëshmoi në favor të Jusufit ishin provat kryesore.¹¹⁰ Për pafajësinë e Jusufit flasin edhe disa argumente të rëndësishme:

¹⁰⁹ Jusuf Ali, op. cit., fq. 558.

¹¹⁰ Komentuesit e Kur’anit kanë mendime të ndryshme rreth shprehjes *dëshmitar* (shahid). Mendimi më i pranuar është ai që zë fill në hadithin e Muhammedit a.s., e të cilin e transmeton Buhariu: “Në djep vetëm tre vetë kanë folur” dhe me këtë rast përmendi dëshmitarin e Jusufit a.s.. Sipas: El-

1) All-llahu i madhëruar pohon pafajësinë e Jusufit: “... ishte nga robërit tanë të singertë.” (Jusuf, 24).

2) Djalli e pohon pafajësinë e Jusufit: “Pasha madhërinë tënde – tha ai - me siguri të gjithë do t’i shpjerë në rrugë pa krye. Përveç robërve të Tu të singertë nga mesi i tyre.” (Sad, 82-83).

3) Dëshmitari nga familja e sunduesit pohon pafajësinë e Jusufit a.s.: “Por, nëse këmisha e tij është e grisur nga prapa, atëherë ajo gënjen kurse ai fletë të vërtetën.” (Jusuf, 27).

4) Pafajësinë e Jusufit më vonë e shpreh edhe vetë gruaja e Ministrit, Zulejhaja, akteri kryesor i tërë kësaj ngjarjeje.¹¹¹

5) Pafajësinë e Jusufit e provon edhe qëndrimi mendjeshëndoshë dhe inteligjent i vetë Jusufit karshi Ministrit (burrit të gruas në fjalë). Në çastet kur të tjerët dorëzohen, ai me gjakftohtësi pohon se “Ajo mu vërsul mua”!¹¹² etj.

Mirëpo, përkundër të gjitha këtyre argumenteve përfoljet në qytet rreth veprimeve të gruas së Ministrit dhe autoriteti i njollosur i ministrit dhe e gruas së tij bëri që gruaja e Ministrit të ndër marrë një veprim tjetër dhe t’i ftojë në vizitë gratë autoritative të qytetit për të parë dhe për t’u bindur se me çfarë provokimi është ballafaquar ajo, duke e paraqitur Jusufin para syve të tyre.¹¹³

Lexo ajetet vijuese:

Kurtubi, op. cit., fq. 172. Ka edhe versione të tjera.

¹¹¹ Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 125.

¹¹² Sejjid Kutub, op. cit., fq. 258 e tutje. Abd Al-Wahab Bouhdiba, *Seksualiteti në Islam*, op. cit., fq. 28 e tutje.

¹¹³ Shih: Imam Vehbi Ismaili, *Historia, II*, op. cit., fq. 11-12.

قَالَ هِيَ رَاوَدْتَنِي عَنْ نَفْسِي وَشَهِدَ شَاهِدٌ مِنْ أَهْلِهَا إِنْ كَانَ قَمِيصُهُ قُدٌّ مِنْ قَبْلِ فَصَدَقَتْ وَهُوَ مِنَ الْكَاذِبِينَ ﴿26﴾ وَإِنْ كَانَ قَمِيصُهُ قُدٌّ مِنْ دُبُرٍ فَكَذَبَتْ وَهُوَ مِنَ الصَّادِقِينَ فَلَمَّا رَأَى قَمِيصَهُ قُدٌّ مِنْ دُبُرٍ قَالَ إِنَّهُ مِنْ كَيْدِكُنَّ إِنَّ كَيْدَكُنَّ عَظِيمٌ يُوسُفُ أَعْرَضَ عَنْ هَذَا وَاسْتَغْفِرِي لِذَنبِكِ إِنَّكِ كُنْتِ مِنَ الْخَاطِئِينَ وَقَالَ نِسْوَةٌ فِي الْمَدِينَةِ امْرَأَتُ الْعَزِيزِ تُرَاوِدُ فَتَاهَا عَنْ نَفْسِهِ قَدْ شَغَفَهَا حُبًّا إِنَّا لَنَرَاهَا فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ فَلَمَّا سَمِعَتْ بِمَكْرِهِنَّ أَرْسَلَتْ إِلَيْهِنَّ وَأَعْتَدَتْ لَهُنَّ مُتَّكًا وَأَتَتْ كُلَّ وَاحِدَةٍ مِنْهُنَّ سَكِينًا وَقَالَتْ أَخْرِجْ عَلَيْنَ فَلَمَّا رَأَيْتَهُ أُكْبِرْتَهُ وَقَطَّعْنَ أَيْدِيَهُنَّ وَقُلْنَ حَاشَ لِلَّهِ مَا هَذَا بَشَرًا إِنْ هَذَا إِلَّا مَلَكٌ كَرِيمٌ ﴿31﴾ قَالَتْ فَذَلِكُنَّ الَّذِي لُمْتُنَّنِي فِيهِ وَلَقَدْ رَاوَدْتُهُ عَنْ نَفْسِهِ فَاسْتَعْصَمَ وَلَئِن لَّمْ يَفْعَلْ مَا أَمَرَهُ لَيَسْجَنَنَّ وَلَيَكُونَنَّ مِنَ الصَّاغِرِينَ

“Ai tha: “Ajo mua tentoi të më mashtrojë në mëkat.”

Një dëshmitar nga familja e saj filloi të dëshmojë: “Nëse këmisha e tij është e grisur nga ana e përparme atëherë ajo fletë të vërtetën, kurse ai të pavërtetën. Por, nëse këmisha e tij është e grisur nga prapa, atëherë ajo gënjen kurse ai fletë të vërtetën. Dhe kur ai e pa se këmisha e tij është e grisur nga prapa, tha: “Kjo është një dredhi e jotja, kurse vërtetë dredhitë tuaja janë të mëdha. Ti, o Jusuf, lëre këtë, kurse ti, i tha asaj, kërko falje për mëkatin tënd, se me të vërtetë ti je ajo që ke gabuar. Dhe gratë e qytetit filluan të flasin: “Gruaja e Ministrit ka tentuar ta përvetësojë atë djaloshin e vet, në të është dashuruar tmerrësisht! Njëmend ne e shohim se ajo është në lajthitje të vërtetë!” Dhe kur ajo dëgjoi përgojimet e tyre, i ftoi ato dhe iu përgatiti ndeje (gosti) dhe secilës prej tyre i dha nga një thikë dhe (Jusufit) i tha: “Dil para tyre!”; dhe kur ato e panë atë (Jusufin) u mahnitën nga bukuria e tij dhe nëpër duart e tyre u prenë dhe thanë: “O Zot, o Zot! Ky nuk është njeri, por ky është një engjëll fisnik! Ajo tha: “Ja, kjo është për çka më keni qortuar. Përnjëmend dëshirova ta mashtroj, por ai kundërshtoi, por nëse

ai nuk pranon atë që unë e urdhëroi, në burg njëmend do ta hedhi dhe do të jetë ndër të përçmuarit!” (12, 26-32.)

Folja شَغَفَ - shegafe që është përdorur në pjesën e ajetit قَدْ شَغَفَهَا حُبًّا, (...në të është dashuruar tmerrësisht...”, sipas Zamahsheriut paraqet “qesen, faculetën e zemrës dhe mbështjellësen e saj” dhe shënon dashurinë e cila “për objekt ka krijesat e jo Krijuesin, apo edhe dashurinë e Tij”. Kjo dashuri nënkupton fuqinë, ndezshmërinë por edhe egoizmin.¹¹⁴

Por, siç lexohet në Kur’an, gruaja e Ministrit shkon edhe më tej. Ajo e kërcënon me burg Jusufin nëse ky nuk e plotëson epshin e saj.¹¹⁵ Ka të dhëna se pasi gratë e qytetit e panë Jusufin lere që ato i arsyetuan veprimet e Zulejhasë, por madje edhe ato e kërcënuan Jusufin.¹¹⁶

Më herët kemi theksuar se All-llahu e fshehi bukurinë e Jusufit me rastin e gjetjes së tij në bunar dhe me rastin e shitjes së tij në tregun e skllevërve. Por, tash, kur Jusufi u rritë dhe zhvillua, shohim se si All-llahu e tregoi tërë bukurinë e Jusufit.¹¹⁷

Mirëpo, Jusufi nuk pranon kërcënimin e Zulejhasë:

قَالَ رَبِّ السَّجْنُ أَحَبُّ إِلَيَّ مِمَّا يَدْعُونَنِي إِلَيْهِ وَإِلَّا تَصْرِفْ عَنِّي كَيْدَهُنَّ أَصْبُ إِلَيْهِنَّ وَأَكُنْ مِنَ الْجَاهِلِينَ فَاسْتَجَابَ لَهُ رَبُّهُ فَصَرَفَ عَنْهُ كَيْدَهُنَّ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

“Ai tha: “O Zoti im! Më tepër e dëshiroj burgun nga ajo çka më ofrojnë ato. Dhe nëse Ti nuk më largon prej dre-

¹¹⁴ Ahmed Gazali, op. cit., fq. 79-80. fusn. 59.

¹¹⁵ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

¹¹⁶ Abdu-l-Mun'im El-Hashimijj, op. cit., fq. 144. Dashurimi i Zulejhasë dhe i grave të qytetit me Jusufin a.s. dhe shantazhimi i saj dhe i grave të qytetit tregon edhe një fakt tjetër e ai është degjenerimi i thellë moral i shoqërisë egjiptiane. Sipas: Dzemaaludin Latic, *Stil...*, op. cit., fq. 380.

¹¹⁷ Shih: Harun Yahya, op. cit., fq. 46 e tutje.

dhisë së tyre unë mund të ndiej simpati ndaj tyre dhe të bëhem prej injorantëve". Dhe Zoti i tij e pranoi lutjen e tij dhe e shpëtoi nga dredhitë e tyre! Ai pa dyshim dëgjon dhe di shumë." (12:33-34).

Këshilla dhe mësimi nga këto ndodhi përudhin që rigorozisht duhet të kemi kujdes që mos të izolohe mi me femrat, e sidomos me ato ku mund të ketë sprovat dhe fitet. Të kemi kujdes edhe nga të dashuruarit që më vonë mund të ketë pasoja të dhembshme¹¹⁸, sikur Muhammedi a.s. thotë: *"Mos lejo që nefsi (epshi) të të shqetësojë dhe mos paso kërkesat e tij kur ka të bëjë me mosdëgjimin ndaj All-llahut, ai do të të akuzojë në Ditën e kijametit ..."*¹¹⁹ Po ashtu, kujdesi duhet të jetë sidomos ndaj dredhive të femrave, të cilat kanë prirje për këtë lloj vesi.¹²⁰

Shembulli i Jusufit duhet të shërbejë si shkolla më e mirë edhe për rastet tjera, sikur: njeriu duhet t'i robërojë All-llahut jo vetëm në çastet e mirësisë dhe rehatisë, por edhe atëherë kur ekzistojnë vështirësi dhe vuajtje. Këtë e bëri Jusufi, jashta burgut, por edhe brenda në burg, duke ftuar në fenë e vërtetë të burgosurit e ndryshëm.¹²¹

¹¹⁸ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

¹¹⁹ Ebu Hamid el-Gazali, *Ihja ulumid-din*, libri 5, Sarajevë, 2005/1426 h., fq. 164.

¹²⁰ M. A. Sabuni, op. cit., fq. 55.

¹²¹ Mendojmë se duke përdorur fjalorin e Imam El-Gazaliut, Jusufi a.s. përmban në vete karakterin (jashtësinë) dhe ahlakun (brendinë), dy shprehje që duhet të përdoren së bashku. Kjo do të thotë se Jusufi a.s. me brendinë dhe jashtësinë e mirë karakterizohet nëpër të gjitha fazat e jetës së tij. Sipas: El-Gazali, *Ihja*, libri 5, op. cit., fq. 133.

Jusufi në burg fton në besim të vërtetë

Me vullnetin e All-llahut Jusufi a.s. u ruajtë nga trillimet dhe shpifjet duke e burgosur atë. Më mirë në burg se sa në liri por duke mos thyer normat elementare morale. Jusufi u eliminua, respektivisht u largua nga skena jo pse kishte faj¹²², por për t'i qetësuar shpirtrat pas thashethemeve të zhvilluara në qytet dhe për ta ruajtur autoritetin e pushtetit. Sepse, skandali i ndodhur në pallat nuk i shkonte në favor mbretërisë. Për më tepër, kur Jusufi deri atëherë ishte qytetar i rendit të dytë.

ثُمَّ بَدَأَ لَهُمْ مِنْ بَعْدِ مَا رَأَوُا الْآيَاتِ لَيْسَ جُنَّةٌ حَتَّىٰ حِينٍ

“Pastaj u ra ndërmend që ta hedhin për një kohë në burg, edhe pse u bindën se është i pafajshëm.” (12:35).

Kur'ani nuk thekson se sa gjatë kohë Jusufi ka mbetur në burg. Shprehja (حَتَّىٰ حِينٍ – *hattâ hîn*) sipas Ibn Abbasit le të kuptohet se kjo është periudha që duhet të kalohet deri sa nuk qetësohen thashethemet që janë ngritur rreth skandalit të gruas së Ministrit.¹²³

Në vijim pasojnë ajetet që përshkruajnë jetën e Jusufit në burg:

¹²² Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 127.

¹²³ Jusufi qe burgosur nga zotëriu jo pse ishte fajtor, por pse duhej t'i bënte lëshim gruas së tij, së cilës i qe nënshtruar dhe sillej sikur deveja frerët e së cilës i mbante ajo në duar. Zamahsheri, sipas: M. Asad, op. cit., fq. 332, fusn. 34.

وَدَخَلَ مَعَهُ السَّجْنَ فَتَيَانِ قَالَ أَحَدُهُمَا إِنِّي أُرَانِي أَعْصِرُ خَمْرًا وَقَالَ الْآخَرُ
 إِنِّي أُرَانِي أُحْمَلُ فَوْقَ رَأْسِي خُبْرًا تَأْكُلُ الطَّيْرُ مِنْهُ نَبْنَأُ بِتَأْوِيلِهِ إِنَّا نَرَاكَ مِنَ
 الْمُحْسِنِينَ

“Me të në burg hynë edhe dy djelmosha; njëri prej tyre dyve i tha: “Kam parë një ëndërr sikur po shtrydhja verë”, kurse tjetri tha: unë kam parë një ëndërr se isha duke bartur mbi krye një bukë nga e cila hanin shpendët. Na shpjego këtë sepse ne e shohim se ti njëmend je njeri i mirë.” (12:36).

Sjellja e Jusufit kundrejt këtyre dy djelmoshave dhe kundrejt të burgosurve të tjerë i ngjasonte sjelljes së një të zgjedhuri dhe të dashuri të Zotit. Ai ishte në mesin e atyre që për shkaqe të ndryshme kishin rënë në telashe dhe kishin humbur shpresat. Kurtubiu sjellë dëshmi se si Jusufi i kishte trimëruar duke u dhënë shpresë dhe durim të burgosurve.¹²⁴

Sjellja e tij kishte tërhequr njerëzit që kishin qëlluar aty. Ata panë se në mesin e tyre është një njeri i mirë, me virtyte të larta morale e njerëzore. Ata e respektonin, e donin dhe kërkonin prej tij këshilla të ndryshme.¹²⁵ Të burgosurit tek Jusufi shihnin bëmirsinë, pikërisht si e përshkruan Kur’ani: *“...Na shpjego këtë sepse ne e shohim se ti njëmend je njeri i mirë.”*. Është interesant të theksohet se për të mirë e sheh vetë Allahu i madhëruar në ajetin 22 të kësaj sure. Të mirë e shohin edhe të burgosurit që shihet në ajetin 36. Por, të këtillë do ta njohin edhe vëllezërit e tij, të cilët ia

¹²⁴ Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 127-128. Abdu-l-Mun’im El-Hashimijj, op. cit., fq. 146 e tutje.

¹²⁵ Ibn Kethir-Ar, op. cit., fq. 34 e tutje.

bënë kurthën. Porosia e Jusufit është që njeriu duhet të sillet mirë në çdo gjendje dhe në çdo mjedis,¹²⁶ që shpjegon se për besimtarin nuk ka moral të dyfishtë: privat dhe publik, transparent dhe sekret, zyrtar dhe jozyrtar.

Ibn Abbasi përmend se Jusufi lënte përshtypje të jashtëzakonshme tek të burgosurit, ashtu që disa edhe kur liroheshin nga burgu, ktheheshin për vizitë tek ai. Një prej shokëve të burgut e respektonte shumë sa me një rast deklaroi: *“O Jusuf, të dua sikur askend”*. Jusufi u përgjigj: *“Kërkoj mbrojtje prej All-llahut nga dashuria jote”*. Ai me habi e pyeti Jusufin: *“Përse ashtu!”* Jusufi u përgjigj: *“Më ka dashur shumë babai im dhe vëllezërit ma bënë atë që ma bënë. Më dashti shumë zonja ime dhe erdha këtu ku më sheh edhe ti.”*¹²⁷

Jusufi në burg shpjegoi ëndërrat e dy shokëve të burgut. Njërin e gëzoi, duke i thënë se do të lirohet nga burgu kurse tjetrin e dëshpëroi, duke i thënë se do të dënohet me vdekje.¹²⁸ Është interesant se këta dy të burgosur ishin shërbetorë të mbretit të Egjiptit. Kundërshtarët e mbretit me shumë dhurata i bindën këta dy shërbetorë që mbretit t’i vendosin helm në ushqim dhe pije. Mirëpo, njëri e qiti helmin ne ushqim e tjetri megjithatë nuk e qiti. Para se mbreti ta hajë ushqimin, ai që mbretin nuk e tradhtoi reagoi duke i treguar mbretit se ç’ndodhi. Mbreti i hidhëruar i futi në burg që të dytë. Këta dy të burgosur në burg u takuan me Jusufin. Pas komentimit të ëndërrave, njëri i

¹²⁶ En-Nedevi, *Price o Bozijim Poslanicima*, Tuzla, 1425 h./2004, fq. 49 e tutje.

¹²⁷ El-Kurtubi, op. cit, IX, fq. 195. Abdu-l-Mun'im El-Hashimijj, op. cit., fq. 146.

¹²⁸ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

burgosur mori shpjegimin se do të shpëtojë nga burgu kurse tjetri se nuk do të shpëtojë. Ai që do të shpëtojë është dënuar me burg pse nuk i ka treguar mbretit me kohë, kurse tjetri do të dënohet me vdekje për shkak se ka vendosur helm në ushqimin e mbretit.¹²⁹

Ajo që pason argumenton se Jusufi të burgosurve u bënte atyre thirrje në besim edhe në ambientet e burgut:

قَالَ لَا يَأْتِيكُمَا طَعَامٌ تُرْزَقَانِهِ إِلَّا نَبَّأْتُكُمَا بِتَأْوِيلِهِ قَبْلَ أَنْ يَأْتِيَكُمَا ذَلِكَ مِمَّا
عَلَّمَنِي رَبِّي إِنِّي تَرَكْتُ مِلَّةَ قَوْمٍ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَهُمْ بِالْآخِرَةِ هُمْ كَافِرُونَ وَاتَّبَعْتُ
مِلَّةَ آبَائِي إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ مَا كَانَ لَنَا أَنْ نُشْرِكَ بِاللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ذَلِكَ مِنْ
فَضْلِ اللَّهِ عَلَيْنَا وَعَلَى النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَشْكُرُونَ يَا صَاحِبِي السَّجْنِ
أَأَرَبَابٌ مُتَفَرِّقُونَ خَيْرٌ أَمْ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ مَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِهِ إِلَّا أَسْمَاءُ
سَمِيئُوهَا أَنْتُمْ وَأَبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ إِنْ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ أَمَرَ أَلَّا
تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

“(Jusufi) tha: “Asnjë shujtë e ushqimit nuk do t’u vijë e unë të mos di t’ju them se çka do t’ju sjellin nga ushqimi para se t’ju vijë ai. Kjo është vetëm një pjesë e asaj që më ka mësuar Zoti im. Unë kam flakur fenë e popullit që nuk beson në Zotin dhe i cili mohon Botën tjetër, dhe ndjek fenë e të parëve të mi, Ibrahimit, Is’hakut dhe Jakubit. Neve nuk na ka hije që All-llahut t’i përshkruajmë asnjë rival. Kjo është mirësi e All-llahut për ne dhe për të gjithë njerëzit, por shumica e njerëzve nuk janë mirënjohës. O shokët e mi të burgut!, a janë më të mirë zotat e llojlojshëm apo All-llahu, i vetmi ngadhënjimtar? Çkado që të adhuronit pos

¹²⁹ Abdu-l-Mun’im El-Hashimijj, op. cit., fq.147-153. I burgosuri që kishte vendosur helm në ushqim dhe i cili ishte ekzekutuar ishte gjellëbërës. I burgosuri tjetër që shpëtoi, sërish filloi të punoi në pallatin e mbretit. Shih: Imam Vehbi Ismaili, *Historia, II*, op. cit., fq. 16.

All-llahut janë vetëm emra të cilëve ua keni ngjitur ju dhe të parët tuaj. All-llahu për ata kurrfarë dëshmie nuk ka shpallur, kurse gjykimi përfundimtar i përket vetëm All-llahut. Ai ka urdhëruar që ta adhuroni vetëm Atë. Kjo është feja e vetme gjithnjë e mirëfilltë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (12, 37-40).

Jusufi përhap besimin në një Zot pa marrë parasysh rrethanat. Ky është mësim për të gjithë ne se parimi kur'anor *thirrja në të mirë dhe pengimi nga e keqja* nuk pushon asnjëherë.¹³⁰ Jusufi a.s. iu ndihmon njerëzve por edhe ua shpjegon besimin e drejtë dhe ua tregon rrugën më të shkurtër.

Më tej, Jusufin e shohim se si e porosit personin (të burgosurin), ëndrra e të cilit jepte shenja shprese për të dalë nga burgu, që t'ia përkujtojë mbretit ndodhinë e Jusufit. Mirëpo, kjo nuk ndodhi për një kohë. Shejtani e pengoi (ngatërroi) përmendjen e Zotëriut të vërtetë (All-llahut).¹³¹

Sipas disa komentuesve të Kur'anit Jusufi është ai i cili ka harruar ta përmend Krijuesin, por ajeti lejon të kuptohet se ai i burgosuri që shpëtoi nga burgu është penguar nga shejtani ta përmend Jusufin para sunduesit, që ishte shkak që Jusufi të qëndrojë në burg edhe për disa vite.¹³²

¹³⁰ S. Kutb – B, op. cit., fq. 202.

¹³¹ Es-Sa'dij, Tejsir, op. cit., fq. 548. Krhs.: Ibn Tejmijeh, *Fetava*, XV, op. cit., fq. 112 e tutje.

¹³² Ibn Hibbani në Sahih-un e tij, duke folur për shkakun përse Jusufi mbeti në burg më gjatë kohë, thotë: “.... Pejgamberi i All-llahut thotë: “All-llahu e mëshiroftë Jusufin! Sikur të mos thoshte “*Më përkujto mua te zotëriu yt*”, - nuk do të kishte mbetur në burg aq sa mbeti.” Sipas: Ibn Kesir, *Kazivanja*, op. cit., fq. 274.

S. Kutb mendon se Jusufi nuk ka gabuar, duke e porositur të burgosurin që pas daljes nga burgu t'ia përkujtojë mbretit rastin e Jusufit. Ai ka vepruar si njeri, në të cilin mund të ketë edhe ndonjë dobësi njerëzore. Si çdo njeri në fatkeqësi, ai provon të gjejë mënyrë për të dalë nga burgu, por All-llahu ia tërheq vërejtjen (12, 42).¹³³

El-Mewdudi mendon se konstrukcioni i togfjalëshit duhet të identifikohet me atë që u lëshua nga burgu, e jo me vetë Jusufin. Këtë komentim e mendon të gabuar, sepse njeriu (dmth. Jusufi) që përpiket të dalë nga burgu nuk lajthon nga rruga e vërtetë.¹³⁴

Pasojnë ajetet:

يَا صَاحِبِ السِّجْنِ أَمَا أَحَدُكُمْ مَا فَيسَّقِي رَبُّهُ خَمْرًا وَأَمَا الْآخِرُ فَيصَلَّبُ فَتَأْكُلُ
الطَّيْرُ مِنْ رَأْسِهِ قُضِيَ الْأَمْرُ الَّذِي فِيهِ تَسْتَفْتِيَانِ

“O shokët e mi të burgut! Njëri prej jush do t’i japë të pijë verë zotëriut të vet, e tjetri do të jetë i gozhduar, kurse shpendët do të hanë prej kokës së tij. Çështja tashmë është vendosur për atë për të cilën më pyetët ju.” (12, 41).

وَقَالَ لِلَّذِي ظَنَّ أَنَّهُ نَاجٍ مِنْهُمَا اذْكُرْنِي عِنْدَ رَبِّكَ فَأَنسَاهُ الشَّيْطَانُ ذِكْرَ رَبِّهِ
فَلَبِثَ فِي السِّجْنِ بِضْعَ سِنِينَ

“Dhe atij nga ata të dy për të cilin mendonte se do të jetë i shpëtuar, (Jusufi) i tha: “Më përkujto mua te zotëriut”, mirëpo djalli bëri që ai të harrojë ta përmend te zotëriut i vet dhe ai (Jusufi) mbeti në burg disa vjet.” (12:42).¹³⁵

¹³³ S. Kutb – B, op. cit., fq. 203.

¹³⁴ El-Mewdudi, op. cit., fq. 906.

¹³⁵ Nga përkthimi i Kur’anit në gjuhën boshnjake nga Besim Korkut, pastaj nga Sherif Ahmeti dhe Feti Mehdiu lë të kuptohet se domethënia e ajetit është se i burgosuri që shpëtoi ka harruar ta kujtojë Jusufin para sunduesit. *Kur’an s prijevodom značenja na bosanski jezik*, përktheu Besim Korkut,

Kurtubiu pohon se Jusufin a.s. në burg e vizitoi me leku Xhibrili. Jusufi e njohu me lekun dhe i tha: "O vëllai i atyre që qortojnë! Përse të shoh në mesin e atyre që kanë gabuar ndaj ligjit?" Xhibrili a.s. u përgjigj: "O i pastërti (i biri) të pastërve, ke selam nga Krijuesi i botave, i cili të porosinë: "Ti nuk je turpëruar nga Unë dhe ke kërkuar ndihmë nga njerëzit?" Pasha madhërinë Time, do të lë në burg edhe disa vite!" Në këtë Jusufi e pyeti Xhibrilin: "A është i kënaqur Ai me mua?" "Po!" u përgjigj Xhibrili. "Atëherë çasti i daljes sime nga burgu nuk më brengos."¹³⁶

Nëse analizohet pjesa foljore e Jusufit në burg, si me të burgosurit ashtu edhe me sunduesit do të vërehet se biseda në burg është spirituale. Ai fletë si i dërguar që ekzekuton misionin e tij në raport me çdo shpirt për të cilën mendon se duhet shpëtuar.¹³⁷

Rijad, pa vit botimi, fq. 240. *Kur'ani dhe hija e tij*, botimi II, Shkup-Stamboll, 1999, fq. 239.

¹³⁶ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 196-197. Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të shumta rreth asaj se sa vjet ka qëndruar Jusufi në burg. Mirëpo, kjo çështje për synimin tonë nuk paraqet rëndësi relevante.

¹³⁷ Malik Ibn Nebi, op. cit., fq. 173.

Ëndrrat e Mbretit

وَقَالَ الْمَلِكُ إِنِّي أَرَى سَبْعَ بَقَرَاتٍ سِمَانٍ يَأْكُلُهُنَّ سَبْعٌ عِجَافٌ وَسَبْعَ سُنبُلَاتٍ
خُضْرٍ وَأُخَرَ يَابِسَاتٍ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ أَفْتُونِي فِي رُؤْيَايَ إِن كُنْتُمْ لِلرُّؤْيَا تَعْبُرُونَ

“Dhe mbreti tha: “Njëmend kam ëndërruar se shtatë lopë të liga i hanin shtatë lopë të majme, dhe kam ëndërruar shtatë kallinj të blertë dhe po aq të tjerë të tharë. O pari, ma shpjegoni ëndrrën time nëse dini t’i shpjegoni ëndërrat?” (12:43).

Sipas transmetimit që e cek Kurtubiu, mbreti që sundonte atë kohë në Egjipt quhej El-Meliku'l-Ekber Er-Rejjan El-Velid. Titulli fletë se ai ishte “Mbreti më i madh”, Rejjani i biri i Velidit. Po në këtë transmetim theksohet se Jusufin a.s. për ëndrrën e sunduesit e njoftoi meleku Xhibrili, duke e vizituar në burg dhe duke i sjellur lajm të gëzueshëm se si All-llahu xh. sh. do ta nxjerrë nga burgu dhe se shkak për këtë do të jetë ëndrra e sunduesit, të cilin Xhibrili ia rrëfeu por e njoftoi edhe me shpjegimin meritor.¹³⁸

Nga mënyra dhe ekspresiviteti i të folurit me të cilin sunduesi i drejtohet suitës së tij, nga ngjyra e zërit, le të kuptohet konfuzioni dhe shqetësimi i tij lidhur me ëndrrën që kishte parë. E ftoi suitën dhe kërkoi nga ata që t’i shpjegohen ëndërrat e pështjelluara.

قَالُوا أَضْغَاثُ أَحْلَامٍ وَمَا نَحْنُ بِتَأْوِيلِ الْأَحْلَامِ بِعَالَمِينَ

“Ata thanë: Këto janë ëndërra të ngatërruara. Ne nuk dimë të shpjegojmë ëndërra.” (12:44).

¹³⁸ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 205.

Me vullnetin e All-llahut shpjegimi i ëndrrës i që pamundësuar të gjithë dijetarëve në pallatin e mbretit.¹³⁹

Sërish hasim në fenomenin e ëndrrës. Në këtë rast përmenden lopët. Lopa është emërtimi i kaptinës së dytë dhe më të gjatë në Kur'an. Përmendja e kësaj kafshe është me rëndësi. A nuk është kjo edhe më e dukshme kur shohim se ajo në ëndrrën e sunduesit krahas kallirit të drithit bartë edhe simbolikën e furnizimit, por edhe të urisë.¹⁴⁰

Sipas Ali ibn Ebi Talibit madje disa shenja mund të parandjehen kur në ndonjë vend hyjnë lopët me karakteristika të caktuara (ngjyra, gjendja, trashësia etj.). Në këtë ëndërr, sipas Kurtubiut, është edhe dëshmia se edhe ëndërra e pabesimtarit mund të jetë e drejtë dhe e mjaftueshme për shpjegim korrekt, si rezultat i gjithëmëshirës së All-llahut që derdhet mbi të gjitha krijesat e tij.¹⁴¹ Të themi edhe këtë se All-llahu, me mëshirën e Tij, nëpërmjet ëndrrës, i jep shenja të caktuara individit që nuk është në rrugë të drejtë që ta përudhë atë në rrugë të drejtë. Ka njerëz që i kthehen të vërtetës pas ndonjë ëndërrë shenjuese, tmerruese, qortuese.

Pasi që suita u gjetë në situatë të palakmueshme duke mos ditur ta komentojë ëndrrën, shokut të Jusufit që kishte shpëtuar nga burgu i bie ndërmend Jusufi dhe mendoi se ai mund ta zgjidh këtë situatë të nderë dhe brengosëse për Mbretin.¹⁴² Shkoi te ai dhe i tha: "O mbret,

¹³⁹ En-Nedevi, *Price ...*, op. cit., fq. 51 e tutje.

¹⁴⁰ Ahmet Behxhet, op. cit., fq. 59.

¹⁴¹ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 210.

¹⁴² Ibn Kethiri përshkruan gjendjen shqetësuese të sunduesit pas ëndrrave të para. Ibn Kesir, *Kazivanja ...*, op. cit., fq. 275. Ibn Kethir-Ar, op. cit., fq. 31-32.

në burg është një djalosh fisnik dhe shumë i mençur dhe i frymëzuar, i zbulon sekretet e ëndrrave me diturinë e tij; se ashtu si ma interpretoi një ëndërr timen kur isha në burg, më doli i vërtetë shpjegimi i tij. Ai ka mundësi të interpretojë ëndrrën tënde, dhe po më lejove të shkoj tek ai, nuk kam dyshim se ai do të jetë në gjendje ta interpretojë dhe të japi mendimin e tij në lidhje me ëndrrën tënde.”¹⁴³ Ish i burgosuri, pas miratimit të mbretit, shkoi te Jusufi, dhe Jusufit ia sqaroi problemin:

وَقَالَ الَّذِي نَجَا مِنْهُمَا وَادَّكَرَ بَعْدَ أُمَّةٍ أَنَا أُنَبِّئُكُمْ بِتَأْوِيلِهِ فَأَرْسِلُونِ يُوسُفُ
أَيُّهَا الصِّدِّيقُ أَفْتِنَا فِي سَعِّ بَقَرَاتِ سِمَانَ يَأْكُلُهُنَّ سَبْعَ عَجَافٍ وَسَبْعَ سُنبُلَاتٍ خُضْرٍ
وَأُخْرَى يَابِسَاتٍ لَعَلِّي أَرْجِعُ إِلَى النَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَعْلَمُونَ

“Dhe atëherë, pas aq vjetësh, u kujtua njëri nga ata dy, ai që shpëtoi, dhe tha: “Unë për domethënien e ëndërrës do t’ju njoftoj, vetëm më dërgoni mua (te Jusufi).” O Jusuf, o njeri i mirëfilltë, na shpjego ç’do të thotë shtatë lopë të liga i hanin shtatë lopë të majme, dhe shtatë kallinj të blertë dhe po aq të tjerë të tharë, dhe të kthehem te njerëzit që edhe ata ta dinë këtë.” (12, 45-46).

Jusufi e shpjegoi ëndrrën që u kërkua nga ai pa e kushtëzuar me dalje nga burgu. Shpjegimi i tij është relevant dhe në vete përmban urtësi dhe simbolik.¹⁴⁴ Mbreti u mahnit me shpjegimin e Jusufit. Gjatë shpjegimit të ëndërrës mbreti nuk dalloj dykuptimësi dhe hamendje, që është karakteristikë tipike e fallxhorëve dhe

¹⁴³ Imam Vehbi Ismaili, *Historia*, II, op. cit., fq. 17.

¹⁴⁴ Edhe pse i burgosuri që kishte dalë nga burgu kishte harruar t’i tregojë sunduesit për Jusufin, që Jusufit i kushtoi edhe disa vjet burg, Jusufi nuk e qortoi për këtë. Shih: Jusuf Ali, op. cit., fq. 567. Mewdudi pjesën e fundit të ajetit kur’anor e shpjegon ashtu që ata ta kuptojnë vlerën e Jusufit dhe ta kuptojnë se shumë gjatë dhe pa kurrfarë të drejte e kanë mbajtur në burg. El-Mewdudi, op. cit., sipas: *Prijevod Kur’ana – RA*, op. cit., fq. 908.

paradëftorëve të pallateve. Në këtë rast, aftësia peygamberike, respektivisht mu'xhizja e Zotit dhuruar Jusufit, qartë dallon nga tregimi që e ofrojnë fallxhorët, profetët, astrologët dhe magjistarët. Kjo e njëjta do të ndodh edhe në pallatin e mbretit kur tek ai erdhi peygamberi Musai a.s.. Me këtë rast, me tregimin e mu'xhizes, me vullnetin e All-llahut, do të ndahet fenomeni i sihrit (maxhisë) si mashtrim dhe magji nga fenomeni i mu'xhizes, të cilën ia mundëson All-llahu xh.sh. ndonjë të dërguari të Tij, që në mësimin islam quhet mu'xhize.¹⁴⁵

Fenomeni i ëndrrës është pak i kapshëm për besimtarin dhe njeriun e zakonshëm. Atë mund të kuptojnë vetëm njerëz të zgjedhur. Jusufi në këtë sure ballafaqohet me tre lloj ëndrrash: ëndrra e tij që ka parë Diellin, Hënën dhe 11 yjë, ëndërrat e dy shokëve të burgut dhe ëndrrën e sunduesit. Dijetarët thonë se ëndërra është shembull ose dëshmi nga e padukshmja, nga bota e gajbit, me të cilin njeriu bashkohet me anë të ruhit në vete, dhe se kjo ëndërr (ru'jetun) vetvetiu nuk mund të merret si aludim për të mirë apo të keq, por vetëm si indikacion i disa forcave të çuditshme në qenien e njeriut me anë të të cilave vetëm disa persona të zgjedhur mund t'i shohin gjerat në ardhmëri. Këto janë kerametet.¹⁴⁶ I këtij lloji ishte edhe rasti i Omerit r.a. kur klithi: "O Sari, kodra!"¹⁴⁷

¹⁴⁵ M. A. Sabuni, op. cit., fq. 55.

¹⁴⁶ Gjerësisht: Muhammed El-Gazali, op. cit., fq. 254. Imami më i madh i besimit (akaidit) islam, El-Maturidiu, pohon se "kerametet e evlijave sigurisht ekzistojnë." *Imam El-Maturidiu, jeta, vepra dhe mësimi*, Prishtinë, 2003, fq. 85-86. Kerametët i miraton edhe Imam Ebu Hanifeh: "Shenjat mu'xhizet) e konfirmuara te peygamberët dhe kerametët te evlijatë janë të vërteta." *Imam Ebu Hanifeh, Fikh'ul-ekber*, Prizren, 2005, fq. 71-72.

¹⁴⁷ *Imam El-Maturidiu, jeta, vepra dhe mësimi*, Prishtinë, 2003, fq. 85-86. Gjere-

Universi i Jusufit a.s.

- Jusufi a.s. nga burgu në pallatin e mbretit
 - Vëllezërit e Jusufit a.s. në Egjipt
- Vëllezërit e Jusufit a.s. e sjellin Benjaminin
 - Takimi i Jusufit a.s. me Benjaminin
 - Gota e sunduesit - Suva'ul-Melik
 - Jusufi a.s. zbulon identitetin e tij
- Ardhja e familjes së Jakubit a.s. në Egjipt
 - Vdekja e Jusufit a.s.

sisht: Xhelaluddin Es-Sujuti, *Povijest halifa*, Sarajeve, 2003, fq. 210-212. Shih: En-Nesefij, *Besimi islam sipas Imam En-Nesefiut*, Prizren, 2003, fq. 38-40.

وَرَفَعَ أَبَوَيْهِ عَلَى الْعَرْشِ وَخَرُّوا لَهُ سُجَّدًا وَقَالَ يَا أَبْتِ هَذَا تَأْوِيلُ رُؤْيَايَ مِنْ
 قَبْلُ قَدْ جَعَلَهَا رَبِّي حَقًّا وَقَدْ أَحْسَنَ بِي إِذْ أَخْرَجَنِي مِنَ السِّجْنِ وَجَاءَ بِكُمْ مِنَ
 الْبَدْوِ مِنْ بَعْدِ أَنْ نَزَغَ الشَّيْطَانُ بَيْنِي وَبَيْنَ إِخْوَتِي إِنَّ رَبِّي لَطِيفٌ لِمَا يَشَاءُ إِنَّهُ هُوَ
 الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

“Dhe ai i vendosi prindërit e vet në fron dhe ata të gjithë iu përulen atij. Ai tha: “O babai im, ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme. Krijuesi im e sendërtoi atë. All-llahu ka qenë i mirë ndaj meje kur më nxorri nga burgu dhe juve nga shkretëtira ju solli, pasi që shejtani ndërmjet meje dhe vëllezërve pati futur përçarje. Krijuesi im është me të vërtetë i mëshirshëm ndaj atij që dëshiron. Me të vërtetë ai është i dijshtëm dhe i urtë!” (Kur'an 12:100)

Jusufi a.s. nga burgu në pallatin e mbretit

Jusufi a.s. i shpjegoi ish-shokut të burgut dome-thënien e ëndrrës së mbretit. Ky u kthye në pallat dhe i kumtoi mbretit shpjegimin e ëndrrës. Mbreti hoqi ca dilema, por megjithatë brengosej për përmbajtjen, thelbin e ëndrrës.

Komentimi i ëndrrës përmbahet në ajetet vijuese:

قَالَ تَزْرَعُونَ سَبْعَ سِنِينَ دَأْبًا فَمَا حَصَدْتُمْ فَذَرَوْهُ فِي سُنْبُلِهِ إِلَّا قَلِيلًا مِمَّا تَأْكُلُونَ
 ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ سَبْعَ شِدَادٍ يَأْكُلْنَ مَا قَدَّمْتُمْ لَهُنَّ إِلَّا قَلِيلًا مِمَّا تَحْصِنُونَ ثُمَّ يَأْتِي
 مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ عَامٌ فِيهِ يُغَاثُ النَّاسُ وَفِيهِ يَعْرِضُونَ

“Ai (Jusufi) tha: “Do të mbillni shtatë vjet rresht dhe atë që e korrni e lini në kallinj, përveç një pakice që do të

hani." Sepse pas asaj do të vijnë shtatë (vite) të vështira që do ta hanë atë çka keni përgatitur për të, përveç asaj pakice që e keni ruajtur për farë. Pastaj, pas këtyre, do të vij një vit në të cilin njerëzit do të kenë shi me bollëk (beregjet) dhe në të cilin do të shtrydhin (rrush e vaj)."(12, 47-49).

Mbreti u interesua për personin që ka komentuar ëndrrën, sepse as dijetarët më të mirë në pallatin e tij nuk mundën ta bëjnë këtë dhe urdhëroi t'ia sjellin atë. Mirëpo, Jusufi refuzoi të dalë nga burgu pa e konstatuar pafajësinë e tij: është apo nuk është fajtor. Kurtubiu sjellë hadithin që e shënon Buhariu, në të cilin Muhammedi a.s. thotë:

*"All-llahu është mëshiruar ndaj vëllait tim Jusufit. Ai ka qenë i durueshëm dhe i butë. Sikur unë të kisha mbetur në burg sa ka mbetur ai, do t'i përgjigjesha thirrjes edhe pa kërkuar shkak."*¹⁴⁸

Pason sqarimi i rastit, duke pranuar gruaja e Ministrit se ajo ka atakuar në Jusufin dhe se Jusufi është i pafajshëm.

Është interesant insistimi i Jusufit a.s. në pafajësinë e tij, sepse gjendja e dyshimtë do t'i bënte dëm më vonë. Jusufi a.s. pranon se nuk mund ta arsyetojë epshin e tij "... sepse shpirti (epshi) njëmend ka prirje kah e keqja, përveç atij ndaj të cilit mëshirohet Zotëriu im! ...".¹⁴⁹

ذَلِكَ لِيَعْلَمَ أَنِّي لَمْ أَخُنْهُ بِالْغَيْبِ وَأَنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي كَيْدَ الْخَائِنِينَ وَمَا أَبْرَأُ
نَفْسِي إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي إِنَّ رَبِّي غَفُورٌ رَحِيمٌ

"Ashtu, ai le ta dijë, se në mungesë të tij, unë nuk e kam tradhëtuar! Sepse njëmend All-llahu nuk lejon që të

¹⁴⁸ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 204-205.

¹⁴⁹ Harun Yahya, op. cit., fq. 66.

sendërtohen dredhitë e mashtruesve. Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (epshi) njëmend ka prirje kah e keqja, përveç atij ndaj të cilit mëshirohet Zotëriu im! Krijuesi im vërtet fal dhe mëshiron.” (Kur'an 12: 52-53).

Disa komentues fillimin e ajetit *“Këtë e foli për ta ditur ai (ministri) se unë nuk e tradhtova tinëzisht ...”* ia atribuonin Jusufit, por, komentuesit si Mahlufi, Reshid Rida, E. Kariq dhe Besim Korkut, mendojnë se këto fjalë janë të Zulejhasë. Këtë komentim mendoj se e provojnë ajetet paraprake të kësaj kaptine.¹⁵⁰ Këtë interpretim e bënë edhe Ibn Kethiri, edhe el-Maverdi, kurse e përkrah edhe Ebu Abbas Ibn Tejmije.¹⁵¹

Pastaj Jusufi vjen në pallat te mbreti, sunduesi i Egjiptit. Pas simpatisë dhe besimit të shprehur nga ana e mbretit, Jusufi propozon që t'i besohet thesari, duke thënë për veten se është i kujdesshëm dhe i ditur. Kurtubiu pohon se Jusufi e njihte mirë matematikën dhe njihte shumë gjuhë të huaja.

Skenën e ardhjes së Jusufit në pallat e rrëfen transmetimi që e përmend Kurtubiu:

¹⁵⁰ Mahluf, op. cit., fq.310, Enes Karic, op. cit., fq. 241, fusn. 4 dhe Besim Korkut, op. cit., fq. 241. Të këtij mendimi është edhe Reshid Rida. Sipas: M. Asad, op. cit., fq. 335, fq. 51. Mirëpo, Taberiu, Begaviu, Zamahsheriu dhe Xh. Llatiqi mendojnë se teskti ka të bëjë me Jusufin. M. Asad, op. cit., fq. 335.

¹⁵¹ Ibn Kethir-Ar, op. cit., fq. 33. Ibn Kethir-B, op. cit., fq. 649. Përkthyesi shqiptar si Feti Mehdiu nuk është i përcaktuar qartë, kurse Hasan Nahi, Sherif Ahmeti dhe përkthyesit anonimë mendojnë se fjalia ka të bëjë me Jusufin a.s.

“Jusufi, pasi erdhi në pallatin e faraonit¹⁵², bëri lutje: ‘All-llahu im, të mirën Tënde e kërkoj nëpërmjet të mirës së tij, mbrojtjen Tënde e kërkoj nga e keqja e tij dhe të atyre përveç atij.’ Pastaj faraonit i dha selam në gjuhën arabe, kurse ai e pyeti: “Cila gjuhë është kjo?” Jusufi u përgjigj: “Kjo është gjuha e kushëririt tim, Ismailit.” Pastaj iu drejtua në gjuhën armeishte, kurse ai sërish e pyeti: “E cila është kjo gjuhë”? Jusufi u përgjigj: “Gjuha e të parëve të mi Ibrahimit, Is’hakut dhe Jakubit. Faraoni fliste 70 gjuhë dhe nëcilën gjuhë Jusufi fliste ai në atë ia kthente. Faraonin e fascinoi kjo gjë. Jusufi atë kohë kishte 30 vjet. Pastaj faraoni i ofroi të ulej dhe i tha Jusufit: “Dëshiroj ta dëgjoj nga ti shpjegimin e ëndrrës sime!” Jusufi u përgjigj: “*Gjithsesi o sundues, keni parë shtatë lopë të trasha ...*”. Transmetimi përfundon me shpjegimin e hollësishëm të ëndrrës e cila në Kur’an është shtruar në mënyrë të shkurtër.¹⁵³

Pas këtij dialogu, sunduesi i Egjiptit tregoi besim të madh karshi Jusufit dhe vendosi t’i besojë funksion e lartë dhe të besueshëm. Këtë na tregon pjesa e fundit e ajetit 54: *قَالَ إِنَّكَ الْيَوْمَ لَدَيْنَا مَكِينٌ أَمِينٌ* - “*Ti prej sot te ne do të jesh i fuqishëm dhe i besueshëm.*”.

¹⁵² Ndonese shumë autorë, muslimanë dhe jomuslimanë, theksojnë se sunduesi në kohën e Jusufit a.s. ishte faraon, kjo nuk qëndron. Faraonët nuk kanë sunduar në këtë kohë. Kjo është koha e Hiksëve. Shih gjerësisht: S. Kutb – B, op. cit., fq. 211. Në pamundësi që të intervenojmë në tekstet brenda thonjzave, ju bëjmë me dije se e drejtë është të thuhet Mbreti, apo Sunduesi i Egjiptit.

¹⁵³ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 217. Krhs.: Ibn Kesir, *Kazivanja ...*, op. cit., fq. 277 e tutje.

Dijetarët muslimanë e komentojnë pjesëmarrjen e Jusufit a.s. në pushtetin e mbretit dhe nga kjo nxjerrin përfundim se muslimanit i lejohet të merrë pjesë në pushtetin jomusliman me qëllim të ndihmesës dhe angazhimit për interesat islame.¹⁵⁴

Komentuesi Kurtubiu mendon se i lejohet njeriut të mirë të punojë për njeriun që nuk është i mirë ose për sunduesin i cili është mosbesimtar, me kusht që puna e tij mos t'i kundërshtojë botëkuptimet e tij dhe që të mundohet ta përmirësojë gjendjen aty ku mundet.¹⁵⁵

Dituria e Jusufit, urtësia e tij, inteligjenca e shëndoshë bëri që sunduesi ta emërojë Jusufin në pozitë shumë strategjike, të grumbullimin e mjeteve materiale dhe në distribuimin e tyre në mënyrë racionale dhe të ndershme. Vendosja e njerëzve në pozitë adekuate është me rëndësi të jashtëzakonshme.

¹⁵⁴ Këtë mendim e mbanë dijetari Rashid Ganushi, lider i lëvizjes islame En-Nahda në Tunizi. Sipas: M. A. Kovač, op. cit.

¹⁵⁵ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 220.

Imam Ibn Kethiri në tefsirin e tij, sipas transmetimit të Muxhahidit, i cili ishte nxënës i Ibn Abbasit, pohon se sunduesi i Egjiptit kur e emëroi Jusufin për ministër të tij e pranoi edhe Islamin.

Shih përkthimin boshnjak të tefsirit të Ibn Kethirit, fq. 650.

Sipas Kurtubiut, nëse sunduesi kërkon prej muslimanit aplikimin e ligjeve joislame, pjesëmarrja në këtë pushtet nuk lejohet.

Vëllezërit e Jusufit në Egjipt

Kurtubiu më tej thekson se thatësia (*kaht*) që kishte përfshirë tërë regjionin kishte shkaktuar mangësi ushqimi edhe në regjionin ku jetonte Jakubi a.s. me familjen. Lajmi për Administruesin e drejtë, të butë e të dhembshëm u dëgjua edhe në zonat e largëta, si në Ken'an. Jakubi a.s. i dërgoi bijtë e tij që të këmbejnë mallra tregtarë dhe të furnizohen në Egjipt me mallrat që u nevojiten. Ata nuk e njohën Jusufin, por Jusufi i njofti menjëherë. Sipas traditës thuhet se Jusufi personalisht e mbikqyrte shpërndarjen e mallrave. Ndarja ishte një 'vesak' (një ngarkesë deveje apo 60 sa'a sipas masës së kohës së Muhammedit a.s.).¹⁵⁶

Kështu, me vullnetin e All-llahut, vëllezërit e Jusufit vijnë pas ushqimit tek ai të cilit ia kishin rrezikuar jetën, duke mos ditur se po ai administruesi i mirë dhe i drejtë është pikërisht ai të cilin tentuan ta mbysin në rini, duke e braktisur në fund të bunarit.

Këtë na përshkruan Kur'ani në ajetet që vijojnë:

وَجَاءَ إِخْوَةُ يُوسُفَ فَدَخَلُوا عَلَيْهِ فَعَرَفَهُمْ وَهُمْ لَهُ مُنْكَرُونَ وَلَمَّا جَهَّزَهُمْ بِجَهَّازِهِمْ قَالَ ائْتُونِي بِأَخٍ لَكُمْ مِنْ أَبِيكُمْ أَلَا تَرَوْنَ أَنِّي أُوفِي الْكَيْلَ وَأَنَا خَيْرُ الْمُنْزِلِينَ فَإِنْ لَمْ تَأْتُونِي بِهِ فَلَا كَيْلَ لَكُمْ عِنْدِي وَلَا تَقْرَبُونِ قَالُوا سَتَرَأُودُ عَنْهُ أَبَاهُ وَإِنَّا لَفَاعِلُونَ

¹⁵⁶ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 225.

“Dhe vëllezërit e Jusufit erdhën dhe hynë tek ai; dhe ai i njofti ata por ata nuk e njoftën atë. Dhe pasi i furnizoi me ushqim të nevojshëm, iu tha: “Ma sillni vëllain tuaj nga babai juaj; a nuk shihni se masën e plotë (me ushqim) dhe jam mikëpritësi më i mirë. Nëse nuk ma sillni atë, nuk do të ketë tek unë më ushqim për ju dhe mos ejani te ne. Ata thanë: “Ne do të përpiqemi ta bindim babain e tij që të ndahet nga ai dhe (vëllain) vërtet do ta sjellim.” (12: 58-61).

Theksohet se vëllezërit e Jusufit erdhën me 11 deve, kurse ata ishin 10 persona. Si arsyetim për Jusufin, theksuan se ata kanë edhe një vëlla, dhe se ai ka mbetur në shtëpi. Jusufi i pyeti për shkakun, kurse ata u përgjigjen se ai ka mbetur në shtëpi për shkak se babai e do shumë atë dhe se brengoset për të. Jusufi kërkoi që edhe atë ta sjellin këtu që të besojnë se kjo që flasin është e vërtetë. Jusufi siguroi ardhjen e vëllait të tij të vogël, duke ua kthyer prapa mallin e sjellur nga ata për këmbim me ushqimin.¹⁵⁷ Në zbrapsjen e tyre, në ngurrimin e tyre që ta sjellin vëllain e vogël, Jusufi kërcënoi se nuk do të tregtojë me ta.¹⁵⁸

Imam Vehbi Ismaili sjellë një dialog mes Jusufit a.s. dhe vëllezërve të tij, i cili është mjaft interesant:

Jusufi a.s. pasi i mirëpriti, iu gjeti vend, i përshëndeti dhe iu tha vëllezërve:

“Unë po ju nderoj dhe besoj se kam të drejtë të pyes kush jeni ju dhe nga vini me që çuditë numri i madh i juaj; dhe dyshoj që mos jeni sy kontra nesh nga sunduesi juaj. A mund të më flisni njeri prej jush

¹⁵⁷ *Prijevod Kur'ana – RA, op. cit., fq. 916-917.*

¹⁵⁸ *Harun Yahya, op. cit., fq. 71-72.*

për qenien tuaj që të më zhduki dyshimet dhe të më qetësohet shpirti ndaj jush.”

Njëri prej tyre, vëllai më i madh, u përgjigj:

“Ne jemi dymbëdhjetë vëllezër, të bijtë e një profeti të nderuar, Jakubit a.s. Ne, dhjetë prej tyre, jemi të dërguarit e tij. Ne jemi në praninë tënde dhe kemi shpresë në ndihmën tënde; të njëmbëdhjetin e kemi lënë pranë babës tonë, në Kenan të Palestinës, që të kujdeset për të. Sa për të dymbëdhjetin e kemi humbur e nuk dijmë a e ka marrë Zoti në prezencën e Tij, a është i vdekur apo jeton dikund në këtë botë. Ne na ka kapluar thatësira dhe na dërgoi tek ti babai ynë, që të na ndihmoni me ushqim. Kemi sjellur me vete do plaçka që t’i këmbejmë me grurë.”

Jusufi a.s. u tha atyre:

“Çka tregoni mund të jetë e vërtetë, por nuk ka vleftë fjala pa prova që ta vërtetojnë atë. Prandaj, më sillni dëshmitarë që të vërtetoj se çka thoni ju janë të drejta.”

Ata i thanë Jusufit:

“O Aziz ne jemi larg, shumë larg prej vendit tonë, këtu jemi të huaj dhe nuk na njeh kush, jemi të ndarë nga ata që na njohin dhe familjet tona. Ti kërkon prej nesh të pamundurën, se ne nuk dijmë këtu njeri që të dëshmoj për ne, por kërko një gjë tjetër që të shpëtojmë nga kjo dilemë?”

Jusufi tha:

“Unë do t’u japë juve ushqimet e nevojshme dhe do të urdhëroj që kafshët tuaja të ngarkohen me çka ju duhet, por me konditë që kur të vini herën tjetër të sillni me vete edhe vëllanë që keni lënë me babën tuaj

dhe të dëshmojë dhe të vërtetojë fjalët tuaja. Atëherë do t'u nderoj edhe më tepër dhe t'u shtoj dhe një kafshë më shumë me ushqime për ju. Kjo është kondita ime dhe ky është premtimi im. Përndryshe po nuk e sollët atë, mos u dukni këtej dhe nuk do të më hyni në Egjipt dhe nuk do t'u japim më grurë dhe ushqime tjera."

Ata i thanë:

"O Aziz, Ne mendojmë që babai ynë nuk do të lejojë atë të vijë me ne, se nuk duron të ndahet nga ai; ...".¹⁵⁹

Sipas disa komentuesve Jusufi ngurroi ta merrë mallin nga babai dhe vëllezërit si kompensim të ushqimit, kurse disa të tjerë thonë se këtë e bëri për shkak që t'i bind këta me mirësinë e tij që ata të kthehen sërisht për ushqim.¹⁶⁰

Ja një varg ajetesh:

وَقَالَ لِفِتْيَانِهِ اجْعَلُوا بِضَاعَتَهُمْ فِي رِحَالِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَعْرِفُونَهَا إِذَا انْقَلَبُوا إِلَى
أَهْلِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ فَلَمَّا رَجَعُوا إِلَى أَبِيهِمْ قَالُوا يَا أَبَانَا مُنِعَ مِنَّا الْكَيْلُ فَأَرْسِلْ
مَعَنَا أَخَانًا نَكْتَلُ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ قَالَ هَلْ أَمْنُكُمْ عَلَيْهِ إِلَّا كَمَا أَمْنُكُمْ عَلَىٰ أَخِيهِ
مِن قَبْلُ فَقَالُوا خَيْرٌ حَافِظًا وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ وَلَمَّا فَتَحُوا مَتَاعَهُمْ وَجَدُوا
بِضَاعَتَهُمْ رُدَّتْ إِلَيْهِمْ قَالُوا يَا أَبَانَا مَا نَبْغِي هَذِهِ بِضَاعَتُنَا رُدَّتْ إِلَيْنَا وَنَمِيرُ أَهْلَنَا
وَنَحْفَظُ أَخَانًا وَنَزِدَادُ كَيْلَ بَعِيرٍ ذَلِكَ كَيْلٌ يَسِيرٌ قَالَ لَنْ أَرْسِلَهُ مَعَكُمْ حَتَّىٰ تُؤْتُونِ
مَوْثِقًا مِنَ اللَّهِ لَتَأْتُنَّنِي بِهِ إِلَّا أَنْ يُحَاطَ بِكُمْ فَلَمَّا آتَوْهُ مَوْثِقَهُمْ قَالَ اللَّهُ عَلَىٰ مَا نَقُولُ
وَكَيْلٌ

¹⁵⁹ Imam Vehbi Ismaili, *Historia, II*, op. cit., fq. 21-22.

¹⁶⁰ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 226. Krhs.: Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 131- 132.

“Kurse Jusufi u tha djelmoshave të vet: “Ngarkoni barrët e tyre në kafshët e tyre, e ata kur të kthehen te familjet e tyre, këtë ta dallojnë dhe që të kthehen përsëri.” Dhe kur u kthyen te babai i tyre, ata thanë: “O babai ynë! Nuk do të na jep më ushqim. Për këtë arsye, dërgoje me ne vëllain tonë që të marrim ushqimin tonë, dhe ne pa dyshim do ta ruajmë atë.” Ai tha: “Vallë, t’ua besoj atë ashtu si ua besova qysh më herët vëllain e tij?” “Por, All-llahu është ruajtësi më i mirë dhe Ai është më i mëshirshmi prej më të mëshirshmëve!” E kur i hapën barrët e tyre, dhe gjetën se gjësendet e tyre janë të tyre, ata thanë: “O babai ynë, ç’dëshirojmë më tepër? Ja, këto janë gjësendet tona, na janë kthyer mbrapa. Dhe me ushqimin do ta furnizojmë familjen tonë dhe vëllain tonë do ta ruajmë dhe një barrë deveje ushqim më tepër do ta fitojmë. Kjo është barrë e parëndësishme. (Jakubi) tha: “Me ju nuk do ta dërgojë deri sa nuk më jepni zotimin tuaj të fortë se me të vërtetë do të ma ktheni prapë, përveç nëse ju nuk pësoni. Dhe pasi ata u zotuan, ai tha: “All-llahu është garantues (vekil) për këtë çka themi.”

Vëllezërit e Jusufit a.s. e sjellin Benjaminin

Pason bindja e djemve të Jakubit a.s. që ta bindin babain ta dërgojë me ta vëllain e ri, Benjaminin. Kjo bindje rritet kur vërejtën se edhe malli i marrë për këmbim të ushqimit është kthyer.

Ja një dialog i djemve të Jakubit me Jakubin:

“O babai ynë, nuk të gënijem ty kur të thamë se kemi takuar një ministër të ndershëm dhe bujar të madh, dhe nuk drehuam kur kërkuaam prej teje që të lejosh Benjaminin të bijë herën tjetër me neve; qe argjendi i jonë që i dhamë për ta këmbyer me ushqim, kjo dëshmon se ministri është shumë njeri i mirë, prandaj lejoje vëllanë tonë të shkoj në Egjipt herën tjetër.”¹⁶¹

Në këtë bindje të ndërsjellë përdoren termet e njëjta sikur edhe atëherë kur kërkonin që Jusufin t’ua lëshojë në shkretëtirë. Jakubi dyshonte. Ai ishte i pandashëm nga Benjaminin. Ai te Benjaminin ndiente aromën e Jusufit dhe ngushëllohej me këtë.¹⁶² Ndaj, ai kërkoi prej tyre garancion të fortë me All-llahun se do ta kthejnë prap “pos nëse nuk ndodh ndonjë fatkeqësi dhe nëse nuk pësoni” – janë fjalët e Jakubit.¹⁶³

وَقَالَ يَا بَنِيَّ لَا تَدْخُلُوا مِنْ بَابٍ وَاحِدٍ وَادْخُلُوا مِنْ أَبْوَابٍ مُتَفَرِّقَةٍ وَمَا أُغْنِي عَنْكُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ إِنْ أُلْحَقْتُكُمْ إِلَّا لِلَّهِ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ

¹⁶¹ Imam Vehbi Ismaili, *Historia, II*, op. cit., fq. 23.

¹⁶² Ibn Kesir, *Kazivanja*, op. cit., fq. 281.

¹⁶³ Abdulvehhab En-Nexhxhar, op. cit., fq. 133. shih edhe: Imam Vehbi Ismaili, *Historia, II*, op. cit., fq. 22-23.

“O bijtë e mi, - tha ai – mos hyni vetëm për një derë, por hyni në dyer të ndryshme! Unë nuk mund t’ju shpëtoj nga ajo që ua cakton All-llahu. Përcaktimi i përket vetëm All-llahut; Atij i mbështetem dhe vetëm në Të le të mbështeten ata që mbështeten!” (12, 67).

Shpjegimi i këshillës së Jakubit dhënë bijve të tij është që bijtë e tij të ruhen nga mësyshi. Nëse në Misr (Egjipt) do të hynin nëpërmjet katër dyerve të mundshme, do të ruheshin nga të këqijat e mundshme.¹⁶⁴

وَلَمَّا دَخَلُوا مِنْ حَيْثُ أَمَرَهُمْ أَبُوهُمْ مَا كَانَ يُغْنِي عَنْهُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا
حَاجَةً فِي نَفْسِ يَعْقُوبَ قَضَاهَا وَإِنَّهُ لَذُو عِلْمٍ لِمَا عَلَّمْنَاهُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا
يَعْلَمُونَ

“Dhe kur hynë ashtu siç i kishte urdhëruar babai i tyre, kjo aspak nuk u ndihmoi të kursehen nga ajo që All-llahu ua ka caktuar; fuqia i përket vetëm Atij, por kështu u plotësua dëshira e Jakubit, të cilën ia plotësoi (Zoti). Kurse ai është vërtet dijetar i madh në atë çka e kemi mësuar, mirëpo shumica e njerëzve nuk e dinë.” (12, 68).

Kurtubiu thekson disa hadithe për të shpjeguar mësyshin, e kjo është në atë që kur shihet diç e mirë duhet falënderuar All-llahun.¹⁶⁵

¹⁶⁴ Këtë mendim e shpreh edhe Xhelalejni: El-Imamejn, *Tefsir’ul-Kur’ani’l-adhim*, libri I, Kairo, pa vit botimi, fq. 196. Ibn Kethir-Ar, op. cit., fq. 38.

Edhe Sabuni pohon çështjen e mësyshit. Shih: M.A. Es-Sabuni, op. cit., fq. 59. Edhe El-Eshkar pohon se qëllimi i fjalëve të Jakubit a.s. që mos të hyjnë nga kjo derë është nga frika e mësyshit. Shih: El-Eshkar, op. cit., fq. 313. Shih: Ibn Tejmijeh, *Fetava*, XV, op. cit., fq. 113-114.

¹⁶⁵ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 226-238. Ibn Kethiri përveç tjerave mendon se qëllimi i Jakubit a.s. duke i porositur djemtë e tij të hyjnë nëpër dyer të ndryshme ishte edhe fakti se mos vallë po dëgjojnë apo zbulojnë ndonjë fakt apo provë për Jusufin. Megjithatë, Ibn Kethiri mendon se mendimi i parë është më i mundshëm. Shih: Ibn Kesir, *Kazivanja* ..., op. cit., fq. 281-282.

Takimi i Jusufit a.s. me Benjaminin

Kur mbaroi ushqimi që kishin, djemtë e Jakubit erdhën sërish në Egjipt. Këtë herë vëllezërit e Jusufit e sollën edhe vëllain e vogël, Benjaminin. Kur e pa Jusufi Benjaminin, u kënaq, por u përmbajtë. I ftoi të hanë ushqim dhe i ndau në sofrë të ndryshme dy nga dy. Meqë Benjaminin mbeti vetëm, në vete tha: *“Po të ishte Jusufi gjallë do të rrinte me mua”*. Jusufi e dëgjoi këtë por u përmbajtë.

وَلَمَّا دَخَلُوا عَلَى يُوسُفَ آوَىٰ إِلَيْهِ أَخَاهُ قَالَ إِنِّي أَنَا أَخُوكَ فَلَا تَبْتَئِسْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

“Dhe kur hynë para Jusufit, ai e afroi vëllain e vet dhe i tha: “Unë me të vërtetë jam vëllai yt, dhe mos u dëshpëro për atë që vepruan ata!” (12, 69).

Katade thekson se Jusufi urdhëroi që vëllezërit e tij të vendosen në dhoma nga dy vetë, ashtu që vëllai i tij më i ri të mbetet i vetëm në dhomë. Këtë e theksojnë edhe burimet tjera. Kur Benjaminin mbeti vetëm Jusufi e pyeti:

“A don të jemë unë vëllau yt, në vend të vëllaut tënd të vdekur?”

Ai u përgjigj:

“Kush gjen një vëlla të mirë si ti, por ty nuk të ka lindur Jakubi dhe nëna ime.”

Sërish Jusufi a.s. u përmbajtë, por nuk mundi të mos i tregoi Benjaminin. Iu afroi, e përqafoi fuqishëm

dhe i tregoi se ai është vëllai i tij, Jusufi, të cilit vëllezërit i bënë fitne.¹⁶⁶ Jusufi e përkujtoi Benjaminin që mos të brengoset sepse vuajtjet ndaj tij kanë marrë fund dhe se më nuk mund t'i bëjnë dëm. Por Benjaminit i sugjeroi që vëllezërve ende mos t'ua zbulojë këtë sekret.¹⁶⁷

Mewdudi mendon se gota u vendosë në barrën e Benjaminit me lejen e tij, me qëllim që Benjaminin ta shpëtojë nga vëllezërit e këqijë. Edhe Benjaminin nuk kishte dëshirë të kthehej me ta, por këtë nuk mund ta thonin haptazi.¹⁶⁸

¹⁶⁶ Tarik Suvejdani, op. cit., fq. 209. Krhs.: Ibn Kesir, *Kazivanja ...*, op. cit., fq. 283.

¹⁶⁷ Shih gjerësisht: Imam Vehbi Ismaili, *Historia, II*, op. cit., fq. 24.

¹⁶⁸ El-Mewdudi, op. cit., fq. 920.

Inskeniimi i gotës së sunduesit te barra e Benjaminit – Suva’ul-Melik

Pas takimit me vëllain e vogël, pason strategjia (taktika) rreth gotës së sunduesit (es-sa’u apo es-suvau). Sipas komentuesve të Kur’anit, kjo enë është ajo nga e cila pinte sunduesi.¹⁶⁹ Në këtë kohë ajo (ena, gota) shërbente për matjen e ushqimit për ata të cilët e kërkonin për respekt ndaj ushqimit, i cili ishte i mangët.

فَلَمَّا جَهَّزَهُمْ بِجَهَّازِهِمْ جَعَلَ السَّقَايَةَ فِي رَحْلِ أَخِيهِ ثُمَّ أَذَّنَ مُؤَذِّنٌ أَيَّتَهَا الْعَيْرُ
إِنَّكُمْ لَسَارِقُونَ قَالُوا وَأَقْبَلُوا عَلَيْهِمْ مَاذَا تَفْقِدُونَ قَالُوا نَفَقْدُ صَوَاعَ الْمَلِكِ وَلِمَنْ
جَاءَ بِهِ حِمْلُ بَعِيرٍ وَأَنَا بِهِ زَعِيمٌ

“Dhe pasi që i furnizoi me ushqim të nevojshëm, në barrën e vëllait të vet e vendosi një gotë dhe pastaj një lajmëtar filloi të bërtiste: “O karavan, ju njëmend qenkeni vjedhës!” Duke u kthyer nga lajmëtari, thanë: “Çka keni humbur!” Thanë: “Kemi humbur gotën e mbretit dhe kush e sjellë ate do ta fitojë një barrë deveje me ushqim. Për këtë unë garantoj.”! (12, 70-72).

Vëllezërit e Jusufit fillimisht u hutuan por edhe u brengosen për akuzën për vjedhje. U përpoqën të arsyetohen se kanë ardhur me qëllime të mira, shitblerëse e jo të vjedhin.¹⁷⁰

¹⁶⁹ Enes Karic, op. cit., fq. 244.

¹⁷⁰ Ahmet Behxhet, op. cit., fq. 61.

Jusufi kërkoi prej vëllezërve të Jusufit që të propozojnë për shkallën e ndëshkimit për veprën e bërë. Sipas ligjit të Jakubit vjedhësi bëhej rob i atij te i cili ka vjedhur.¹⁷¹ Që skena të duket bindëse, filloi humtimi i gjësendeve të të gjithë vëllezërit e më në fund edhe te Benjamini. Qëllimisht u fillua larg Benjaminsit që mos të dyshojnë vëllezërit se gota është inskenuar në plaçkat e tij.¹⁷²

Jusufi tha: “Vëllai juaj do të bëhet rob i imi.”¹⁷³

Në ajetet që vijojnë edhe vetë vëllezërit e Jusufit konfirmojnë atributin me të cilin All-llahu e përshkruan Jusufin: *إِنَّا نُرَاكَ مِنَ الْمُحْسِنِينَ* (*Inna nerake min'el-muhsinin*) “Vërtet ne shohim se ti je njeri bamirës!”.

قَالُوا إِن يَسْرِقْ فَقَدْ سَرَقَ أَخٌ لَّهُ مِنْ قَبْلُ فَأَسْرَهَا يُوسُفُ فِي نَفْسِهِ وَلَمْ يُبْدِهَا لَهُمْ قَالَ أَنْتُمْ شَرٌّ مَكَانًا وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا تَصِفُونَ قَالُوا يَا أَيُّهَا الْعَزِيزُ إِنَّ لَهُ أَبًا شَيْخًا كَبِيرًا فَخُذْ أَحَدَنَا مَكَانَهُ إِنَّا نُرَاكَ مِنَ الْمُحْسِنِينَ قَالَ مَعَاذَ اللَّهِ أَنْ نَأْخُذَ إِلَّا مَنْ وَجَدْنَا مَتَاعَنَا عِنْدَهُ إِنَّا إِذًا لَطَّالِمُونَ

“(Vëllezërit) thanë: “Nëse ka vjedhur, po edhe para vëllai i tij pati vjedhur!” Dhe Jusufi nuk u tha asgjë. “Ju jeni në gjendje më të keqe” mendoi në vete, e All-llahu e di më së miri atë për çka ju flisni (përshkruani).” (Vëllezërit) thanë:

¹⁷¹ Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 134. Sipas ligjit egjiptian dënimi për vjedhje është rrahja me kamxhik ose pagesa e dyfishtë e sendit të vjedhur, por kurrësesi robërimi. (El-Xhelalejni, sipas: *Prijevod Kur'ana – RA*, op. cit., fq. 923. Për këtë shkak Jusufi, me pëlqimin e vëllezërve, aplikoi ligjin e vendit të Ken'anit dhe jo të Egjiptit.

¹⁷² El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 239.

Edhe në këtë rast është provuar metoda e indicionit, siç ishte me rastin e hetimit të fajësisë ndërmjet Jusufit dhe gruas së Ministrit. Shih: Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

¹⁷³ Ahmet Behxhet, op. cit., fq. 63.

“O sundues (Aziz), ai ka një baba shumë të moshuar, ndaj merre ndonjërin prej nesh në vend të tij! Vërtet ne shohim se ti je njeri bamirës. “All-llahu na ruajtë” - tha (Jusufi) - “si ta marrim tjetërkend në vend të atij ku i gjetëm gjësendet tona? Ne atëherë njëmend do të ishim mizorë”! (12, 77-79).

Që të arsyetohen për veprimet e Benjamins, vëllezërit e Jusufit përsëri filluan të gënjejnë. Ata pohuan se Benjamini ka pasur prirje për vjedhje, por Jusufi a.s. nuk reagoi në pohimin e tyre.¹⁷⁴

Sipas mendimit të Ibn Shexheretit dhe Ibn Isa'it, të cilët i thekson Kurtubiu, Jusufi në vete pëshpëriti: “Ju jeni në pozitë më të keqe”, pastaj me zë tha: “All-llahu e di më së miri për atë që trilloni!” Kurtubiu mendon se oferta e vëllezërve për zëvendësim me Benjaminsin është thënë me kuptim figurativ, sikurse në rastin kur dikush gjendet në situatë të rëndë dhe thotë: “Më mbytë, por këtë mos e bënë!”, dhe në asnjë çast nuk mendon se bashkëbiseduesi i tij do ta pranojë sugjerimin e tij, por këtë e bëri sa për bindje.¹⁷⁵

Duke vërejtur se gjendja nuk do të zgjidhet ashtu siç dëshiruan vëllezërit e Jusufit, vëllai më i vjetër, siç përmend Kur'ani, iu përmend vëllezërve të vet zotimin me All-llahun që ia kanë dhënë babait për ruajtjen e të birit, por nuk lëshon rastin t'i përkujtojë në krimin që më herët kishin bërë kundrejt Jusufit.

¹⁷⁴ Urrejtja e vëllezërve të Jusufit dhe Benjamins ndaj tyre është ende e pranishme dhe kjo shihet duke akuzuar Jusufin për vjedhje. Këtë e bënë që më lehtë të distancohen nga Benjamini. Mirëpo, as nuk kanë mundur ta imagjinojnë se Jusufin e kanë para vetes. Këtë e bëri Jusufi që gënjeshttrat e tyre të dalin në shesh. Shih: M. Asad dhe Jusuf Ali. El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 239. Ibn Kesir, *Kazivanja ...*, op. cit., fq. 283-284.

¹⁷⁵ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 240 e tutje.

Ndonëse vëllezërit ofruan zëvendësim për Benjaminin, Jusufi refuzoi kategorikisht: *مَعَاذَ اللَّهِ* – *All-llahu na ruajtë*. Ky togfjalësh kur'anor ka kuptime si “All-llahu mos dhashtë, All-llahu na ruajtë, Kërkojmë mbrojtjen Tënde o All-llah nga ... etj.¹⁷⁶

Kur humbën çdo shpresë, u ndanë anash që të këshillohen:

فَلَمَّا اسْتَيْسَسُوا مِنْهُ خَلَصُوا نَجِيًّا قَالَ كَبِيرُهُمْ أَلَمْ تَعْلَمُوا أَنَّ أَبَاكُمْ قَدْ أَخَذَ عَلَيْكُمْ مَوْثِقًا مِنَ اللَّهِ وَمِنْ قَبْلُ مَا فَرَّطْتُمْ فِي يُوسُفَ فَلَنْ أَبْرَحَ الْأَرْضَ حَتَّىٰ يَأْذَنَ لِي أَبِي أَوْ يَحْكُمَ اللَّهُ لِي وَهُوَ خَيْرُ الْحَاكِمِينَ

“Dhe kur i humbën tëra shpresat, u ndanë anash që të konsultohen. Më i vjetri ndër ata tha: “A nuk e dini se i jeni betuar babait tuaj, por edhe më herët me Jusufin keni gabuar? Nuk e lëshojë dot këtë vend deri sa babai im këtë nuk ma lejon, ose deri sa All-llahu nuk gjykon në favor timin. Kurse Ai është gjykatësi më i mirë. ” (12, 80).

Kurtubiu thekson se vëllai më përgjegjës ndaj zotimit të Jakubi turpërohej t'i del Jakubit para syve. Ai ishte i gatshëm që edhe me shpatë ta kthente vëllain ose të vdiste për lirim të tij.

ارْجِعُوا إِلَىٰ أَبِيكُمْ فَقُولُوا يَا أَبَانَا إِنَّ ابْنَكَ سَرَقَ وَمَا شَهِدْنَا إِلَّا بِمَا عَلَّمْنَا وَمَا كُنَّا لِلْغَيْبِ حَافِظِينَ

“Kthehuni te babai juaj dhe thuani: “O babai ynë, biri yt ka vjedhur; ne pohojmë vetëm atë që kemi parë, dhe ne nuk kemi mund të mbrohemi nga ajo që është e fshehtë.” (12, 81).

وَاسْأَلِ الْقَرْيَةَ الَّتِي كُنَّا فِيهَا وَالْعِيرَ الَّتِي أَقْبَلْنَا فِيهَا وَإِنَّا لَصَادِقُونَ

¹⁷⁶ Mahluf, fq. 313, sipas: Enes Karic, op. cit., fq. 245.

“Ti pyete qytetin në të cilin kemi qenë dhe karvanin me të cilin kemi ardhur. Ne vërtet flasim të vërtetën.” (12, 82).

Ibn Abbasi dhe Ed-Dahaku këtë shprehje ‘sereka’ – ka vjedhur, e lexon në pasiv: *enne’bneke surrika*, kështu që kuptimi është *“O babai ynë, biri yt është vjedhur (grabitur)”*, për shkak të vetë gjendjes në të cilën e humbën Benjaminin.¹⁷⁷

Pastaj Kur’ani përshkruan arsyetimet e djemve të Jakubit para tij dhe mosbesimin e Jakubit në fjalët e tyre, sepse qysh në rastin e Jusufit e patën humbur besimin. Edhe me këtë rast Jakubi reagoi ngjashëm sikurse me rastin e humbjes së Jusufit.

قَالَ بَلْ سَوَّلَتْ لَكُمْ أَنْفُسُكُمْ أَمْرًا فَصَبْرًا جَمِيلًا عَسَى اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَنِي بِهِمْ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

“(Jakubi) tha: “Jo, por shpirti juaj në këtë u ka shpjerë, ndaj mua më mbetet durim i mirë. Është për të shpresuar se All-llahu do të m’i kthejë të gjithë. Ai, njëmend, është i gjithëdijshtëm dhe i urtë.” (12, 83)

Nga ky ajet, si shpjegon Kurtubiu, kuptojmë se Jakubi a.s. e ka ditur se Jusufi nuk ka vdekur.

وَتَوَلَّى عَنْهُمْ وَقَالَ يَا أَسْفَىٰ عَلَىٰ يُوسُفَ وَإِیْضًا عَيْنَاهُ مِنَ الْحُزْنِ فَهُوَ كَظِيمٌ

“Dhe ua ktheu shpinën atyre dhe tha: “O dëshpërimi im (O i mjeri unë) për Jusufin; sytë iu kishin zbardhur prej pikëllimit, ka qenë shumë i dëshpëruar.. (12, 84).

U kthye prej tyre dhe pikëllim dhe brengosje dhe foli: *Jâ esefâ alâ Jûsufe ...- “O dëshpërimi im për Jusufin*

¹⁷⁷ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 241. Krhs.: Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 133.

fin...". Esef është brengosje e madhe (prej foljes: esefe – je'sefu) dhe vetvetiu ofron lidhje etimologjike me emrin e pejgamberit Jusufit, i cili domethënë *i përlotur, i qajtur, ai për të cilin është dhembur shumë*.¹⁷⁸ Jakubi i cili ishte verbuar, dëshpërimin dhe dhembjen e tij e kishte zotuar për All-llahun e dashur.¹⁷⁹ Jakubi a.s. pas lajmit të humbjes edhe të Benjamin, iu kthye edhe njëherë dëshpërimin të vjetër, dëshpërimin ndaj Jusufit, duke pritur lehtësim dhe rrugëdalje vetëm nga All-llahu.¹⁸⁰

Pas largimit të vëllezërve tjerë për atdhe dhe pas mbetjes së Benjamin për rob të Jusufit, sipas ligjit të atëhershëm në Kenan, Jusufi i zbulohet Benjamin, duke i thënë: "Inni ene ehuke" – "Unë pa dyshim jam vëllai yt"¹⁸¹, duke ia treguar tërë ndodhinë deri atë ditë.

Pasojnë ajetet:

قَالَ قَالُوا تَاللَّهِ تَفْتَأُ تَذُكُرُ يُوسُفَ حَتَّى تَكُونَ حَرَضًا أَوْ تَكُونَ مِنَ الْهَالِكِينَ
إِنَّمَا أَشْكُو بَثِّي وَحُزْنِي إِلَى اللَّهِ وَأَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ

"Ata thanë: "Pasha All-llahun, ti aq e përmend Jusufin sa që është frikë se do të sëmuresh ose do të vdesësh"! "Unë", tha ai (Jakubi), "pikëllimin tim dhe dhembjen time ia shprehi vetëm All-llahut dhe nga All-llahu di atë që ju nuk dini." (12, 85 - 86).

¹⁷⁸ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 247 e tutje. Es-Sabuni, op. cit. fq. 64. Mahluf, fq. 245. Enes karic, op. cit., fq. 245. Ibn Abbasi ajetin "nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë" e kupton ashtu që do të mund të përkthehej si "nga pikëllimi sytë iu mbushën me lotë." Sipas: Pandza – Causevic, op. cit., fq. 363.

¹⁷⁹ Prijevod Kur'ana – RA, op. cit., fq. 928.

¹⁸⁰ Ibn Kesir, Kazivanja..., op. cit., fq. 285.

¹⁸¹ Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 136.

Jusufi zbulon identitetin e tij

Pasojnë pjesët e fundit nga rrëfimi i Jusufit. Me kërkesë të babait, djemtë e Jakubit a.s. kthehen në Egjipt. Jakubi a.s. kërkon prej tyre që ta hulumtojnë fatin e Jusufit dhe të pyesin për të vëllain e tij Benjaminin në Egjipt. Jakubi a.s. ishte i bindur se Jusufi është gjallë¹⁸²:

يَا بَنِي إِدْهَبُوا فَتَحَسَّسُوا مِنْ يُوسُفَ وَأَخِيهِ وَلَا تَيْسُرُوا مِنْ رُوحِ اللَّهِ إِنَّهُ لَا
يَيْسُرُ مِنْ رُوحِ اللَّهِ إِلَّا الْقَوْمَ الْكَافِرُونَ

“(Jakubi u tha të bijve të vet) “O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllain e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e All-llahut, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në All-llahun”.¹⁸³(12, 87).

Me këtë ajet shihet qartë pozita përçmuese e vëllezërve të Jusufit. Për së treti herë vijnë në Egjipt për ushqim.¹⁸⁴ Kishin kaluar 22 vjet nga hedhja e Jusufit në bunar.¹⁸⁵ Pas kësaj gjendjeje pason mëshira e All-llahut dhe premtimi i All-llahut që ia kishte dhënë Jusufit qysh kur ishte i vogël, kur vëllezërit e tij e braktisën në bunar në mëshirën e shkretëtirës:

¹⁸² El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 252. Ibn Kesir, Kazivanja..., op. cit., fq. 286.

¹⁸³ Jusuf Ali mendon se këtu togfjalëshi مِنْ رُوحِ اللَّهِ (min rewh'il-Lah), jo 'min ruh'il-Lah', përfshinë falënderimin ndaj mëshirës së All-llahut, e cila në konfuzionin më të madh brenda nesh na jep qetësi dhe rehati. Jusuf Ali, op. cit., fq. 582. Shih edhe : M. Asad, op. cit., fq. 341, fusn. 88.

¹⁸⁴ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 254 e tutje.

¹⁸⁵ Sipas: Tarik Suvejdani, op. cit., fq. 214.

لَتَبَيَّنَهُمْ بِأَمْرِهِمْ هَذَا وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ...

“... Ti për këtë veprim të tyre do t'i njoftosh, kurse ata ty as nuk do të njohin”. (12, 15)

فَلَمَّا دَخَلُوا عَلَيْهِ قَالُوا يَا أَيُّهَا الْعَزِيزُ مَسْنَا وَأَهْلْنَا الضُّرَّ وَجِئْنَا بِبِضَاعَةٍ مُزْجَاةٍ فَأَوْفِ لَنَا الْكَيْلَ وَتَصَدَّقْ عَلَيْنَا إِنَّ اللَّهَ يَجْزِي الْمُتَصَدِّقِينَ قَالَ هَلْ عَلِمْتُمْ مَا فَعَلْتُمْ بِيُوسُفَ وَأَخِيهِ إِذْ أَنْتُمْ جَاهِلُونَ قَالُوا أَأَنْتَ يَا يَاسُفَ قَالَ أَنَا يُوسُفُ وَهَذَا أَخِي قَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَيْنَا إِنَّهُ مَنْ يَتَّقِ وَيَصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ قَالُوا تَاللَّهِ لَقَدْ آثَرَكَ اللَّهُ عَلَيْنَا وَإِنْ كُنَّا لَخَاطِبِينَ

“Dhe kur ata dolën para tij (Jusufit), ata thanë: “O Aziz (sundues), neve dhe familjen tonë e ka goditur një fat-keqësi e madhe, kemi sjellë gjera me vlerë të vogël, por ti na jepë masën e plotë dhe na jep sadaka, sepse All-llahu njëmend i shpërblen ata që ndajnë sadakë.” Ai (Jusufi) u tha: “A e dini se ç’keni bërë me Jusufin dhe vëllain e tij kur keni vepruar si injoratë.” A mos je ti, me të vërtetë, Jusufi!, britën ata. “Po, unë jam Jusufi, kurse ky është vëllai im - u përgjigj. All-llahu na ka mëshiruar neve. Me të vërtetë, kush frikësohet dhe kush bën durim, All-llahu nuk lejon të shkatërrohet shpërblimi për ata që bëjnë vepra të mira.” Ata thanë: “Për All-llahun, All-llahu të ka lartësuar mbi neve, ne me të vërtetë kemi gabuar!” (12, 88-91).

Jusufi mendoi në vete se kishte ardhur koha që t’u shfaqej vëllezërve të tij¹⁸⁶:

“A ju kujtohet ajo ditë, vite të shkuara, kur ju zbukuroi epshi dhe ju shtyu ta tradhtoni Jusufin dhe ta hidhni në pys, pasi e zhveshët nga këmisha e

¹⁸⁶ Jusufi a.s. mallëngjente ndaj prindërve dhe familjes, bashkëndjente ndaj vëllezërve para dëmit të dukshëm. Njëkohësisht ai paraqitet me qortim të rafinuar dhe falje bujare ndaj vëllezërve. Këto janë virtyre të një pejgambëri. Shih: S. Kutb – B, op. cit., fq. 206.

megjithqë iu lut juve duke qarë që ta mëshironi, por juve nuk i vutë fare mendjen dhe e përplasët në thellësinë e pusit.” Të habitur nga dija që kishte Ministri, vëllezërit filluan të shikojnë njëri-tjetrin.¹⁸⁷

Lidhur me këtë çështje, Kurtubiu thekson transmetimin që e përcjell Ibn Abbasi, në të cilin thuhet se pasi djemtë e Jakubit a.s. hynë te Jusufi dhe filluan t’i ankohen, Jusufi i pyeti se çka kanë bërë me Jusufin dhe vëllain e tij. Pas asaj që dëgjoji prej tyre Jusufi buzëqeshi, duke treguar dhëmbët e tij shumë të bukur. Pastaj hoqi e kurorën e qeveritarit. Pas kësaj vëllezërit e njohën, dhe i thanë: *“A mos je ti, me të vërtetë, Jusufi?”*.

Ibn Abbasi tregon se Jakubi a.s. i shkruan një letër personale Ministrit të Egjiptit, duke i kërkuar t’ia lirojë djalin:

*“Nga Jakubi, robi i singertë i All-llahut, i biri i Is’hakut sakrificës së All-llahut, të birit të Ibrahimit, mikut të All-llahut, Drejtuesit të Egjiptit. Pastaj, ne i përkasim familjes së të përvojaturve dhe të munduarve / All-llahu e ka sprovuar gjyshin tim Ibrahimin me paganët dhe zjarrin e tyre, pastaj e sprovoi babain tim Is’hakun me sakrifikim, pastaj mua më sprovoi me fëmijën i cili ishte fëmija më i dashur, është që kam humbur të pamurit duke qajtur për të. Unë nuk kam vjedhur as nuk kam lindur vjedhës. Paqja qoftë me ju.”*¹⁸⁸

¹⁸⁷ Imam Vehbi Ismaili, Historia, II, op. cit., fq. 28.

¹⁸⁸ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 261-262. Në këtë transmetim qëndron se Is’haku është dhebih’ull-llah, sakrificë e All-llahut. Shumica e dijetarëve mendon se Ibrahimit i është urdhëruar ta sakrifikojë Ismailin a.s. Mirëpo, ka edhe të atillë që mendojnë se ky ishte Is’haku. El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 256. Ky version është nga ata që mendojnë se sakrifimi ka të bëjë me Is’hakun.

Pasi Jusufi i lexoi këto fjalë gjunjë filluan t'i dridhen e lëkura t'i rrënoqethet, kurse sytë e tij filluan të përloten. Jusufi e ktheu përgjigjen:

*"Israilullah Jakubit prej sundimtarit të Egjiptit,
O plak! Letrën tënde e mora. E këndova dhe e kuptova.
Më shkruan për etërit e tu, për shqetësimet që u kanë rënë
në kokë dhe për durimin e tyre. Si të kenë duruar ata, edhe
ti duro! Paqja qoftë mbi ty!"*

Kur e mori përgjigjen Jakubi tha:

*"Betohem në All-llahun se kjo nuk është një letër sundimtari, por një letër profeti! Ai që e ka shkruar këtë letër s'mund të jetë tjetërkush veç Jusufit!"*¹⁸⁹

Pas disa bisedave mes Jusufit dhe vëllezërve, Jusufin e lëshoi durimi dhe misterien e bëri të njohur me fjalët se ai është Jusufi: *Ene Jusufu - "Unë jam Jusufi"*.¹⁹⁰

¹⁸⁹ Osman Nuri Topbash, op. cit., fq. 79.

¹⁹⁰ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 256. Sejjid Kutub mendon se shumë pyetje të Jusufit që asoconin se Jusufi kishte dije mbi ngjarjet e tyre, pastaj edhe paraqitja e Benjamin, jo si rob i sunduesit, por në lidhje të ngushtë me sunduesin dhe disa elemente të tjera bënë që ata paprimtas t'ia qëllonë dhe ta njohin Jusufin a.s. Ata habiten se vijne në Egjipt tash disa vite dhe si kanë mundur mos ta njohin Jusufin a.s. Sipas: S. Kutub, op. cit.; Es-Sabuni, op. cit., fq. 65.

Këmisha e vërtetë e Jusufit dhe dija e Jakubit a.s.

All-llahu e dalloi Jusufin me dituri dhe urtësi, me sjellje të mirë dhe me moral të pashembëllt. E dalloi me cilësinë e thirrjes së njerëzve në fe të pastër të Krijesit. E dalloi me forcën për t'i falur vëllezërit e tij. Veprimi i Jusufit me vëllezërit e tij është shembull i faljes dhe dhembsurisë. All-llahu e dalloi Jusufin edhe mirësinë e pakufishme ndaj prindërve, vëllezërve dhe ndaj të gjitha krijesave të tjera.¹⁹¹

Në kohën kur Jusufi mund të hakmerrej ndaj vëllezërve, ai nuk do t'i qortoje ata, por nga All-llahu do të kërkojë falje për ta:

قَالَ لَا تَثْرِبَ عَلَيْكُمُ الْيَوْمَ يَغْفِرُ اللَّهُ لَكُمْ وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ اذْهَبُوا بِقَمِيصِي
هَذَا فَأَلْقُوهُ عَلَىٰ وَجْهِ أَبِي يَأْتِ بَصِيرًا وَأْتُونِي بِأَهْلِكُمْ أَجْمَعِينَ

“Ai tha: “Unë tash nuk do t’u qortoje juve, All-llahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi prej mëshiruesve.” Çojeni këtë këmishën time dhe vënia babait tim në fytyrë, atij do t’i vijë shikimi. Dhe ma sillni mua tërë familjen tuaj!”. (12, 92-93).

Këmisha, siç e shohim në përfundim të rrëfimit jetësor të Jusufit, na paraqitet sërish, por në funksion tjetër, shërues, për të cilën e mësoi All-llahu Jusufin.

M. Asadi mendon se pjesa e ajetit *“vënia babait tim në fytyrë”* mund të ketë kuptim *“vënia para babait tim”*,

¹⁹¹ Abdurrahman ibn Nasir Es-Saadi, nr. 112, op. cit., fq. 13.

sepse fjala وَجْهٍ në gjuhën klasike arabe do të thotë edhe personalitetin ose qenien e ndonjë individi.¹⁹²

Vazhdimi i ajetit “atij do t’i vijë shikimi” nga disa autorë kuptohet në aspektin simbolik, figurativ, sepse “besir” do të thotë njeriu tek i cili edhe sytë por edhe zemra janë të hapura dhe me këtë rast Jakubi do të kuptojë jo vetëm se Jusufi a.s. është gjallë, por edhe se ku gjendet.¹⁹³

Kjo dëshmon edhe në një mënyrë tjetër përkryeshmërinë e të shprehurit kur’anor:

وَلَمَّا فَصَلَتِ الْعِيرُ قَالَ أَبُوهُمْ إِنِّي لَأَجِدُ رِيحَ يُوسُفَ لَوْلَا أَنْ تُفَنِّدُونِ قَالُوا
تَاللَّهِ إِنَّكَ لَفِي ضَلَالِكَ الْقَدِيمِ فَلَمَّا أَنْ جَاءَ الْبَشِيرُ أَلْقَاهُ عَلَى وَجْهِهِ فَارْتَدَّ بَصِيرًا
قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لَكُمْ إِنِّي أَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ

“Dhe kur karvani e lëshoi (Egjiptin), babai i tyre tha: “Unë njëmend ndiej aromën e Jusufit, por mos më quani të matufosur.” Ata (familjarët) thanë: “Për All-llahun, ti je njëmend në lajthimin e vjetër.” Por kur erdhi sihariquesi, ia vuri atë (këmishën) mbi fytyrën e tij dhe ai filloi të shohë. “A nuk ju thash, tha (Jakubi), se unë e di nga All-llahu atë çka ju nuk e dini?” (94-96).

Si mundi Jakubi a.s. ta ndiejë aromën e Jusufit? Kurtubiu thekson mendimin e Malik ibn Enesit r.a. në të cilin ai thotë:

“Aromën e tij pa dyshim e solli po ai shkak i cili Sulejmanit a.s. i solli fronin e Belkises, para se të përpëlites me sy.”¹⁹⁴ Ibn Kethiri shkruan në historinë e tij: “...Ibn

¹⁹² Muhammed Asad, op. cit., fq. 342. Es-Sabuni, op. cit., fq. 67. Pandza Čausevič, op. cit., fq. 364, fusn. 27.

¹⁹³ Pandza- Čausevič, op. cit., fq. 364, fusn. 28. Ibn Kethir-Ar, op. cit., fq. 46-47.

¹⁹⁴ El-Kurtubi, op. cit., IX, fq. 260. Krhs.: Enes Karic, op. cit., fq. 246.

Abbasi ka thënë: “Kur karvani e lëshoi Egjiptin fryri era dhe Jakubit ia solli aromën e këmishës së Jusufit. ... “Kështu Jakubi ndjeu aromën e tij në largësi prej tri ditë ecje.”¹⁹⁵

Nga ana e familjarëve të Jakubit a.s. ka ekzistuar bindja se Jakubi ishte matufosur, por ata bindjen e tyre e mbështesnin në vrotim sipërfaqësor. Kjo tregon se edhe Jusufi por edhe Jakubi posedonin dije që nuk mund të kuptohej nga rrethi i tyre. Mendimin tonë e konfirmon edhe Harun Jahja.¹⁹⁶

Vëllezërit e Jusufit kërkojnë prej babait të tyre që t’i drejtohet All-llahut për lutje që t’ua falë mëkatin e tyre të shëmtuar:

قَالُوا يَا أَبَانَا اسْتَغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا إِنَّا كُنَّا خَاطِئِينَ قَالَ سَوْفَ أَسْتَغْفِرُ لَكُمْ رَبِّي إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

“Ata (djemtë) thanë: “O babai ynë, lutu që mëkatet tona të na falen. Ne me të vërtetë jemi prej mëkatarëve.” (Jakubi) tha: “Do ta lus (më vonë) Krijuesin tim që t’ua falë. Sepse ai falë dhe është i mëshirshëm!” (12, 97-98).¹⁹⁷

Babai nuk ua fali menjëherë djemve të tij. Ishte tejet i zemëruar me veprimin e djemve të tij dhe kërkoj një kohë për prehje shpirtërore nga tërë ajo që kishte përjetuar. Por, u premtoi se atë do ta bëjë më vonë. Ibn Mes’udi dhe disa tabi’inë pohojnë se Jakubi e kishte shtyrë lutjen tek All-llahu deri në agim.¹⁹⁸

¹⁹⁵ Ibn Kesir, *Kazivanja ...*, op. cit., fq. 288. Ibn Kethiri përmend se nga ndarja e Jakubit prej Jusufit kishte kaluar 80 vjet. Ibid., fq. 288.

¹⁹⁶ Harun Yahya, op. cit., fq. 86-87.

¹⁹⁷ Me këtë kërkesë të vëllezërve të Jusufit, u sendërtuan të tri ëndërrat e përmendura në këtë sure. Shih: Muhammed El-Gazali, op. cit., fq. 260.

¹⁹⁸ Ibn Kethir-Ar, op. cit., fq. 48.

Nga tragjedia në gëzim

- Jakubi me familje te Jusufi a.s. në Egjipt -

Krahas njoftimit se Jusufi a.s. është gjallë dhe dëshmisë për këtë nëpërmjet këmishës së dërguar, kemi një moment shumë të rëndësishëm: dalja në shesh e gënjeshtres së vëllezërve të Jusufit me dekada të fshehur se gjoja Jusufin e ka ngrënë ujku.

Paso i ardhja e Jakubit a.s. dhe anëtarëve të tij te Jusufi në Egjipt. Mbreti urdhëroi të gjithë ministrat dhe dinjitarët që së bashku të dalin në pritje. Edhe vetë ishte në pritje.¹⁹⁹

Kur dolën para Jusufit, ai i përqafoi prindërit e tij dhe i përkujtoi se janë në të sigurtë. Kaptina mëson se përqaftimi është shenjë e mirë e dashurisë së sinqertë ndër njerëzit. Edhe shprehja se ata janë në të sigurtë është mirësjellje e rafinuar që qetëson dhe prehë palën tjetër pas gjithë atyre intrigave, shantazheve, gënjeshtreve dhe shpifjeve.

Jusufi a.s. tregoi edhe shenjë tjetër mirësie kundrejt prindërve, duke i ulur pranë vetes në fronin e sunduesit.

Jusufi a.s. tha:

¹⁹⁹ Dzermaludin Latic, *Stil...*, op. cit., fq. 382.

فَلَمَّا دَخَلُوا عَلَى يُوسُفَ أَوَىٰ إِلَيْهِ أَبُوهُ وَقَالَ ادْخُلُوا مِصْرَ إِن شَاءَ اللَّهُ
 آمِنِينَ وَرَفَعَ أَبُوهُ عَلَى الْعَرْشِ وَخَرُّوا لَهُ سُجَّدًا وَقَالَ يَا أَبَتِ هَذَا تَأْوِيلُ رُؤْيَايَ مِنْ
 قَبْلُ قَدْ جَعَلَهَا رَبِّي حَقًّا وَقَدْ أَحْسَنَ بِي إِذْ أَخْرَجَنِي مِنَ السِّجْنِ وَجَاءَ بِكُمْ مِنَ
 الْبَدْوِ مِنْ بَعْدِ أَنْ نَزَغَ الشَّيْطَانُ بَيْنِي وَبَيْنَ إِخْوَتِي إِنَّ رَبِّي لَطِيفٌ لِمَا يَشَاءُ إِنَّهُ هُوَ
 الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Dhe kur hynë te Jusufi, ai i përqafoi prindërit e vet dhe tha: "Hyni në Egjipt, në dashtë All-llahu, të sigurtë." Dhe ai i vendosi pirndërit e vet në fron dhe ata të gjithë iu përulën atij. Ai tha: "O babai im, ky është shpjegimi i ëndërrës sime të dikurshme. Krijuesi im e sendërtoi atë. All-llahu ka qenë i mirë ndaj meje kur më nxorri nga burgu dhe juve nga shkretëtira ju solli, pasi që shejtani ndërmjet meje dhe vëllezërve pati futur përçarje. Krijuesi im është me të vërtetë i mëshirshëm ndaj atij që dëshiron. Me të vërtetë ai është i dijshëm dhe i urtë!" (12, 99-100).

Në këtë ajet përdoret shprehja e përuljes (sexhdes). Mahlufi thekson tre versione rreth komentimit të përuljes, apo sexhdes:

1) Prindërit dhe vëllezërit e Jusufit a.s. i bënë sexhde All-llahut;

2) Prindërit dhe vëllezërit e Jusufit a.s. i bënë sexhde Jusufit; thuhet se ky rregull ishte i lejuar me sheriatin e Jakubit a.s.;

3) Me sexhde këtu nënkuptohet vetëm përulje me kokë, shenjë me kokë.²⁰⁰

Edhe Kurtubiu thekson disa mendime, e njëri nga mendimet është se për shkak të këtij nderi i kanë bërë sexhde All-llahut famëlartë. Mirëpo, vetë Kurtubiu

²⁰⁰ Mahluf, fq. 316, sipas: Enes Karic, op. cit., fq. 247.

mendon se kjo ishte një përkulje, traditë në Egjiptin e atëhershëm, dhe se kjo mënyrë e respektit ndaj njerëzve²⁰¹ është deroguar me ardhjen e Muhammedit a.s.:

رَبِّ قَدْ آتَيْتَنِي مِنَ الْمُلْكِ وَعَلَّمْتَنِي مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ فَاطِرَ السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضِ أَنْتَ وَلِيِّ لِي فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَأَلْحَقْنِي بِالصَّالِحِينَ ذَلِكَ مِنْ
أَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ أَجْمَعُوا أَمْرَهُمْ وَهُمْ يَمْكُرُونَ
وَمَا أَكْثَرُ النَّاسِ وَلَوْ حَرَصْتَ بِمُؤْمِنِينَ

"O Zoti im, ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar të shpjegoj ëndërrat. O Krijues i qiejve dhe Tokës, Ti je mbrojtësi im edhe në këtë edhe në botën tjetër; Më bëj të vdes mua si musliman dhe më bashko me ata që bëjnë mirë. Ja, këto janë disa lajme të panjohura që ne t'i shpallim ty, dhe ti nuk ke qenë me ata kur vendosën për punën e tyre dhe kur thurën kurtha. Kurse shumica e njerëzve, sado ti të dëshirosh, nuk do të jenë besimtarë!" (12, 101-103).

Siç shohim në ajetet përmbyllëse ceket duaja e Jusufit që ia drejtoi Krijuesit të tij, në të cilën e falënderon për begatitë dhe pushtetin që i janë dhuruar, por kërkon prej Tij që deri në vdekje ta ruajë në përkushtim Atij.

Muhammedit a.s. rrëfimet kur'anore i janë zbuluar si këshillë-mësim, të cilën e dëshmojnë ajetet e cekura. Qytetërimi i Arabisë para Islamit (shpalljes së Kur'anit) nuk kishte pika prekëse me pjesëtarët e feve qiellore, kristianët dhe hebraikët, dhe për këtë arsye çdo narracion vetëvetiu është nivel i jashtëzakonshëm

²⁰¹ Përujja që prindërit e Jusufit e bënë para Jusufit nuk ishte formë adhurimi, por një traditë e kohës së tyre. Shih edhe: Harun Yahya, op. cit., fq. 90.

(mu'xhize), sepse flitet për popujt për të cilët nuk ka pasur njohuri dhe fletë me besnikëri të plotë.²⁰²

Në Dhiatën e vjetër dhe të re ka shtrembërime të shpeshta kur flitet për plejadën e të përzgjedhurve të Zotit nga Ademi deri te Isai a.s. Shpeshherë disa pejgamberëve iu përshkruhen gjera të fëlliqura me çka goditet dinjiteti i tyre. Kur'ani për dallim prej tyre dinjitetin pejgamberik në çdo rrëfim e konsideron të pakontestueshëm dhe të padiskutueshëm.²⁰³ Duke mos u ndalur në hollësi, Kur'ani në tërë rrëfimet përdorë shprehjet figurative në përshkrimin e pozicioneve të caktuara, duke përdorur i'xhazin, si cilësi të jashtëzakonshme për të dëshmuar se Kur'ani buron nga gurra e amshueshmërisë.

²⁰² Mahlufi mendon se kjo është mrekulli, mu'xhize, sepse pa njoftimin kur'anor Muhammedi a.s. nuk do të dinte çka ka ndodhur për Jusufin a.s.. Mahluf, fq. 316, sipas: Enes Karic, op. cit., fq. 247.

²⁰³ Shih për trajtimin biblik të Josipit (Jusufit): Walter Beltz, *Mitologija Kur'ana – Čeznja za rajem*, Zagreb, 1982, fq. 100-108. Dhe: Malik Ibn Nebi, *Kur'anski fenomen*, Sarajevë, 1986, fq. 136-187.

Vdekja e Jusufit a.s.

Jusufi a.s. gjithnjë, në të gjitha fazat e jetës dhe në të gjitha gjendjet shoqërore, mbeti i pathyeshëm: sikur fëmijë, sikur rob, sikur i burgosur, si ministër. All-llahun e kishte pikësnyim. Atij i besonte, e përmendte, i frikësohej. Gjykonte sipas udhëzimeve të Tij dhe i zbatonte dispozitat e Tij. Nuk e preokuponte shumë pushteti, as nuk synonte të vdesë sikur pushtetar, apo të mishërohej me pushtetin. Preokupim i tij gjithnjë ishte "Krijuesi im, më dhurove pushtet dhe më mësove me shpjegimin e ëndërrave. Krijuesi i qiejve dhe tokës, Ti je mbrojtësi im në këtë dhe në botën tjetër; më ndihmo të vdes si musliman dhe më bashko me ata që janë të mirë."²⁰⁴

Jusufi a.s. u pleqërua. Jetonte në mirësi dhe në hare. Ishte tubuar familja dhe çdo gjë ishte në rregull. Ai e dinte se çdo gjë është kaluese. Jusufi a.s. iu lutë All-llahut: "O All-llah, na mundëso të jetojmë si muslimanë dhe të vdesim si muslimanë."²⁰⁵

Pas një kohe edhe vdiq. Kjo ishte ditë e rëndë për banorët e Egjiptit, e pikëllueshme dhe për një kohë të gjatë e paharrueshme. E varrosën edhe Jusufin a.s. Të vjetrit e mendonin si vdekjen e vëllait të tyre, kurse të rinjtë sikurse vdekjen e babait. Njerëzit njëri tjetrit i

²⁰⁴ En-Nedevi, *Priçe ...*, op. cit., fq. 61.

²⁰⁵ Ibn Kesir, *Kaživanja ...*, op. cit., fq. 294.

shprehnin ngushëllime. Ngushëllimet e popullit ndaj djemve të Jusufit ishin:

“Humbja juaj sot nuk është më e madhe se humbja jonë. Në atë që e varrosëm ne humbëm vëllain e dhembshëm, udhëheqësin e mëshirshëm dhe sunduesin e drejtë. Ky është ai që ua ka lehtësuar njerëzve dhe ka hequr padrejtësinë nga shteti. Ai ka penguar që të mëdhenjtë t’u bëjnë padrejtësi të vegjëlove dhe të fuqishmit të dobtëve. Ai ka ndihmuar të shkelurit, iu ka dhënë strehim të frikësuarve dhe ka ushqyer të uriturin. Ai na udhëzoi drejt të vërtetës. Ai na ftoi në besim të All-llahut. Para se të vinte kemi qenë sikurse kafshët që nuk dijnë për All-llahun dhe Ditën e gjykimit. Ai na ka ndihmuar gjatë viteve të urisë ashtu që kemi ngrënë dhe kemi qenë të ngritë, deri sa njerëzit nëpër vendet tjera vdisnin nga uria. Ne nuk do ta harrojmë kurrë sunduesin tonë bujar. Nuk do ta harrojmë as atë që ju jeni vëllezërit e tij. Sa qe gëzuar sunduesi ynë atë ditë kur ju erdhët në Egjipt. Sa i hareshëm ka qenë! Egjiptin konsideroni atdhe tuajin. Ne do t’u konsiderojmë juve ashtu si ju kemi konsideruar deri sa ishte gjallë Jusufi.”²⁰⁶

سُبْحَانَ رَبِّكَ رَبِّ الْعِزَّةِ عَمَّا يَصِفُونَ وَسَلَامٌ عَلَى الْمُرْسَلِينَ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ
رَبِّ الْعَالَمِينَ

“I pastër e i lartë është Zoti yt, Zoti i gjithfuqishëm nga ajo që ata i përshkruajnë. Çdo e mirë qoftë ndaj të dërguarëve. Dhe falënderimi i qoftë All-llahut, Zotit të gjithësisë!!” (Es-Saffat, 180-182.)

²⁰⁶ Ebu-l-Hasan En-Nedevi, *Kazivanja o vjerovjesnicima*, Novi Pazar, 2002, fq. 72-73.

Pasthënie

Tema e shtruar për pejgamberin e All-llahut të madhërueshëm, Jusufin a.s., është trajtuar në bazë të të dhënave nga Kur'ani, nga Hadithi dhe nga interpretimet e komentuesve më të njohur të Kur'anit, klasikë dhe bashkëkohorë.

Jemi përpjekur që mos të themi asgjë më shumë se që përmbanë literatura më besnike, më autentike Islame, pikërisht në frymën e ajetit kur'anor:

ذَلِكَ مِنْ أَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ أَجْمَعُوا أَمْرَهُمْ وَهُمْ يَمْكُرُونَ

“Ja, këto janë disa lajme të panjohura që ne t’i shpallim ty, dhe ti nuk ke qenë me ata kur vendosën për punën e tyre dhe kur thurën kurtha!” (Jusuf, 102).

Duke mësuar për Jusufin a.s., ne mësojmë të kaluarën, edukohemi nga urtësitë jetësore të pejgamberëve por edhe njoftohemi me jetën e tyre. Morali sipëror i tyre, arsyeja e jashtëzakonshme dhe devotshmëria e përkryer ndihmojmë t’i pranojmë për shembuj dhe t’i jetësojmë në jetën tonë të përditshme.²⁰⁷

Nuk duhet të harrojmë se në tërë këtë kaos kozmik, në tërë këto ndodhi befasuese, ka një plan të pagabueshëm, i cili funksionon sipas një rendi të pagabueshëm. Asgjë s’është e kot dhe rastësisht.

²⁰⁷ Abdulvehhab En-Nexhhar, op. cit., fq. 138-144.

وَكُلًّا نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ
وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ

“Të gjitha këto që t’i rrëfyem ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që ta forcojnë zemrën tënde, dhe në to të ka ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët.” (Hud, 120).

Pejgamberia përgjithësisht por edhe e Jusufit në veçanërisht është dhuratë që nuk mund të arrihet apo të fitohet. Zoti, me urtësinë e Tij, pejgamberinë ia ka dhuruar atij i cili është i gatshëm dhe i fuqishëm ta bartë atë. All-llahu më së miri e di ku dhe kur do të jetë me dobi më të madhe dërgimi i pejgamberit. Pejgamberët pa dushim ishin të gatshëm që porosinë pejgamberike t’ia përcjellin tërë njerëzisë. Ai ishte i përgatitur ta bartë porosinë e fesë më të përsosur *إِنَّ الدِّينَ* - “E vetmja fe e drejtë te All-llahu është feja islame.” (Ali Imran, 19), të bëhet pejgamberi i fundit *وَأَخَاتِمَ النَّبِيِّينَ* - “Vulë e të dërguarve” (El-Ahzab, 40), dritë unikale e udhëzimit dhe mëshirë për shekuj *وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ* - “Kurse ty të kemi dërguar vetëm nga mëshira ndaj botërave.” (El-Enbija`, 107).

Shtojcë

Shtojca 1: Porositë nga kaptina Jusuf

Studimi i vëmendshëm i kaptinave kur'anore, andaj edhe i kaptinës *Jusuf* nxjerr në pah disa përfundime, mësimë dhe synime. Nuk pretendojmë se kemi theksuar të gjitha porositë, por mendojmë se në parim janë përfshirë shumica e tyre. Kur'ani është mu'xhize dhe nuk mund të shterret vetëm me një lexim. Ai do të jetojë ndër njerëzit deri në Ditën e shkatërrimit (jewn'us-sa'atu):

1. Besimi në Zotin Një dhe i Vetëm (*Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.*) (El-Ihlas, 1-4).

2. Fuqia e All-llahut të vetëm është e pakufishme, e plotëfuqishme dhe e plotëpushtetshme. Asgjë nuk i paraprinë para dhe pas, herët e vonë.

3. All-llahu ka dërguar të dërguar e lajmëtarë kohë pas kohe për të udhëhequr njerëzinë në besimin e një All-llahu. Të gjithë ata janë një familje dhe plotësim i mësimit të atij që ishte para tij.

4. Të gjithë të dërguarit dhe lajmëtarët kanë qenë njerëz dhe kanë jetuar jetën e njerëzve të kohës së

tyre. Të gjithë ata janë ballafaquar me ngrohtesi dhe ftohtësi, me dashuri dhe dhembje, me uri dhe ngopësi, me shëndet dhe sëmundje, sikur të gjithë të tjerët.

5. Duke ftuar në besim në një Zot, si njerëz kanë ftuar shumë armiqë dhe kundërshtarë. Shumë prej të zgjedhurve të All-llahut e kanë lënë vendin e tyre dhe kanë vazhduar misionin e tyre në vend tjetër për ta mbjellë farën e mirësisë.

6. All-llahu i ka ndihmuar të dërguarit (rusul) dhe lajmëtarët (enbija) me mrekulli që u përshtateshin kohës dhe rrethanave të tyre për të vërtetuar se misioni i tyre është hyjnor.

7. Të dërguarit e All-llahut kanë qëndruar të patyeshëm para mundimeve të kundërshtarëve deri në fitore ose deri sa kundërshtarët janë dënuar prej All-llahut të madhëruar.

8. All-llahu i shpërblen me xhennet besimtarët që kanë përkrahur dhe ndihmuar të dërguarit dhe lajmëtarët e All-llahut, duke ndjekur mësimet, udhëzimet dhe zbatimin praktik të fesë.

9. Të dërguarit dhe lajmëtarët kanë vuajtur dhe janë munduar nga popujt e tyre. Për këtë arsye, ata duhet të jenë të pajisur me virtytin e durimit, të punës, me oratori dhe metoda efikase të të ftuarit, duhet të kenë shpresë në ndihmën e All-llahut dhe në fitoren përfundimtare të fesë së tyre.²⁰⁸

²⁰⁸ Shih: Imam Vehbi Ismaili, *Jusufi i drejt*, botimi I, Michigan, USA, 1415-1994, fq. III-IV.

Shtojca 2: Karakterizimi i personazhëve

Jusufi a.s.: Fëmijë i dashur, i aftë, inteligjent. I edukuar dhe arsimuar drejtë në fëmijëri të hershme, por i pafat në fëmijëri të vonshme.

I pjekur për detyra të mëdha, i gatshëm të qëndrojë në burg vetëm e vetëm që ta ruajë pastërtinë morale dhe të mos bëjë mëkat. Edhe në çastet e rënda gjatë burgut ndjek parimin e drejtë: besimin e mirëfilltë. Ua fali të gjithë atyre që i kanë shkaktuar dëm atij, pra i fali edhe vëllezërit e tij.

Letrarët Jusufin e krahasojnë me arin: sa më shumë që farkohet aq më i ndritshëm është. Drita e tij përshkon mileniume të tëra dhe reflekton edukatë e pastërti morale, arsimim e profesionalizëm, parimësi dhe këmbëngulësi.

Jakubi a.s.: I Dërguar i Zotit i qetë, baba i kujdesshëm por edhe i pikëlluar. Ka hetuar aftësitë e jashtëzakonshme të Jusufit qysh në fëmijëri. Kurrë nuk e humb shpresën tek All-llahu, përkundër vështirësive të shumta. Pejgamber i qetë që përballet me lajmin e gëzueshëm dhe me frikën nga veprimi i shejtanit në shpirtrat e djemve të tij.

Vëllezërit e Jusufit: Ngatërrestarë dhe ziliqarë. Kur synojnë të bëjnë mëkat i brenë ndërgjegjja. Thurin gënjeshtër për t'i mbuluar mëkatet dhe gabimet e tyre. Në fund kërkojnë falje për gabimet e tyre.

Benjamini: Vëllai i vetëm i Jusufit nga dy prindërit. Djali më i ri i Jakubit a.s., figurë dytësore në rrë-

fim. Ka qenë shpresa dhe ngushëllimi i Jakubit, me virtyte morale të babait dhe vëllait Jusufit.

Gruaja e Ministrit: Zulejhaja, e pafatshme, e vetmuar, shpirtlig dhe atakuese, pa vetëdije fetare, por jo krejt negative. Ajo përpiqet ta ndëshkojë Jusufin, por jo ta dënojë me mbytje apo diç të ngjashme. Në fund, kërkon falje, pendohet për gabimet e bëra dhe sendërtton synimet e saj.

Mbreti: Pa vetëdije fetare, por njeri me qëllime të mira dhe i brengosur për popullin dhe shtetin e tij. I aftë, i urtë dhe largpamës që ta caktojë njeriun e aftë në vend përkatës për të ardhmen e shtetit dhe popullit.

Në literaturë, nga mosnjohja e historisë, shpesh është quajtur edhe Faraon. Sa herë që përmendet si faraon mendohet për Mbretin për kohën e Jusufit. Ai nuk i takonte familjes së faraonëve.

Ministri (Azizi): Zemërmirë, bujar por i pa vetëdije fetare. I pafat me gruan e tij, ndoshta për shkak të pleqërisë dhe impotencës. Burrë i kujdesshëm ndaj Zulejhës por edhe i paaftë të qeverisë me familjen.

Aziz në kohën e Mbretit të Jusufit quhej Ministri i rëndësishëm. Pas tij edhe Jusufi është quajtur aziz.

Shokët e Jusufit në burg: Idhujtarë, shërbetorë te sunduesi. Të aftë të dëgjojnë, të brengosur, por të dhembshëm; njëri i pafatshëm, kurse tjetri mendjelehtë dhe harrestarë.²⁰⁹

²⁰⁹ Shih: Džemaludin Latič, *Stil...*, op. cit., fq. 383-395. Disa përshkrime rreth personazheve shih edhe: Abd Al-Wahab Bouhdiba, *Seksualiteti në Islam*, op. cit., fq. 26 e tutje.

Shtojca 3: Ndikimi i kaptinës kur'anore 'Jusuf' në kulturën dhe qytetërimin islam në hapësirën gjithëshqiptare

*Për Shqipërinë u përpoqa
Rezikova jetën t'ime
Nuk rëfeket se sa hoqa
Se shteti m'i njihte krime.
(H. A. Korça, Shtat ëndrat, fq. 30)*

I. Shqyrtimi hyrës

Populli shqiptar një periudhë të gjatë kohore të historisë së vet e ka të lidhur ngushtë me islamin dhe muslimanët, pra edhe me Perandorinë Osmane. Gjatë kësaj periudhe populli shqiptar ka krijuar një pasuri, trashëgimi shumë të pasur e të vlefshme në aspektin krijues kulturor, politik e fetar. Edhe pse gjatë kësaj kohe kishte mosmarrëveshje të kohëpaskohshme midis popullit shqiptar dhe perandorisë osmane, megjithatë këta dy faktorë kanë qenë ngushtë të lidhur mes vete. Këtë bashkëpunim e dëfton dhe dëshmon gjeniu krijues në fushën fetare, arsimore-edukative, kulturore-qytetëruese shqiptare, që paraqet një thesar të mirëfilltë.²¹⁰ Edhe pse u krijua në faza të ndryshme historike dhe në rrethana të vështira, e kaluara tregon një shpirt të pasur krijues.

²¹⁰ Shih një pasqyrë të shkurtër të një pjese të krijimtarisë: Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, Prizren, 1411/1991, 9-111; Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare*, I-II, Shkup, 2000 etj.

Për fat të keq, krijimtaria shqiptare e proveniencës islame në fe, kulturë, histori, artë, letërsi, etj., nuk pati trajtim dhe pranim të barabartë apo të përafërt me krijimtarinë e proveniencës kristiane, qoftë ortodokse qoftë katolike. Këtë e ka theksuar më herët edhe Hasan Kaleshi²¹¹ por edhe Osman Myderrizi²¹². Thua jse institucionalisht por edhe individualisht përparësia ishte në anë të krijimtarisë kristiane dhe laike duke e lënë në harresë krijimtarinë e autorëve të proveniencës muslimane. Kjo gjendje është e pranishme edhe në fillim të shekullit XXI. Madje, disa prej tyre, si Ismail Kadare, kanë qëndrim mohues. Ai krijimtarinë shqiptare islame më tepër e përjeton si të huaj, incident kalimtar, si armiqësore se sa si krijimtari të popullit shqiptar brenda popullit shqiptar dhe për popullin shqiptar. Gëzon fakti se edhe autori Isak Ahmeti, shpesh me disponim antiislam, kundërshton mendimin e Kadaresë se islami është “incident kalimtar”, por shtonë se “Roli i Kur’anit, i fesë dhe kulturës islame ndër shqiptarët ka qenë i një rëndësie të veçantë dhe jo incident kalimtar, ... se që nga përhapja institucionale e Islamit në trojet etnike shqiptare (fundi i shekullit XIV) e deri më sot, ai ka frymëzuar, ..., jetën shpirtërore dhe kulturore të

²¹¹ Krijimet e proveniencës kristiane edhe pse thua jse të gjitha të shkruara me dirigjim nga Vatikani apo Patrikana dhe ishin të angazhuara kundër pjesës shumicë dmth. kundër shqiptarëve muslimanë, krijimet e proveniencës shqiptare muslimane rezultonin nga shtresat e ulta, të varfëra, shpesh të adresuara kundër të pasurve, bujarëve dhe feudalëve. Shih: Hasan Kaleshi, op. cit., fq. 9-11.

²¹² “...për tekstet me alfabetin arab s’u bë asnjë kërkim...”. Osman Myderrizi, *tekstet e Vjetra Shqip me Alfabetin Arab*, Tiranë, 1965, fq. 288.

shqiptarëve, ka frymëzuar bukur mirë edhe një pjesë të madhe të letërsisë sonë...”.²¹³

II. Jusufi dhe Zulejhaja te disa autorë botërorë

Tërë Kur’ani por edhe sureja / kaptina Jusuf e Kur’anit dhe vetë mënyra e rrëfimit kur’anor, ka bërë një ndikim të madh te komentuesit e Kur’anit, si te Taberiu, Raziu, Zamahsheriu, Ibn Abbasi, Ibn Kethiri, Kutbi²¹⁴, por edhe te shumë sufi si Ibn Arebiu²¹⁵ dhe letrarë, historianë e krijues të tjerë, si Firdevsi, Xhamiu, Attari, Sadiu²¹⁶, Ibn Xhevziu, etj..²¹⁷ Këta emra tregojnë se me këtë problematikë janë marrë jo vetëm arabët, por edhe persianët, turqit, urdët, malajët. Por, me këtë temë janë marrë edhe në Evropë: gjermanët, sikur te Gëte²¹⁸, italianët, sikur te Danteja, spanjollët,

²¹³ Shih shkrimin: Isak Ahmeti, Kur’ani në letërsinë shqiptare, në: http://www.seguraweb.nl/1a1/arspoetica_artikujt.php?id=196.

²¹⁴ Një pasqyrë më të plotë për komentuesit e Kur’anit mund të marrim nga pjesa qendrore e këtij libri. Shih edhe: Jusuf Ali, *The Holy Qur’an. Text, Translation and Commentary*, Maryland, USA, 1983, fq. 548.

²¹⁵ Sufitë kishin prirje për temën e Jusufit dhe Zulejhasë. Shih: Annemarie Schimmel, *Odgonetanje Božijih znakova - Fenomenološki pristup islamu*, Sarajevë, 2001, fq. 198. Edhe gjermanja e kohës sonë, A. Schimmel, ka treguar interesim të veçantë për Jusufin dhe Zulejhanë. Shih: *Yusuf in Mawlana Rumi’s poetry*, në: L. Lewisohn ed., 1991, *The Legacy of Mediaeval Persian Sufism*, fq. 45-60.

²¹⁶ Duke iu falënderuar Vexhi Buharasë, në gjuhën shqipe kemi pjesë të zgjedhura të Saadiut. Ky shkrim dëshmon ndikimin e kaptinës Jusuf te Sadiu por edhe te autorët shqiptarë. Shih: *Sadiu, Gjulistani dhe Bostani*, Tiranë, 2003, fq. 31, 104.

²¹⁷ Shih gjerësisht për interesimet e të tjerëve për temën e Jusufit dhe Zulejhasë: Adnan Ismaili, *Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe*, punim magjistrate, dorëshkrim, Prishtinë, 2003, fq. 41 e tutje.

²¹⁸ Për ndikimin e muslimanëve te Gëte, pra edhe të temës së Jusufit dhe

francezët²¹⁹, serbët etj. Përjashtim nuk janë as boshnjakët e shqiptarët etj.

Është interesant se kohëve të fundit autorët kanë trajtuar edhe një segment të shpërfillur deri tash, atë ekonomik. Ndonëse të gjithë autorët flasin për aftësinë e Jusufit në fushën e administrimit ekonomik, disi kanë kaluar mbi këtë aspekt. Gëzon fakti që dikush edhe këtë aspekt e mbuloi, duke vënë bazat e një ekonomie islame.²²⁰ Të shpresojmë se në të ardhmen do të trajtohen edhe aspektet tjera të jetës dhe veprës së Jusufit a.s.: politike, psikologjike, pedagogjike, etj.

III. Jusufi dhe Zulejhaja te disa autorë shqiptarë

Përkundër tendencave që krijimtaria shqiptare e proveniencës islame të shpërfilllet dhe t'i mohohet identiteti dhe fizionomia, studimet e mirëfillta shkencore çdo ditë e më shumë dëshmojnë dhe tregojnë se ajo është mjaft e avansuar dhe me vlera artistike të larta e të pamohueshme, madje me një prapavijë krijuese, shoqërore dhe politike shumë të shëndoshë dhe autoktone. Disa të tjerë këtë krijimtari e radhisin ndër tre shtyllat e literaturës shqiptare, krahas asaj orale dhe shkrimit biblik.²²¹

Zulejhasë shih gjerësisht: *Hafiz i Gete*, përmbledhje punimesh nga grup autorësh, Beograd, 2003.

²¹⁹ Për ndikimet islame ndër evropianët apo për disa aspekte letrare shih studimin: Milazim Krasniqi, *Soneti në poezinë shqipe*, Prishtinë, 2005, fq. 18 e tutje.

²²⁰ Nevvaf bin Salih El-Hulejsi, *El-Menhexh'ul-iktisadi fi't-tahtiti li nebijjil-lahi Jusuf alejhís-selam*, Rijad, 652. Libri paraqet tezë doktore. Për këtë të dhënë e falënderoj zotëri mr. Adnan Ismailin.

²²¹ Shih gjerësisht: Isak Ahmeti, op. cit.

Kur'ani dhe kaptina *Jusuf* kanë ndikuar në shumë pikëpamje të krijuesit shqiptarë. Kësaj teme i shkruan edhe shumë të tjerë në rrafshin gojor, si imamët, hatibët, vaizët, kënduesit e ilahive, nëpër xhami, ndeje fetare apo ndeje të lira.

Krahas rrafshit fetar gojor ndikimi i Kur'anit dhe i kaptinës Jusuf është evident edhe në rrafshin fetar të shkruar të imamët dhe vaizët, në rrafshin fetaro-letrar të poetët me ilahi e kaside, të historianët nëpërmjet librave të historisë islame mbi pejgamberët. Është interesant se thuajse të gjithë autorët që janë preokupuar me Jusufin dhe Zulejhanë e kanë njohur gjuhën arabe në origjinal e jo nga përkthimet.

Tema e Jusufit, sikurse edhe tërë krijimtaria shqiptare islame, ka pasur një shtrirje gjithëshqiptare si në kohë ashtu edhe në hapësirë. Ajo nuk është karakteristike e një zone gjeografike shqiptare, apo e një rrymimi ideor. Jusufi dhe Zulejhaja trajtohen njësoj të imamët në xhami apo të shejhët në teqe. Këtë e dëshmojnë emrat e ndryshëm dhe krijimet e ndryshme nëpër fazat e ndryshme historike.

Ndër autorët e hershëm shqiptarë që shkroi për Jusufin dhe Zulejhanë (në gjuhë turke) është Jahja bej Dukagjini (vdiq 1582), i cili e shkroi poemën *Jusufi dhe Zulejhaja*²²², sipas tij nga origjinali e jo nga përkthimet persiane.²²³

Në mesin e atyre që krijuan në mënyrë origjinale e që shkrimet e tyre kanë arritur deri te ne janë edhe

²²² Sipas: Adnan Ismaili, op. cit. fq. 55-56.

²²³ Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, Prizren, 1411/1991, fq. 21.

Muhamed Kuçuk Çami (1782-1884)²²⁴, Hafiz Ali Korça (1873-1956)²²⁵, Çajupi²²⁶, Haki Sharofi²²⁷ e të tjerë, të cilët trajtuan jo vetëm në aspektin letrarë, por edhe historik, edukativ, filozofik, politik, ekonomik etj.

Duhet pranuar faktin se, në rastin konkret, tema e Jusufit dhe Zulejhasë në nënqiellin shqiptar më tepër ka provokuar shkrimet letrare e më pak ose fare pak rrafshet tjera që përmendëm më sipër. Megjithatë, edhe këto shkrime dhe studime janë mjaft të arsyeshme dhe ndoshta çelësi hyrës për studime më të gjera e më të specializuara.²²⁸

Muhamed Çami shkroi poemën *Jusufi dhe Zulejhaja*. Sipas studiuesve, M. Çami realizimin e tij e bëri edhe në mbështetje të Kur'anit dhe traditës islame por edhe në bazë të autorëve botërorë si Firdevsi, Xhamiu e Attari. Këtë ia ka mundësuar M. Çamit njohja e shkëlqyeshme e Islamit dhe e trashëgimisë së tij por edhe i gjuhëve orientale.²²⁹

Pa dyshim, poema *Jusufi dhe Zulejhaja* e M Çamit “me vlerat e larta strukturore që ka, me fenomenin

²²⁴ Muhamed Çami, *Jusufi dhe Zulejhaja*, në përgatitje të Ibrahim D. Hoxha, Tiranë, 1992.

²²⁵ Hafiz Ali Korça, *Historija e shenjtë edhe të katër Halifetë*, Tiranë, 1931.

²²⁶ Për shkak se nuk është preokupim yni parësor në këtë shkrim, nuk jemi interesuar te gjejme burimin, por huazuar shënimin nga: Hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjve*, Prishtinë, 1987, fq. 205.

²²⁷ Haki Sharofi, *Edukata fetare e morale*, pjesa IV, Tiranë, 1939.

²²⁸ Kohëve të fundit kemi disa sosh: Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare, I-II*, Shkup, 2000; Ismail Ahmedi, *Hafiz Ali Korça - Jeta dhe vepra (temë doktrature)*, Shkup, 1419-1999; Qazim Qazimi, *Jeta dhe vepra letrare e Muhamed Çamit (temë doktrature)*, Prishtinë, 2002; Adnan Ismaili, *Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe (punim magjistrature)*, Prishtinë, 2003 etj.

²²⁹ Adnan Ismaili, op. cit., fq. 77-79.

kompozicional dhe dramatik, me pasurinë shpirtërore të personazheve, me gjuhën poetike që ka²³⁰, ka hapur rrugë të reja, ka trasuar shtigje shumëdimensionale dhe paraqet gurrë, burim por edhe sfidë për studime e vlerësime të drejta.

Me *Jusufin e Zuejhanë* u preokupua edhe Hafiz Ali Korça. Ai shkroi poemën origjinale *Jusufi me Zelihane a më e bukura e ngjarjeve (ahsen-ul-kasas)*²³¹. Normalisht, te Korça, sikur edhe te Çami, kemi përshkrim artistik të ndodhisë, por ky përshkrim është në frymën e buri-meve islame, e jo trillim i kulluar i imagjinatës së poetit. Leximi i kujdesshëm i këtij krijimi, vlerësimet shkencore që i janë bërë deri tash kësaj poeme, tregojnë dhe udhëzojnë se hafiz Ali Korça dëshmon ndikimin e fuqishëm të Kur'anit në këtë krijim. Me këtë por edhe me veprat e tjera,²³² Korça i bëri vetes vend të merituar në historinë shqiptare dhe veçanërisht në historinë e letërsisë moderne shqiptare.

Ndër ata që u preokupuan me Jusufin dhe Zuejhanë është edhe imami shumë i dalluar Vehbi Ismaili, i cili emigroi nga Shqipëria në SHBA dhe atje punoi shumë. Ky autor i vyeshëm shkroi veprën në dy vëllime²³³ me titull *Historia e pejgamberëve*, e një kaptinë ia kushtoi Jusufit a.s.²³⁴. Imam Vehbiu shkroi edhe një

²³⁰ Isak Ahmeti, op. cit..

²³¹ Hafiz Ali Korça, *Jusufi me Zelihane a më e bukura e ngjarjeve (ahsen-ul-kasas)*, Elbasan, 1342-1923, sipas: Adnan Ismaili, op. cit., fq. 86.

²³² Komplet i veprave të H.A. Korçës botuar nga Sh.B. Logos-A, Shkup, 2006.

²³³ Në përgatitje e sipër është kompleti i veprave të Iman Vehbi Ismailit nga Sh.B. Logos-A.

²³⁴ Imam Vehbi Ismaili, *Historia e pejgamberëve, II*, botim'i parë, Michigan, USA, 1419-1998, fq. 1-30.

vepër tjetër në formë drame me titull *Jusufi i drejt*, ndoshta vepra e parë e këtij lloji në gjuhën shqipe.²³⁵

Ekzistojnë edhe shkrime të tjera²³⁶, por ne do të mjaftohemi duke përmendur vetëm disa shembuj me krijime origjinale të zhanreve të ndryshme.

²³⁵ Imam Vehbi Ismaili, *Jusufi i drejt, botim'i parë*, Michigan, USA, 1415-1994, fq. 162.

²³⁶ Ndër ta është edhe: Zejnullah Rrahmani, *Jusufi*, Pejë, 2000.

Shtojca 4: Tabela e të dhënave krahasuese në rrëfimin mbi Jusufin a.s.

Nr. i ajetit kur'anor	Versioni kur'anor	Versioni biblik	Vërejtje²³⁷
1-3	Hyrja e vendos rrëfimin në suaza të fenomenit religjioz	Hyrja që e vendos rrëfimin në suaza familjare	Dallim
4-6	Ëndrra e Jusufit a.s.	Dy ëndrra të Josipit	Dallim
7-15	Shkuarja e Jusufit a.s. të cilin Jakubi a.s. e beson pas kurthës	Shkuarja e Josipit me urdhëresë të Jakobit	Dallim
16-18	Dyshimi i Jakubit a.s. dyshon në fëmijët e tij dhe shpresa e tij pas intrigës	Mendjehetësia e Jakobit dhe dëshpërimi i tij pas intrigës	xxx

²³⁷ Kryesisht sipas: Malik Ibn Nebi, op. cit., fq. 175-177.

19-20	Shitja e Jusufit a.s. dhe ardhja e tij në Egjipt	Versioni i njëjtë	Versioni kur'anor thekson intervenimin e Zotit
24	Sprova e Jusufit a.s. dhe ndihma e Zotit	Mungon	xxx
25	Gruaja e ministrit e grisi këmishën	Gruaja e mbajti këmishën (pelerinën)	xxx
27-29	Bashkëshorti i saj moralisht e gjykon	Zemërimi i burrit të saj kundër Josipit	Dallim
30-31	Skandali në qytet dhe takimi i grave të qytetit	Mungon	xxx
33-34	Lutja e Jusufit a.s. para këmbëngulësisë së gruas	Mungon	Në Kur'an më shumë shprehet i dërguari
37-40	Predikimi i Jusufit a.s. shokëve të tij	Mungon	xxx
41	Nga Jusufi a.s. kërkohet shpjegimi i dy ëndrrave	Shpjegim ofron Josipi	Dallim

49	Parashikimi i vitit te bollëkut dhe kënaqësisë	Mungon	xxx
50-53	Epilogu psikologjik i burgut të Jusufit me pranimit e gruas	Epilogu politik në bazë të ëndrrës së mbretit	Aspekti shpirtëror është më i theksuar në Kur'an
54	Rehabilitimi i Jusufit a.s.	Misioni i besuar Josipit	Drejtësia në Kur'an. Politika në Bibël.
55	Jusufi a.s. kërkon detyrën e drejtorit të furnizimit	Detyra e drejtorit i ofrohet	Dallim
56	Predikim mbi mëshirën e Zotit	Mungon	xxx
57	Preokupimi me botën tjetër	Mungon	Religjioni është më i shprehur në Kur'an
58-61	Skena e takimit të Jusufit a.s. me vëllezërit e tij.	Tekst tjetërfare	Jusufi a.s. në Kur'an është më tepër peygamber

63-67	Shkaku i kthimit në Egjipt: veprimi i fëmijëve të Jakubit para tij.	Shkaku i kthimit në Egjipt: urdhëri i Jakubit i cili si duket e la Shimunitin para fatit të tij	Akuza për spiunazh dhe për burgosje të Shimunit mungon në Kur'an
68-69	Ardhja në Egjipt dhe kurthi i Jusufit a.s.	Njëjtë	xxx
70-79	Shkuarja e vëllezërve të Jusufit a.s., Burgosja e Benjaminut.	Tekst tjetërfare.	xxx
80	Këshillimi i vëllezërve	Mungon.	xxx
81-87	Kthimi i djemve të Jakubit i cili iu preferon shpresë dhe këmbëngulësi.	Mungon.	xxx
88	Shkuarja e vëllezërve në Egjipt të Jusufi a.s.	Mungon.	xxx
89-92	Skena e epilogut dhe falja e Jusufit a.s.	Epilogu me emocionimin e Josipit	Dallim

93	Dërgimi i këmishës së Jusufit a.s. babait të tij	Mungon	xxx
94-95	Parandjenja e Jakubit a.s.	Mungon	xxx
96-100	Shërimi i Jakubit a.s., falja për djemtë e tij dhe lutja e Jusufit a.s.	Mungon	xxx
101-102	Përfundimi i Jusufit a.s. dhe fundi i rrëfimit	Mungon	Sërish është theksuar nota spirituale në Kur'an

Shtojca 5:

سورة يوسف:

سورة يوسف

- الر تِلْكَ آيَاتُ الْكِتَابِ الْمُبِينِ ﴿1﴾
 إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿2﴾
 نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ وَإِن كُنْتَ
 مِنْ قَبْلِهِ لَمِنَ الْغَافِلِينَ ﴿3﴾
 إِذْ قَالَ يُوسُفُ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ إِنِّي رَأَيْتُ أَحَدَ عَشَرَ كَوْكَبًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ
 رَأَيْتُهُمْ لِي سَاجِدِينَ ﴿4﴾
 قَالَ يَا بَنِيَّ إِنِّي أَخُصُّكُمْ بِرُؤْيَايَ لَئِن كُنْتُمْ إِخْوَتِي فَعِكَدُوا لِي كَيْدًا إِنَّ الشَّيْطَانَ
 لِلْإِنْسَانِ عَدُوٌّ مُبِينٌ ﴿5﴾
 وَكَذَلِكَ يَجْتَبِيكَ رَبُّكَ وَيُعَلِّمُكَ مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ وَيُتِمُّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ
 وَعَلَى آلٍ يَعْقُوبُ كَمَا أَتَمَّهَا عَلَى أَبَوَيْكَ مِنْ قَبْلُ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ إِنَّ رَبَّكَ عَلِيمٌ
 حَكِيمٌ ﴿6﴾
 لَقَدْ كَانَ فِي يُوسُفَ وَإِخْوَتِهِ آيَاتٍ لِلْسَّانِلِينَ ﴿7﴾
 إِذْ قَالُوا لِيُوسُفُ وَأَخُوهُ أَحَبُّ إِلَيْنَا مِنَ أَبِينَا إِنَّ أَبَانَا لَفِي ضَلَالٍ
 مُبِينٍ ﴿8﴾
 اقْتُلُوا يُوسُفَ أَوْ اطْرَحُوهُ أَرْضًا يَخْلُ لَكُمْ وَجْهُ أَبِيكُمْ وَتَكُونُوا مِنْ بَعْدِهِ
 قَوْمًا صَالِحِينَ ﴿9﴾
 قَالَ قَائِلٌ مِنْهُمْ لَا تَقْتُلُوا يُوسُفَ وَأَلْقُوهُ فِي غِيَابَةِ الْجُبِّ يَلْتَقِطْهُ بَعْضُ
 السَّيَّارَةِ إِن كُنتُمْ فَاعِلِينَ ﴿10﴾
 قَالُوا يَا أَبَانَا مَا لَكَ لَا تَأْمَنَّا عَلَى يُوسُفَ وَإِنَّا لَهُ لَنَاصِحُونَ ﴿11﴾

أَرْسَلَهُ مَعَنَا غَدًا يَرْتَعُ وَيَلْعَبُ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿12﴾
 قَالَ إِنِّي لِيَحْزُنِّي أَنْ تَذْهَبُوا بِهِ وَأَخَافُ أَنْ يَأْكُلَهُ الذِّئْبُ وَأَنْتُمْ عَنْهُ
 غَافِلُونَ ﴿13﴾

قَالُوا لَنْ نَأْكُلَهُ الذِّئْبُ وَنَحْنُ عُصْبَةٌ إِنَّا إِذَا لَخَاسِرُونَ ﴿14﴾
 فَلَمَّا ذَهَبُوا بِهِ وَاجْتَمَعُوا أَنْ يَجْعَلُوهُ فِي غِيَابَةِ الْجَبِّ وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِ لَتُنَبِّئَهُمْ
 بِأَمْرِهِمْ هَذَا وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ﴿15﴾

وَجَاءُوا أَبَاهُمْ عِشَاءً يَبْكُونَ ﴿16﴾
 قَالُوا يَا أَبَانَا إِنَّا ذَهَبْنَا نَسْتَبِقُ وَتَرَكْنَا يُوسُفَ عِنْدَ مَتَاعِنَا فَأَكَلَهُ الذِّئْبُ وَمَا
 أَنْتَ بِمُؤْمِنٍ لَنَا وَلَوْ كُنَّا صَادِقِينَ ﴿17﴾

وَجَاءُوا عَلَى قَمِيصِهِ بِدَمٍ كَذِبٍ قَالَ بَلْ سَوَّلَتْ لَكُمْ أَنْفُسُكُمْ أَمْرًا فَصَبْرًا
 جَمِيلًا وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ عَلَى مَا تَصِفُونَ ﴿18﴾
 وَجَاءَتْ سَيَّارَةٌ فَأَرْسَلُوا وَارِدَهُمْ فَأَدْلَى دَلْوَهُ قَالَ يَا بُشْرَى هَذَا غُلَامٌ

وَأَسْرُوءُ بِضَاعَةٍ وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِمَا يَعْمَلُونَ ﴿19﴾

وَشَرَّوهُ بِشَمْنٍ بَخْسٍ دَرَاهِمَ مَعْدُودَةٍ وَكَانُوا فِيهِ مِنَ الزَّاهِدِينَ ﴿20﴾
 وَقَالَ الَّذِي اشْتَرَاهُ مِنْ مِصْرَ لِامْرَأَتِهِ أَكْرِمِي مَثْوَاهُ عَسَى أَنْ يَنْفَعَنَا أَوْ نَتَّخِذَهُ
 وَلَدًا وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ وَلِنُعَلِّمَهُ مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ وَاللَّهُ غَالِبٌ
 عَلَى أَمْرِهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿21﴾

وَلَمَّا بَلَغَ أَشُدَّهُ آتَيْنَاهُ حُكْمًا وَعِلْمًا وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿22﴾
 وَرَاوَدَتْهُ الَّتِي هُوَ فِي بَيْتِهَا عَنْ نَفْسِهِ وَغَلَّقَتِ الْأَبْوَابَ وَقَالَتْ هَيْتَ لَكَ قَالَ
 مَعَاذَ اللَّهِ إِنَّهُ رَبِّي أَحْسَنَ مَثْوَايَ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الظَّالِمُونَ ﴿23﴾

وَلَقَدْ هَمَّتْ بِهِ وَهَمَّ بِهَا لَوْلَا أَنْ رَأَى بُرْهَانَ رَبِّهِ كَذَلِكَ لِنَصْرِفَ عَنْهُ السُّوءَ
 وَالْفَحْشَاءَ إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا الْمُخْلَصِينَ ﴿24﴾

وَاسْتَبَقَا الْبَابَ وَقَدَّتْ قَمِيصَهُ مِنْ دُبُرٍ وَأَلْفَيَا سَيِّدَهَا لَدَى الْبَابِ قَالَتْ مَا
 جَزَاءُ مَنْ أَرَادَ بِأَهْلِكَ سُوءًا إِلَّا أَنْ يُسْجَنَ أَوْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿25﴾

قَالَ هِيَ رَاوَدْتَنِي عَنْ نَفْسِي وَشَهِدَ شَاهِدٌ مِنْ أَهْلِهَا إِنْ كَانَ قَمِيصُهُ قَدْ مِنْ
قَبْلِ فَصَدَقَتْ وَهُوَ مِنَ الْكَاذِبِينَ ﴿26﴾

وَإِنْ كَانَ قَمِيصُهُ قَدْ مِنْ ذُبُرٍ فَكَذَبَتْ وَهُوَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿27﴾

فَلَمَّا رَأَى قَمِيصَهُ قَدْ مِنْ ذُبُرٍ قَالَ إِنَّهُ مِنْ كَيْدِكَ إِنْ كَيْدُكَ عَظِيمٌ ﴿28﴾

يُوسُفُ أَعْرَضَ عَنْ هَذَا وَاسْتَغْفِرِي لِذَنبِكَ إِنَّكَ كُنْتَ مِنَ الْخَاطِئِينَ ﴿29﴾

وَقَالَ نِسْوَةٌ فِي الْمَدِينَةِ امْرَأَتُ الْعَزِيزِ تُرَاوِدُ فَتَاهَا عَنْ نَفْسِهِ قَدْ شَغَفَهَا حُبًّا إِنَّا

لَنَرَاهَا فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ ﴿30﴾

فَلَمَّا سَمِعَتْ بِمَكْرِهِنَّ أَرْسَلَتْ إِلَيْهِنَّ وَأَعْتَدَتْ لَهُنَّ مُتَّكًا وَأَتَتْ كُلَّ وَاحِدَةٍ

مِنْهُنَّ سَكِينًا وَقَالَتْ أُخْرَجَ عَلَيْهِنَّ فَلَمَّا رَأَيْنَهُ أَكْبَرْنَهُ وَقَطَّعْنَ أَيْدِيَهُنَّ وَقُلْنَ حَاشَ لِلَّهِ

مَا هَذَا بَشَرًا إِنْ هَذَا إِلَّا مَلَكٌ كَرِيمٌ ﴿31﴾

قَالَتْ فَذَلِكُنَّ الَّذِي لُمْتُنَنِي فِيهِ وَلَقَدْ رَاوَدْتُهُ عَنْ نَفْسِهِ فَاسْتَعْصَمَ وَلَئِن لَّمْ

يَفْعَلْ مَا أَمَرُهُ لَيَسْجُنَنَّ وَلَيَكُونَنَّ مِنَ الصَّاعِرِينَ ﴿32﴾

قَالَ رَبِّ السِّجْنُ أَحَبُّ إِلَيَّ مِمَّا يَدْعُونَنِي إِلَيْهِ وَإِلَّا تَصْرِفْ عَنِّي كَيْدَهُنَّ

أَصْبُ إِلَيْهِنَّ وَأَكُنْ مِنَ الْجَاهِلِينَ ﴿33﴾

فَاسْتَجَابَ لَهُ رَبُّهُ فَصَرَفَ عَنْهُ كَيْدَهُنَّ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿34﴾

ثُمَّ بَدَأَ لَهُمْ مِنْ بَعْدِ مَا رَأَوُا الْآيَاتِ لَيَسْجُنُنَّهُ حَتَّى حِينٍ ﴿35﴾

وَدَخَلَ مَعَهُ السِّجْنَ فَتَيَانٍ قَالَ أَحَدُهُمَا إِنِّي أَرَانِي أَعْصِرُ خَمْرًا وَقَالَ الْآخَرُ

إِنِّي أَرَانِي أُحْمَلُ فَوْقَ رَأْسِي خُبْرًا تَأْكُلُ الطَّيْرُ مِنْهُ نَبْنَأُ بِتَأْوِيلِهِ إِنَّا نَرَاكَ مِنَ

الْمُحْسِنِينَ ﴿36﴾

قَالَ لَا يَأْتِيكُمَا طَعَامٌ تُرْزَقَانِهِ إِلَّا نَبَأَكُمَا بِتَأْوِيلِهِ قَبْلَ أَنْ يَأْتِيَكُمَا ذَلِكَمَا مِمَّا

عَلَّمَنِي رَبِّي إِنِّي تَرَكْتُ مِلَّةَ قَوْمٍ لَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَهُمْ بِالْآخِرَةِ هُمْ كَافِرُونَ ﴿37﴾

وَاتَّبَعْتُ مِلَّةَ آبَائِي إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ مَا كَانَ لَنَا أَنْ نُشْرِكَ بِاللَّهِ مِنْ

شَيْءٍ ذَلِكَ مِنْ فَضْلِ اللَّهِ عَلَيْنَا وَعَلَى النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَشْكُرُونَ ﴿38﴾

يَا صَاحِبِي السِّجْنِ أَرْبَابٌ مُتَفَرِّقُونَ خَيْرًا أَمْ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ ﴿39﴾

مَا تَعْبُدُونَ مِنْ دُونِهِ إِلَّا أَسْمَاءُ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ إِنْ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ أَمَرَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿40﴾

يَا صَاحِبِي السَّجْنِ أَمَا أَحَدُكُمْ مَا فَيْسَقِي رَبِّيهِ خَمْرًا وَأَمَّا الْآخِرُ فَيُصَلِّبُ فَتَأْكُلُ الطَّيْرُ مِنْ رَأْسِهِ قُضِيَ الْأَمْرُ الَّذِي فِيهِ تَسْتَفْتِيَانِ ﴿41﴾
وَقَالَ لِلَّذِي ظَنَّ أَنَّهُ نَاجٍ مِنْهُمَا اذْكُرْنِي عِنْدَ رَبِّكَ فَأَنْسَاهُ الشَّيْطَانُ ذِكْرَ رَبِّهِ فَلَبِثَ فِي السَّجْنِ بِضْعَ سِنِينَ ﴿42﴾

وَقَالَ الْمَلِكُ إِنِّي أَرَى سَبْعَ بَقَرَاتٍ سِمَانٍ يَأْكُلُهُنَّ سَبْعٌ عِجَافٌ وَسَبْعٌ سُنبُلَاتٍ خُضْرٍ وَأُخَرَ يَابِسَاتٍ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ الْأَفْتُونِي فِي رُؤْيَايَ إِنْ كُنْتُمْ لِلرُّؤْيَا تَعْبُرُونَ ﴿43﴾

قَالُوا أَضْغَاثُ أَحْلَامٍ وَمَا نَحْنُ بِتَأْوِيلِ الْأَحْلَامِ بِعَالَمِينَ ﴿44﴾
وَقَالَ الَّذِي نَجَا مِنْهُمَا وَادَّكَرَ بَعْدَ أُمَّةٍ أَنَا أُنَبِّئُكُمْ بِتَأْوِيلِهِ فَأَرْسِلُونِ ﴿45﴾
يُوسُفُ أَيُّهَا الصِّدِّيقُ أَفْتِنَا فِي سَبْعِ بَقَرَاتٍ سِمَانٍ يَأْكُلُهُنَّ سَبْعٌ عِجَافٌ وَسَبْعِ سُنبُلَاتٍ خُضْرٍ وَأُخَرَ يَابِسَاتٍ لَعَلِّي أَرْجِعُ إِلَى النَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿46﴾
قَالَ تَزْرَعُونَ سَبْعَ سِنِينَ دَأْبًا فَمَا حَصَدْتُمْ فَذَرُوهُ فِي سُنْبُلِهِ إِلَّا قَلِيلًا مِمَّا تَأْكُلُونَ ﴿47﴾

ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ سَبْعٌ شِدَادٌ يَأْكُلْنَ مَا قَدَّمْتُمْ لَهُنَّ إِلَّا قَلِيلًا مِمَّا تَحْصِنُونَ ﴿48﴾

ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ عَامٌ فِيهِ يُغَاثُ النَّاسُ وَفِيهِ يَعْرِضُونَ ﴿49﴾
وَقَالَ الْمَلِكُ ائْتُونِي بِهِ فَلَمَّا جَاءَهُ الرَّسُولُ قَالَ ارْجِعْ إِلَى رَبِّكَ فَاسْأَلْهُ مَا بَالُ النَّسْوَةِ اللَّاتِي قَطَعْنَ أَيْدِيَهُنَّ إِنَّ رَبِّي بِكَيْدِهِنَّ عَلِيمٌ ﴿50﴾
قَالَ مَا خَطْبُكُنَّ إِذْ رَاوَدْتُنَّ يُوسُفَ عَنْ نَفْسِهِ قُلْنَ حَاشَ لِلَّهِ مَا عَلِمْنَا عَلَيْهِ مِنْ سُوءٍ قَالَتِ امْرَأَةُ الْعَزِيزِ الْآنَ حَصْحَصَ الْحَقُّ أَنَا رَاوَدْتُهُ عَنْ نَفْسِهِ وَإِنَّهُ لَمِنَ الصَّادِقِينَ ﴿51﴾

ذَلِكَ لِيَعْلَمَ أَنِّي لَمْ أَخُنْهُ بِالْغَيْبِ وَأَنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي كَيْدَ الْخَائِنِينَ ﴿52﴾

وَمَا أُبْرئُ نَفْسِي إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي إِنَّ رَبِّي غَفُورٌ
رَحِيمٌ ﴿53﴾

وَقَالَ الْمَلِكُ ائْتُونِي بِهِ أَسْتَخْلِصُهُ لِنَفْسِي فَلَمَّا كَلَّمَهُ قَالَ إِنَّكَ الْيَوْمَ لَدَيْنَا
مَكِينٌ أَمِينٌ ﴿54﴾

قَالَ اجْعَلْنِي عَلَى خَزَائِنِ الْأَرْضِ إِنِّي حَفِيظٌ عَلَيْمُ ﴿55﴾
وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ يَتَّبِعُونَ مِنْهَا حَيْثُ يَشَاءُ نُصِيبُ بِرَحْمَتِنَا مَنْ
نَشَاءُ وَلَا نُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ ﴿56﴾

وَلَأَجْرُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ لِلَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿57﴾
وَجَاءَ إِخْوَةَ يُوسُفَ فَدَخَلُوا عَلَيْهِ فَعَرَفَهُمْ وَهُمْ لَهُ مُنْكَرُونَ ﴿58﴾
وَلَمَّا جَهَّزَهُمْ بِجَهَّازِهِمْ قَالَ ائْتُونِي بِأَخٍ لَكُمْ مِنْ أَبِيكُمْ أَلَا تَرَوْنَ أَنِّي أَوْفِي
الْكَيْلَ وَأَنَا خَيْرُ الْمُنْزِلِينَ ﴿59﴾

فَإِنْ لَمْ تَأْتُونِي بِهِ فَلَا كَيْلَ لَكُمْ عِنْدِي وَلَا تَقْرَبُونِ ﴿60﴾
قَالُوا سُرَّادُودٌ عَنْهُ أَبَاهُ وَإِنَّا لَفَاعِلُونَ ﴿61﴾
وَقَالَ لِفَتْيَانِهِ اجْعَلُوا بِضَاعَتَهُمْ فِي رِحَالِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَعْرِفُونَهَا إِذَا انْقَلَبُوا إِلَى
أَهْلِهِمْ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿62﴾

فَلَمَّا رَجَعُوا إِلَى أَبِيهِمْ قَالُوا يَا أَبَانَا مُنِعَ مِنَّا الْكَيْلُ فَأَرْسِلْ مَعَنَا آخَانًا نَكْتَلُ
وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿63﴾
قَالَ هَلْ أَمْنَكُمْ عَلَيْهِ إِلَّا كَمَا أَمْنْتُكُمْ عَلَى أَخِيهِ مِنْ قَبْلُ فَاللَّهُ خَيْرٌ حَافِظًا
وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ﴿64﴾

وَلَمَّا فَتَحُوا مَتَاعَهُمْ وَجَدُوا بِضَاعَتَهُمْ رُدَّتْ إِلَيْهِمْ قَالُوا يَا أَبَانَا مَا نَبْغِي هَذِهِ
بِضَاعَتُنَا رُدَّتْ إِلَيْنَا وَنَمِيرُ أَهْلَنَا وَنَحْفَظُ أَخَانًا وَتَزِدَادُ كَيْلَ بَعِيرٍ ذَلِكَ كَيْلٌ
يَسِيرٌ ﴿65﴾

قَالَ لَنْ أُرْسِلَهُ مَعَكُمْ حَتَّى تُؤْتُونِ مَوْثِقًا مِنَ اللَّهِ لَتَأْتُنَّنِي بِهِ إِلَّا أَنْ يُحَاطَ بِكُمْ
فَلَمَّا آتَوْهُ مَوْثِقَهُمْ قَالَ اللَّهُ عَلَى مَا نَقُولُ وَكِيلٌ ﴿66﴾

وَقَالَ يَا بَنِيَّ لَا تَدْخُلُوا مِن بَابٍ وَاحِدٍ وَادْخُلُوا مِنْ أَبْوَابٍ مُتَفَرِّقَةٍ وَمَا أُغْنِي
عَنكُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ إِنَّ الْحُكْمَ إِلَّا لِلَّهِ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ
الْمُتَوَكِّلُونَ ﴿67﴾

وَلَمَّا دَخَلُوا مِنْ حَيْثُ أَمَرَهُمْ أَبُوهُمْ مَا كَانَ يُغْنِي عَنْهُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا
حَاجَةٌ فِي نَفْسٍ يَعْقُوبَ قَضَاهَا وَإِنَّهُ لَذُو عِلْمٍ لِمَا عَلَّمْنَاهُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا
يَعْلَمُونَ ﴿68﴾

وَلَمَّا دَخَلُوا عَلَى يُوسُفَ أَوَى إِلَيْهِ أَخَاهُ قَالَ إِنِّي أَنَا أَخُوكَ فَلَا تَبْتَئِسْ بِمَا
كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿69﴾

فَلَمَّا جَهَّزَهُمْ بِجَهَّازِهِمْ جَعَلَ السَّقَايَةَ فِي رِجْلِ أَخِيهِ ثُمَّ أَذَّنَ مُؤَذِّنٌ أَيَّتَهَا الْعِيبُ
إِنَّكُمْ لَسَارِقُونَ ﴿70﴾

قَالُوا وَأَقْبَلُوا عَلَيْهِمْ مَاذَا تَفْقَدُونَ ﴿71﴾

قَالُوا تَفْقَدُ صَوَاعِ الْمَلِكِ وَلِمَنْ جَاءَ بِهِ حِمْلُ بَعِيرٍ وَأَنَا بِهِ زَعِيمٌ ﴿72﴾

قَالُوا تَاللَّهِ لَقَدْ عَلِمْتُمْ مَا جِئْنَا لِنُفْسِدَ فِي الْأَرْضِ وَمَا كُنَّا سَارِقِينَ ﴿73﴾

قَالُوا فَمَا جَزَاؤُهُ إِنْ كُنْتُمْ كَاذِبِينَ ﴿74﴾

قَالُوا جَزَاؤُهُ مَنْ وَجِدَ فِي رِحْلِهِ فهُوَ جَزَاؤُهُ كَذَلِكَ نَجْزِي الظَّالِمِينَ ﴿75﴾

فَبَدَأَ بِأَوْعِيَّتِهِمْ قَبْلَ وِعَاءِ أَخِيهِ ثُمَّ اسْتَخْرَجَهَا مِنْ وِعَاءِ أَخِيهِ كَذَلِكَ كِدْنَا
لِيُوسُفَ مَا كَانَ لِيَأْخُذَ أَخَاهُ فِي دِينِ الْمَلِكِ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ تَرْفَعُ دَرَجَاتٍ مَنْ
نَشَاءُ وَفَوْقَ كُلِّ ذِي عِلْمٍ عَلِيمٌ ﴿76﴾

قَالُوا إِنْ يَسْرِقْ فَقَدْ سَرَقَ أَخٌ لَهُ مِنْ قَبْلُ فَأَسْرَهَا يُوسُفُ فِي نَفْسِهِ وَلَمْ

يُبْدِهَا لَهُمْ قَالَ أَنْتُمْ شَرُّ مَكَانًا وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا تَصِفُونَ ﴿77﴾

قَالُوا يَا أَيُّهَا الْعَزِيزُ إِنَّ لَهُ أَبَا شَيْخًا كَبِيرًا فَخُذْ أَحَدَنَا مَكَانَهُ إِنَّا نَرَاكَ مِنْ

الْمُحْسِنِينَ ﴿78﴾

قَالَ مَعَاذَ اللَّهِ أَنْ نَأْخُذَ إِلَّا مَنْ وَجَدْنَا مَتَاعَنَا عِنْدَهُ إِنَّا إِذًا لظَالِمُونَ ﴿79﴾

فَلَمَّا اسْتَيْسُوا مِنْهُ خَلَصُوا نَجِيًّا قَالَ كَبِيرُهُمْ أَلَمْ تَعْلَمُوا أَنَّ أَبَاكُمْ قَدْ أَخَذَ عَلَيْكُمْ مَوْثِقًا مِنَ اللَّهِ وَمِنْ قَبْلُ مَا فَرَّطْتُمْ فِي يُوسُفَ فَلَنْ أَبْرَحَ الْأَرْضَ حَتَّى يَأْذَنَ لِي أَبِي أَوْ يَحْكُمَ اللَّهُ لِي وَهُوَ خَيْرُ الْحَاكِمِينَ ﴿80﴾

ارْجِعُوا إِلَىٰ أَبِيكُمْ فَقُولُوا يَا أَبَانَا إِنَّ ابْنَكَ سَرَقَ وَمَا شَهِدْنَا إِلَّا بِمَا عَلَّمَنَا وَمَا كُنَّا لِلْغَيْبِ حَافِظِينَ ﴿81﴾

وَأَسْأَلُ الْقَرْيَةَ الَّتِي كُنَّا فِيهَا وَالْعَيْرَ الَّتِي أَقْبَلْنَا فِيهَا وَإِنَّا لَصَادِقُونَ ﴿82﴾
قَالَ بَلْ سَوَّلَتْ لَكُمْ أَنْفُسُكُمْ أَمْرًا فَصَبْرٌ جَمِيلٌ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَنِي بِهِمْ جَمِيعًا إِنَّهُ هُوَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ ﴿83﴾

وَتَوَلَّى عَنْهُمْ وَقَالَ يَا أَسْفَىٰ عَلَىٰ يُوسُفَ وَإِيتَضَتْ عَيْنَاهُ مِنَ الْحُزْنِ فَهُوَ كَظِيمٌ ﴿84﴾

قَالُوا تَاللَّهِ تَفْتَأُ تَذْكُرُ يُوسُفَ حَتَّىٰ تَكُونَ حَرَضًا أَوْ تَكُونَ مِنَ

الْهَالِكِينَ ﴿85﴾

قَالَ إِنَّمَا أَشْكُو بَثِّي وَحُزْنِي إِلَى اللَّهِ وَأَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿86﴾
يَا بَنِي إِدْهَبُوا فَتَحَسَّسُوا مِنْ يُوسُفَ وَأَخِيهِ وَلَا تَيْسَسُوا مِنْ رُوحِ اللَّهِ إِنَّهُ لَا يَنْسُ مِنْ رُوحِ اللَّهِ إِلَّا الْقَوْمَ الْكَافِرُونَ ﴿87﴾

فَلَمَّا دَخَلُوا عَلَيْهِ قَالُوا يَا أَيُّهَا الْعَزِيزُ مَسْنَا وَأَهْلْنَا الضَّرَّ وَجِئْنَا بِبِضَاعَةٍ مُزْجَاةٍ فَأَوْفِ لَنَا الْكَيْلَ وَتَصَدَّقْ عَلَيْنَا إِنَّ اللَّهَ يَجْزِي الْمُتَصَدِّقِينَ ﴿88﴾

قَالَ هَلْ عَلِمْتُمْ مَا فَعَلْتُمْ بِيُوسُفَ وَأَخِيهِ إِذْ أَنْتُمْ جَاهِلُونَ ﴿89﴾
قَالُوا أَنْتَكَ لَأَنْتَ يُوسُفَ قَالَ أَنَا يُوسُفَ وَهَذَا أَخِي قَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَيْنَا إِنَّهُ مَنْ يَتَّقِ وَيَصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ ﴿90﴾

قَالُوا تَاللَّهِ لَقَدْ آثَرَكَ اللَّهُ عَلَيْنَا وَإِنْ كُنَّا لَخَاطِئِينَ ﴿91﴾

قَالَ لَا تَثْرِبَ عَلَيْكُمْ الْيَوْمَ يَغْفِرُ اللَّهُ لَكُمْ وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ ﴿92﴾
إِذْهَبُوا بِقَمِيصِي هَذَا فَالْقُوهُ عَلَىٰ وَجْهِ أَبِي يَأْتِ بَصِيرًا وَأْتُونِي بِأَهْلِكُمْ أَجْمَعِينَ ﴿93﴾

وَلَمَّا فَصَلَتِ الْعَيْرُ قَالَ أَبُوهُمْ إِنِّي لَأَجِدُ رِيحَ يُوسُفَ لَوْلَا أَنْ تُفَنِّدُونِ ﴿94﴾

قَالُوا تَاللَّهِ إِنَّكَ لَفِي ضَلَالِكَ الْقَدِيمِ ﴿95﴾

فَلَمَّا أَنْ جَاءَ الْبَشِيرُ أَلْقَاهُ عَلَىٰ وَجْهِهِ فَارْتَدَّ بَصِيرًا قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لَكُمْ إِنِّي
أَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿96﴾

قَالُوا يَا أَبَانَا اسْتَغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا إِنَّا كُنَّا خَاطِئِينَ ﴿97﴾

قَالَ سَوْفَ أَسْتَغْفِرُ لَكُمْ رَبِّي إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ ﴿98﴾

فَلَمَّا دَخَلُوا عَلَىٰ يُونُسَ أَوَىٰ إِلَيْهِ أَبُوهُ وَقَالَ ادْخُلُوا مِصْرَ إِن شَاءَ اللَّهُ
أَمِينٌ ﴿99﴾

وَرَفَعَ أَبُوهُ عَلَى الْعَرْشِ وَخَرُّوا لَهُ سُجَّدًا وَقَالَ يَا أَبَتِ هَذَا تَأْوِيلُ رُؤْيَايَ مِنْ
قَبْلُ قَدْ جَعَلَهَا رَبِّي حَقًّا وَقَدْ أَحْسَنَ بِي إِذْ أَخْرَجَنِي مِنَ السِّجْنِ وَجَاءَ بِكُمْ مِنَ
الْبَدْوِ مِنْ بَعْدِ أَنْ نَزَغَ الشَّيْطَانُ بَيْنِي وَبَيْنَ إِخْوَتِي إِنَّ رَبِّي لَطِيفٌ لِمَا يَشَاءُ إِنَّهُ هُوَ
الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ ﴿100﴾

رَبِّ قَدْ آتَيْتَنِي مِنَ الْمُلْكِ وَعَلَّمْتَنِي مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ فَاطِرَ السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضِ أَنْتَ وَلِيِّي فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ تَوَفَّنِي مُسْلِمًا وَأَلْحَقْنِي بِالصَّالِحِينَ ﴿101﴾
ذَلِكَ مِنْ أَنْبَاءِ الْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ وَمَا كُنْتَ لَدَيْهِمْ إِذْ أَجْمَعُوا أَمْرَهُمْ وَهُمْ
يَمْكُرُونَ ﴿102﴾

وَمَا أَكْثَرَ النَّاسِ وَلَوْ حَرَصْتَ بِمُؤْمِنِينَ ﴿103﴾

وَمَا تَسْأَلُهُمْ عَلَيْهِ مِنْ أَجْرٍ إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ﴿104﴾

وَكَأَيِّنْ مِنْ آيَةٍ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يَمُرُّونَ عَلَيْهَا وَهُمْ عَنْهَا

مُعْرِضُونَ ﴿105﴾

وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُمْ بِاللَّهِ إِلَّا وَهُمْ مُشْرِكُونَ ﴿106﴾

أَفَأَمِنُوا أَنْ تَأْتِيَهُمْ غَاشِيَةٌ مِنْ عَذَابِ اللَّهِ أَوْ تَأْتِيَهُمُ السَّاعَةُ بَغْتَةً وَهُمْ لَا

يَشْعُرُونَ ﴿107﴾

قُلْ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُو إِلَى اللَّهِ عَلَىٰ بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي وَسُبْحَانَ اللَّهِ وَمَا

أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿108﴾

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ إِلَّا رِجَالًا نُوحِي إِلَيْهِمْ مِنْ أَهْلِ الْقُرَى أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي
الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَدَارُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ لِلَّذِينَ اتَّقَوْا
أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴿109﴾

حَتَّى إِذَا اسْتَيْسَرَ الرُّسُلُ وَظَنُّوا أَنَّهُمْ قَدْ كُذِّبُوا جَاءَهُمْ نَصْرُنَا فَنُجِّيَ مَنْ
نَشَاءُ وَلَا يُرَدُّ بَأْسُنَا عَنِ الْقَوْمِ الْمُجْرِمِينَ ﴿110﴾
لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِأُولِي الْأَلْبَابِ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَى وَلَكِنْ
تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿111﴾

*Përkthimi i sures Jusuf:**

Në emër Të All-llahut, Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Elif, Lam, Ra. Këto janë ajetet e librit të qartë!

2. Pa dyshim Ne e shpallëm si Kur'an në gjuhën arabe, që ta kuptoni!

3. Ne ty të rrëfejme rrëfimet më të bukura duke ta shpallur këtë Kur'an, edhe pse para tij, me të vërtetë, ti nuk ke ditur asgjë.

4. Kur Jusufi i tha babait të vet: 'O babai im!, kam parë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, edhe Diellin, edhe Hënën; dhe i kam parë (në ëndërr) se si më bënëin sexhde mua!

5. Ai (babai) tha: 'O biri im, mos ua rrëfe ëndërrën tënde vëllezërve tu, që mos të ta bëjnë ndonjë të keqe (kurthë); s'ka dyshim se djalli është armik i hapët i njeriut!

6. Por, ashtu Krijuesi yt ty do të zgjedh, dhe me shpjegimin e ëndrrave do të mësojë dhe dhantinë e Tij ty dhe familjes së Jakubit do t'ia plotësojë, ashtu siç ua ka plotësuar më parë dy të parëve tu, Ibrahimit dhe Is'hakut. Krijuesi yt, pa dyshim, është i gjithëdijsëm dhe i urtë.

7. Njëmend te Jusufi dhe vëllezërit e tij ka shenja (mësime) për ata që pyesin.

* Pasi që në përsiatjet tona nuk kemi përkthyer dhe trajtuar të gjitha ajetet e sures Jusuf, këtu po e japim tekstin origjinal të kësaj sureje dhe përkthimin e plotë. Përkthimi është i yni. Janë konsultuar të gjitha përkthimet e theksuara në literaturë.

8. Kur ata (vëllezërit) thanë: “Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashur për babain tonë se sa ne, edhe pse ne jemi një grupim i fuqishëm. Njëmend babai ynë po gabon haptazi.

9. Mbyteni Jusufin apo dëbonie në ndonjë vend të largët, e babai juaj do t’u kthehet juve dhe pas kësaj ju do të bëheni njerëz të mirë.

10. Njëri nga ata tha: “Mos e mbytni Jusufin, por hedhnie në fund të ndonjë bunari, do ta gjejë ndonjë karvan – nëse njëmend dëshironi të bëni diçka me të.”

11. Ata (vëllezërit) thanë: O babai ynë, ç’është me ty që nuk ke besim te ne për Jusufin. Ne pa dyshim jemi nga ata që do ta këshillojmë.

12. Dërgoje nesër me ne që të argëtohet e të luaj, kurse ne, me siguri, do ta ruajmë atë.

13. (Kurse Jakubi) tha: “Do të brengosem nëse e merrni, dhe frikësohem se mos do ta hajë ujku kur ju nuk do të kujdeseni për të.

14. Ata thanë: “Si do ta hajë ujku kur ne jemi grup i fuqishëm! Ne atëherë më mirë mos qofshim!

15. Pasi e morën dhe vendosën ta hedhin në fund të bunarit, Ne i shpallëm atij: “Ti për këtë veprim të tyre do t’i njoftosh, kurse ata ty as nuk do të njohin”.

16. Dhe në mbrëmje ata erdhën te babai i tyre duke qarë.

17. Ata thanë: “O babai ynë, patëm shkuar të garojmë në vrap, kurse Jusufin e lamë të teshat tona, ashtu që atë e hëngri ujku. Ti nuk do të na besosh, edhe pse ne të vërtetën e flasim.”

18. Dhe ia sollën këmishën e tij të njomur me gjak të rrejshëm. Ai tha: “Jo, por epshet tuaja ua zbukuruan punën tuaj, dhe mua më mbetet vetëm durim i mirë. Nga All-llahu kërkoj ndihmë kundër kësaj që ju e përshkruani.

19. Dhe erdhi një karvan, dhe e dërguan ujëmbushësin e tyre që të mbushë ujë me kovë. "Sihariq", bërtiti ai, "ja një djalosh"! Dhe ata e fshehën si mallë tregtar, kurse All-llahu e dinte mirë se ç'bënë ata.

20. Dhe e shitën me një çmim përbuzës, për disa dirhem; mezi pritën që atë ta heqin qafe.

21. Kurse ai njeriu nga Egjipti që e bleu i tha gruas së tij: "Bëni qëndrim të këndshëm! Ndoshta na bëhet i dobi-shëm por edhe mund ta birëzojmë". Ja kështu ne Jusufit në Tokë vend të mirë i dhuruam dhe me shpjegimin e ëndrrave e mësuam – All-llahu ka fuqi ta zbatojë vendimin e Tij, por shumica e njerëzve këtë nuk e dijnë.

22. Dhe kur ai arriti pjekurinë, dhe e pajisëm me urtësi dhe dituri. Ashtu ne i shpërblejmë mirëbërësit.

23. Dhe ajo në shtëpinë e së cilës gjendej ai, filloi ta nxisë atë në mëkat; i mbylli të gjitha dyert dhe i tha: "Eja ti!" Tha ai: "Ruajna Zot!" "Zotëriu im është kujdesur ndaj meje dhe me siguri të padrejtët nuk do të shpëtojnë.

24. Dhe ajo e dëshiroi atë, por edhe ai ate do ta dëshironte sikur të mos e kishte parë dëshminë nga Krijuesi i tij. Dhe kështu nga ai të keqen dhe imoralitetin e mënjanuam, sepse ai me të vërtetë ishte nga robërit tanë të singertë.

25. Dhe ata të dy vrapuan kah dera, kurse ajo nga prapa e grisi këmishën e tij – dhe burrin e saj skajë derës e takuan. Ajo tha: "Çfarë është dënimi për atë i cili dëshiron t'i bëjë keq familjes tënde, (çka) tjetër pos burgosje apo edhe dënim më të dhembshëm.

26. Ai tha: "Ajo mua tentoi të më mashtrojë në mëkat." Një dëshmitar nga familja e saj filloi të dëshmojë: "Nëse këmisha e tij është e grisur nga ana e përparme atëherë ajo fletë të vërtetën, kurse ai të pavërtetën.

27. Por, nëse këmisha e tij është e grisur nga prapa, atëherë ajo gënjen kurse ai fletë të vërtetën.

28. Dhe kur ai e pa se këmisha e tij është e grisur nga prapa, tha: "Kjo është një dredhi e jotja, kurse vërtetë dredhitë tuaja janë të mëdha.

29. Ti, o Jusuf, lëre këtë, kurse ti, i tha asaj, kërko falje për mëkatin tënd, se me vërtetë ti je ajo që ke gabuar.

30. Dhe gratë e qytetit filluan të flasin: "Gruaja e Ministrit ka tentuar ta përvetësojë atë djaloshin e vet, në të është dashuruar tmerrësisht! Njëmend ne e shohim se ajo është në lajthitje të vërtetë!"

31. Dhe kur ajo dëgjoji përgojimet e tyre, i ftoi ato dhe iu përgatiti ndeje (gosti) dhe secilës prej tyre i dha nga një thikë dhe (Jusufit) i tha: "Dil para tyre!"; dhe kur ato e panë atë (Jusufin) u mahnitën nga bukuria e tij dhe nëpër duart e tyre u prenë dhe thanë: "O Zot, o Zot! Ky nuk është njeri, por ky është një engjëll fisnik!

32. Ajo tha: "Ja, kjo është për çka më keni qortuar. Përnjëmend dëshirova ta mashtroj, por ai kundërshtoi, por nëse ai nuk pranon atë që unë e urdhëroi, në burg njëmend do ta hedhi dhe do të jetë ndër të përçmuarit!"

33. Ai tha: "O Zoti im! Më tepër e dëshiroj burgun nga ajo çka më ofrojnë ato. Dhe nëse Ti nuk më largon prej dredhisë së tyre unë mund të ndiej simpati ndaj tyre dhe të bëhem prej injorantëve".

34. Dhe Zoti i tij e pranoi lutjen e tij dhe e shpëtoi nga dredhitë e tyre! Ai pa dyshim dëgjon dhe di shumë.

35. Pastaj u ra ndërmend, edhe pse u bindën se është i pafajshëm, që ta hedhin për një kohë në burg.

36. Me të në burg hynë edhe dy djelmosha; njëri prej tyre dyve i tha: "Kam parë një ëndërr sikur po shtrydhja

verë”, kurse tjetri tha: unë kam parë një ëndërr se isha duke bartur mbi krye një bukë nga e cila hanin shpendët. Na shpjego këtë sepse ne e shohim se ti njëmend je njeri i mirë.”

37. (Jusufi) tha: “Asnjë shujtë e ushqimit nuk do t’u vijë e unë të mos di t’ju them se çka do t’ju sjellin nga ushqimi para se t’ju vijë ai. Kjo është vetëm një pjesë e asaj që më ka mësuar Zoti im. Unë kam flakur fenë e popullit që nuk beson në Zotin dhe i cili mohon Botën tjetër,

38. dhe ndjek fenë e të parëve të mi, Ibrahimit, Is’hakut dhe Jakubit. Neve nuk na ka hije që All-llahut t’i përshkruajmë asnjë rival. Kjo është mirësi e All-llahut për ne dhe për të gjithë njerëzit, por shumica e njerëzve nuk janë mirënjohës.

39. O shokët e mi të burgut!, a janë më të mirë zotat e llojlojshëm apo All-llahu, i vetmi ngadhënjimtar?

40. Çkado që të adhuroni pos All-llahut janë vetëm emra të cilëve ua keni ngjitur ju dhe të parët tuaj. All-llahu për ata kurrfarë dëshmie nuk ka shpallur, kurse gjykimi përfundimtar i përket vetëm All-llahut. Ai ka urdhëruar që ta adhuroni vetëm Atë. Kjo është feja e vetme gjithnjë e mirëfilltë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.

41. O shokët e mi të burgut! Njëri prej jush do t’i japë të pijë verë zotëriut të vet, e tjetri do të jetë i gozhduar, kurse shpendët do të hanë prej kokës së tij. Çështja tashmë është vendosur për atë për të cilën më pyetët ju.

42. Dhe atij nga ata të dy për të cilin mendonte se do të jetë i shpëtuar, (Jusufi) i tha: “Më përkujto mua te zotëriu yt”, mirëpo djalli bëri që ai të harrojë ta përmend te zotëriu i vet dhe ai (Jusufi) mbeti në burg disa vjet.

43. Dhe mbreti tha: "Njëmend kam ëndërruar se shtatë lopë të liga i hanin shtatë lopë të majme, dhe kam ëndërruar shtatë kallinj të blertë dhe po aq të tjerë të tharë. O pari, ma shpjegoni ëndrrën time nëse dini t'i shpjegoni ëndërrat?"

44. Ata thanë: Këto janë ëndërra të ngatërruara. Ne nuk dimë të shpjegojmë ëndërra.

45. Dhe atëherë, pas aq vjetësh, u kujtua njëri nga ata dy, ai që shpëtoi, dhe tha: "Unë për domethënien e ëndërrës do t'ju njoftoj, vetëm më dërgoni mua (te Jusufi)."

46. O Jusuf, o njeri i mirëfilltë, na shpjego ç'do të thotë shtatë lopë të liga i hanin shtatë lopë të majme, dhe shtatë kallinj të blertë dhe po aq të tjerë të tharë, dhe të kthehem te njerëzit që edhe ata ta dinë këtë."

47. Ai (Jusufi) tha: "Do të mbillni shtatë vjet rresht dhe atë që e korrni e lini në kallinj, përveç një pakice që do të hani."

48. Sepse pas asaj do të vijjnë shtatë (vite) të vështira që do ta hanë atë çka keni përgatitur për të, përveç asaj pakice që e keni ruajtur për farë.

49. Pastaj, pas këtyre, do të vij një vit në të cilin njerëzit do të kenë shi me bollëk (beregjet) dhe në të cilin do të shtrydhin (rrush e vaj)."

50. Dhe mbreti tha: "Silleni atë para meje". Dhe kur i erdhi i deleguari këtij (Jusufit), ai tha: "Kthehu te zotëriu yt dhe pyete: ç'u bë me ato gra që i patën pre duart e tyre. Zotëriu im njëmend i di dredhitë e tyre."

51. Ai (sunduesi) tha: "Si qe puna e juaj kur deshët ta mashtroni Jusufin. Ato thanë: "Ruana Zot, ne nuk dijmë gjë të keqe për të." "Tash do të dalë e vërteta në shesh! - tha gruaja e Azizit. Unë jam përpjekur ta mashtroj atë, kurse ai është njëmend prej të sinqertëve."

52. Ashtu, ai le ta dijë, se në mungesë të tij, unë nuk e kam tradhëtuar! Sepse njëmend All-llahu nuk lejon që të sendërtohen dredhitë e mashtruesve.

53. Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (epshi) njëmend ka prirje kah e keqja, përveç atij ndaj të cilit mëshirohet Zotëriu im!(të shiqohet përkthimi) Krijuesi im vërtet fal dhe mëshiron.

54. Dhe sunduesi tha: “Ma sillni mua atë, do ta marrë në suitën time” – dhe pasi bisedoi me të, i tha: Ti prej sot te ne do të jesh i fuqishëm dhe i besueshëm.

55. Ai tha: “Me vendos përgjegjës të depove në vend. Unë vërtet jam i kujdesshëm dhe i ditur.”

56. Dhe kështu ne Jusufin e bëmë të fuqishëm në vend, kudo që të dëshirojë ai. Ne mëshirën tonë ia dhurojmë kujt të dëshirojmë Ne dhe nuk lejojmë të humb shpërblimi për bëmirsit.

57. Kurse shpërblimi në botën tjetër është më i mirë për ata që kanë besuar dhe që ruhen nga mëkatet.

58. Dhe vëllezërit e Jusufit erdhën dhe hynë tek ai; dhe ai i njofti ata por ata nuk e njoftën atë.

59. Dhe pasi i furnizoi me ushqim të nevojshëm, iu tha: “Ma sillni vëllain tuaj nga babai juaj; a nuk shihni se masën e plotë (me ushqim) dhe jam mikëpritësi më i mirë.

60. Nëse nuk ma sillni atë, nuk do të ketë tek unë më ushqim për ju dhe mos ejani te ne.

61. Ata thanë: “Ne do të përpiqemi ta bindim babain e tij që të ndahet nga ai dhe (vëllain) vërtet do ta sjellim.

62. Kurse Jusufi u tha djelmoshave të vet: “Ngarkoni barrët e tyre në kafshët e tyre, e ata kur të kthehen te familjet e tyre, këtë ta dallojnë dhe që të kthehen përsëri.”

63. Dhe kur u kthyen te babai i tyre, ata thanë: “O babai ynë! Nuk do të na jep më ushqim. Për këtë arsye, dërgoje me ne vëllain tonë që të marrim ushqimin tonë, dhe ne pa dyshim do ta ruajmë atë.”

64. Ai tha: “Vallë, t’ua besoj atë ashtu si ua besova qysh më herët vëllain e tij?” “Por, All-llahu është ruajtësi më i mirë dhe Ai është më i mëshirshmi prej më të mëshirshmëve!”

65. E kur i hapën barrët e tyre, dhe gjetën se gjësendet e tyre janë të tyre, ata thanë: “O babai ynë, ç’ dëshirojmë më tepër? Ja, këto janë gjësendet tona, na janë kthyer mbrapa. Dhe me ushqimin do ta furnizojmë familjen tonë dhe vëllain tonë do ta ruajmë dhe një barrë deveje ushqim më tepër do ta fitojmë. Kjo është barrë e parëndësishme.

66. (Jakubi) tha: “Me ju nuk do ta dërgojë deri sa nuk më jepni zotimin tuaj të fortë se me të vërtetë do të ma ktheni prapë, përveç nëse ju nuk pësoni. Dhe pasi ata u zotuan, ai tha: “All-llahu është garantues (vekil) për këtë çka themi.”

67. O bijtë e mi, - tha ai – mos hyni vetëm për një derë, por hyni në dyer të ndryshme! Unë nuk mund t’ju shpëtoj nga ajo që ua cakton All-llahu. Përcaktimi i përket vetëm All-llahut; Atij i mbështetem dhe vetëm në Të le të mbështeten ata që mbështeten!”

68. Dhe kur hynë ashtu siç i kishte urdhëruar babai i tyre, kjo aspak nuk u ndihmoi të kursehen nga ajo që All-llahu ua ka caktuar; fuqia i përket vetëm Atij, por kështu u plotësua dëshira e Jakubit, të cilën ia plotësoi (Zoti). Kurse ai është vërtet dijetar i madh në atë çka e kemi mësuar, mirëpo shumica e njerëzve nuk e dinë.

69. Dhe kur hynë para Jusufit, ai e afroi vëllain e vet dhe i tha: “Unë me të vërtetë jam vëllai yt, dhe mos u dëshpëro për atë që vepruan ata!”

70. Dhe pasi që i furnizoi me ushqim të nevojshëm, në barrën e vëllait të vet e vendosi një gotë dhe pastaj një lajmëtar filloi të bërtiste: "O karavan, ju njëmend qenkeni vjedhës"!

71. Duke u kthyer nga lajmëtari, thanë: "Çka keni humbur!"

72. Thanë: "Kemi humbur gotën e mbretit dhe kush e sjellë ate do ta fitojë një barrë deveje me ushqim. Për këtë unë garantoj.

73. Ata thanë: "Për All-llahun, ju e dini se ne nuk kemi ardhur të bëjmë çrregullim në vend; ne njëmend nuk jemi vjedhës."

74. Thanë: "Çfarë është dënimi nëse nuk flisni të vërtetën?"

75. (Vëllezërit) thanë: "Dënimi për atë, te barra e të cililit gjendet gota, është vetë ai. Kështu ne i dënojmë tiranët."

76. Dhe filloi të kërkojë nëpër thasët e tyre, para thesit të vëllait të vet, e pastaj nxori gotën nga barra e vëllait të tij. Ne e mësuam Jusufin që këtë mashtrim ta bëjë, sepse ai sipas ligjit të mbretit të vet nuk mund ta ndalte si rob vëllain e vet, përveç me dëshirë të All-llahut. Ne e lartësojmë atë që Ne duam, kurse mbi çdo dijetar ka edhe më të Ditur.

77. (Vëllezërit) thanë: "Nëse ka vjedhur, po edhe para vëllai i tij pati vjedhur!" Dhe Jusufi nuk u tha asgjë. "Ju jeni në gjendje më të keqe" mendoi në vete, e All-llahu e di më së miri atë për çka ju flisni (përshkruani)."

78. (Vëllezërit) thanë: "O sundues (Aziz), ai ka një baba shumë të moshuar, ndaj merre ndonjërin prej nesh në vend të tij! Vërtet ne shohim se ti je njeri bamirës.

79. “Zoti na ruajtë”- tha (Jusufi)- “si ta marrim tjetërkend në vend të atij ku i gjetëm gjësendet tona ? Ne atëherë njëmend do të ishim mizorë”!

80. Dhe kur i humbën tëra shpresat, u ndanë anash që të konsultohen. Më i vjetri ndër ata tha: “A nuk e dini se i jeni betuar babait tuaj, por edhe më herët me Jusufin keni gabuar? Nuk e lëshojë dot këtë vend deri sa babai im këtë nuk ma lejon, ose deri sa All-llahu nuk gjykon në favor timin. Kurse Ai është gjykatësi më i mirë.

81. Kthehuni te babai juaj dhe thuani: “O babai ynë, biri yt ka vjedhur; ne pohojmë vetëm atë që kemi parë, dhe ne nuk kemi mund të mbrohemi nga ajo që është e fshehtë.”

82. Ti pyete qytetin në të cilin kemi qenë dhe karvanin me të cilin kemi ardhur. Ne vërtet flasim të vërtetën.

83. (Jakubi) tha: “Jo, por shpirti juaj në këtë u ka shpjeguar, ndaj mua më mbetet durim i mirë. Është për të shpresuar se All-llahu do të m’i kthejë të gjithë. Ai, njëmend, është i gjithëdijshtëm dhe i urtë.

84. Dhe ua ktheu shpinën atyre dhe tha: “O dëshpërimi im (O i mjeri unë) për Jusufin; sytë iu kishin zbardhur prej pikëllimit, ka qenë shumë i dëshpëruar.

85. Ata thanë: “Pasha All-llahun, ti aq e përmend Jusufin sa që është frikë se do të sëmuresh ose do të vdesësh”!

86. “Unë”, tha ai (Jakubi), “pikëllimin tim dhe dhembjen time ia shprehi vetëm All-llahut dhe nga All-llahu di atë që ju nuk dini.”

87. O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni Jusufin dhe vëllain e tij dhe mos e humbni shpresën në mëshirën e All-llahut. Vetëm pabesimtarët e humbin shpresën në mëshirën e All-llahut.”

88. Dhe kur ata dolën para tij (Jusufit), ata thanë: “O Aziz (sundues), neve dhe familjen tonë e ka goditur një fat-

keqësi e madhe, kemi sjellë gjera me vlerë të vogël, por ti na jepë masën e plotë dhe na jep sadaka, sepse All-llahu njëmend i shpërblen ata që ndajnë sadakë.”

89. Ai (Jusufi) u tha: “A e dini se ç’keni bërë me Jusufin dhe vëllain e tij kur keni vepruar si injoratë.”

90. A mos je ti, me të vërtetë, Jusufi!, britën ata. “Po, unë jam Jusufi, kurse ky është vëllai im - u përgjigj. All-llahu na ka mëshiruar neve. Me të vërtetë, kush frikësohet dhe kush bën durim, All-llahu nuk lejon të shkatërrohet shpërblimi për ata që bëjnë vepra të mira.”

91. Ata thanë: “Për All-llahun, All-llahu të ka lartësuar mbi neve, ne me të vërtetë kemi gabuar.!”

92. Ai tha: “Unë tash nuk do t’u qortojë juve, All-llahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi prej mëshiruesve.”

93. Çojeni këtë këmishën time dhe vënia babait tim në fytyrë, atij do t’i vijë shikimi. Dhe ma sillni mua tërë familjen tuaj!”

94. Dhe kur karvani e lëshoi (Egjiptin), babai i tyre tha: “Unë njëmend ndiej aromën e Jusufit, por mos më quani të matufosur.”

95. Ata (familjarët) thanë: “Për All-llahun, ti je njëmend në lajthimin e vjetër.”

96. Por kur erdhi sihariquesi, ia vuri atë (këmishën) mbi fytyrën e tij dhe ai filloi të shohë. “A nuk ju thash, tha (Jakubi), se unë e di nga All-llahu atë çka ju nuk e dini?”

97. Ata (djemtë) thanë: “O babai ynë, lutu që mëkatet tona të na falen. Ne me të vërtetë jemi prej mëkatarëve.”

98. (Jakubi) tha: “Do ta lus (më vonë) Krijuesin tim që t’ua falë. Sepse ai falë dhe është i mëshirshëm.!”

99. Dhe kur hynë te Jusufi, ai i përqafoi prindërit e vet dhe tha: “Hyni në Egjipt, në dashtë All-llahu, të sigurtë.”

100. Dhe ai i vendosi pirndërit e vet në fron dhe ata të gjithë iu përulen atij. Ai tha: "O babai im, ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme. Krijuesi im e sendërtoi atë. All-llahu ka qenë i mirë ndaj meje kur më nxorri nga burgu dhe juve nga shkretëtira ju solli, pasi që shejtani ndërmjet meje dhe vëllezërve pati futur përçarje. Krijuesi im është me të vërtetë i mëshirshëm ndaj atij që dëshiron. Me të vërtetë ai është i dijshtëm dhe i urtë!"

101. O Zoti im, ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar të shpjegoj ëndërrat. O Krijues i qiejve dhe Tokës, Ti je mbrojtësi im edhe në këtë edhe në botën tjetër; Më bëj të vdes mua si musliman dhe më bashko me ata që bëjnë mirë.

102. Ja, këto janë disa lajme të panjohura që ne t'i shpallim ty, dhe ti nuk ke qenë me ata kur vendosën për punën e tyre dhe kur thurën kurtha.

103. Kurse shumica e njerëzve, sado ti të dëshirosh, nuk do të jenë besimtarë!

104. Ti prej tyre nuk kërkon shpërblim për atë (rrëfim); ai është vërejtje për të gjitha botat.

105. Dhe sa e sa shenja ka në qiej dhe tokë pranë të cilëve kalojnë e ata e kthejnë kokën nga ato.

106. Shumica e tyre nuk beson në All-llahun, por ata janë politeistë.

107. A mund të jenë të qetë ata që fatkeqësia, si dënim i All-llahut, nuk do t'i arrijë apo çasti i fundit nuk do t'i befasojë, e që ata këtë nuk do ta vërejnë?!

108. Thuaj: "Kjo është rruga ime, unë ftoj tek All-llahu, duke pasur dëshmi të qarta, unë dhe secili kush më pasion. Dhe vetëm All-llahut i përket tërë lavdia, unë nuk jam nga ata që i përshkruajnë rival Atij!"

109. Dhe ne as përpara teje nuk kemi dërguar përveç njerëz nga banorët e qytetit, të cilëve u shpallëm. A nuk ecin ata nëpër botë e të shohin si kanë përfunduar ata përpara tyre, ndërsa ajo botë është njëmend më e mirë për ata të cilët i frikësohen All-llahut – A nuk po mendoni?

110. Dhe kur pejgamberët thuajse humbnin shpresat dhe mendonin se do t'i shpallnin rrenacakë, u vinte ndihma jonë: Ne i shpëtonim ata që donim, ndërsa dënimi ynë nuk do ta kapërcejë popullin mëkatarë.

111. Në rrëfimet e tyre ka mësim për njerëzit e mençur. Kur'ani nuk është bisedë e trilluar, por është pohim i shpalljes që ishte më parë dhe shpjegim i çdo gjëje, dhe udhërrëfyes e mëshirë për popullin që beson.

VII. Literatura

A. Literatura në gjuhën arabe:

Abdul-baki, Muhamed Fuad, *El-Mu'xhem el-Mufehres li elfadh'il-Kur'an'ul-kerim*, Bejrut, pa vit botimi.

Behxhet, Ahmet, Enbija'ull-llah, Kairo, 1977.

Ed-Damegani, El-Husejn bin Muhamed, *Kamus'ul-Kur'ani ew islah'ul-wuxhuhi we'n-nedhairi fi'l-Kur'an'il-kerim*, Bejrut, botimi III, 1980.

Ed-Dimishkij, *Hafidh Imaduddin Ebi'Fida' Ismail bin Kethir El-Kureshij, Tefsir'ul-Kur'an'il-adhim*, libri IV, botimi II, 1980/1400 h..

El-Eshkar, Muhamed Sulejman Abdullah, *El-Kur'an'ul-kerim we bi'l-hamishi zubdet'ut-tefsiri min feth'il-kadir*, botimi II, Kuvait, 1999/1420 h.

El-Gazali, Shejh Muhamed, *Nahwe tefsirin mewdu'ijjin li suweri'l-Kur'ani'l-kerim*, Botimi I, Daru'sh-shuruk, Bejrut-Kairo, 1414 h./1993.

El-Havarizmij, Ebul-Kasim Xharullah Mahmud Ibn Umer Ez-Zamahsherij, *El-Keshshafu an hakaiki't-tenzili ve ujuni wel-ekavili fi vuxhuhi't-te'vili*, pjesa II, Bejrut, pa vit botimi.

El-Hulejsi, Nevvaf bin Salih, *El-Menhexh'ul-iktisadi fi't-tahtiti li nebijjil-lahi Jusuf alejhis-selam*, Rijad, pa vit botimi.

El-Kurtubi, Ebu Abdullah Muhamed b. Ahmed El-Ensari, *El-Xhamiu li ahkam'il-Kur'an*, libri IX, Bejrut, 1966.

El-Xhelalejn, El-Imamejn, *Tefsir'ul-Kur'ani'l-adhim*, libri I, Kairo, pa vit botimi.

En-Nexhxhar, Abdulvehhab, *Kasas'ul-enbija*, botimi III, Bejrut, pa vit botimi.

Esh-Shafij, Ebu Tahir Muhamed Ibn Jakub El-Fejruzuabadi, *El-Kur'an'ul-kerim we bi hamishihi Tenvir'ul-mikbasi min tefsiri Ibn Abbasi*, botimi I, Katar, 1409/1988.

Es-Sa'dij, Abdurrahman bin Nasir, *Tejsir'ul-kerim'ir-rrahman fi tefsiri kelam'il-mennan*, libri I, botimi IV, Kuvait, 2000/1420 h.

Es-Sabuni, Muhamed Alij, *Safvet'ut-tefasir*, libri II, botimi IV, Bejrut, 1981/1402 h.

Et-Taberij, Ebu Xhafer Muhamed ibn Xherir, *Xhamiu'l-bejani fi tefsiril-Kur'ani*, pjesa VII, Bejrut, 1407/1987.

Halefullah, Muhamed Ahmed, *El-Fennu'ul-kasasi fi'Kur'an'il-kerim*, Kairo, 1965.

Kethir, El-Hafiz 'Imadu'd-din Ebu'l-Fida Isma'il Ibn, *Tefsir'ul-Kur'an'il-adhim*, Damask, 1994, II.

Kutub, Sejjid, *Fi dhilal'il-Kur'an*, libri IV, Bejrut, botimi VIII, 1979/1399 h.

Tabatabaj, Al-lammeh Es-Sejjid Muhamed Husejn, *El-Mizanu fi tefsir'il-Kur'ani*, libri 11, botimi II, Koma, 1972/ 1391 h. (Libri është konsultuar, por nuk kemi marrë asnjë citat).

Tejmijeh, Ahmed Ibn, *Mexhmeu fetava shejh'ul-islam Ahmed Ibn Tejmijeh*, libri XV, Kairo, 1404 h.

B. Literatura në gjuhët joarabe:

Ahmedi, Ismail, *Hafiz Ali Korça - Jeta dhe vepra*, Shkup, 1419-1999.

Ali, Jusuf, *The Holy Qur'an, Text, Translation and Commentary*, Maryland, USA, 1983.

Asad, Muhamed, *Poruka Kur'ana*, Sarajevë, 1425 h./2004.

Beltz, Walter, *Mitologija Kur'ana – Ceznja za rajem*, Zagreb, 1982.

Çami, Muhamed, *Jusufi dhe Zulehaja*, në përgatitje të Ibrahim D. Hoxha, Tiranë, 1992.

El-Gazali, Ebu Hamid, *Ihja ulumid-din*, libri 5, Sarajevë, 2005/1426 h.

El-Gazali, Muhamed, *Tematski tefsir kur'anskih sura*, Sarajevë, 1424 h./2003. (Ky tefsir është botuar nga Logos-A në gjuhën shqipe, të përkthyer nga arabishtja nga Sadush Tahiri me titull: Muhammed El-Gazali, Komentimi Tematik i Kur'anit Famëlartë, Shkup, 2007.)

El-Hashimijj, Abdu-l-Mun'im, *Mu'dzize vjerovjesnika*, Sarajevë, 2003.

En-Nedevi, Ebu-l-Hasan, *Kazivanja o vjerovjesnicima*, Novi Pazar, 2002.

En-Nedevi, *Priče o Božijim Poslanicima*, Tuzla, 1425 h./2004.

En-Nesefij, *Besimi islam sipas Imam En-Nesefiut*, Prizren, 2003.

Es-Sujuti, Đzelaluddin, *Povijest halifa*, Sarajeve, 2003.

Etika u islamu, Zbornik radova Trećeg Simpozija 1410/1990, Zagreb, 1991.

Gazali, Ahmed, *Knjiga o ljubavi*, Sarajevë, 2003/ 1424 h.

Glas islama, List za vjeru, društvo i kulturu, nr. 112, 113, 114/ 2006, Novi Pazar.

Hafiz i Gete, (përmbledhje punimesh nga grup autorësh), Beograd, 2003.

<http://anwary-islam.com/prophet-story/yusuf1.htm>

<http://islam.dzemat.org/modules.php?name=News&file=article&sid=366>.

<http://islam.dzemat.org/modules.php?name=News&file=article&sid=330>.

<http://islam.dzemat.org/modules.php?name=News&file=article&sid=311>.

http://www.seguraweb.nl/1s1/arspoetica_artikujt.php?id=196.

http://www.seguraweb.nl/1s1/arspoetica_artikujt.php?id=197.

http://www.seguraweb.nl/1s1/arspoetica_artikujt.php?id=198.

http://www.seguraweb.nl/1s1/arspoetica_artikujt.php?id=199.

Hysa, Mahmud, *Alamiada shqiptare, I-II*, Shkup, 2000.

Hysa, Mahmud, *Alamiada shqiptare, I-II*, Shkup, 2000.

Ibn Arabi, Muhyi-d-din, *Dragulji Poslaničke Mudrosti – Fusus Al-Hikam*, Zenica, 1995.

Ibn Kethir, *Kazivanja o vjerovjesnicima*, Zenica, 1420/1999.

Ibn Kethir, Tefsir Ibn Kesir, *Skraćeno izdanje...*, Sarajevë, 1423 h./2002.

Ibn Nebi, Malik, *Kur'anski fenomen*, Sarajevë, 1986.

Imam Ebu Hanifeh, *Fikh'ul-ekber*, Prizren, 2005

Imam El-Maturidiu, *Jeta, vepra dhe mësimi*, Prishtinë, 2003.

Ismaili, Adnan, *Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe*, punim magistrature, dorëshkrim, Prishtinë, 2003.

Ismaili, Imam Vehbi, *Historia e pejgamberëve, II*, botim'i parë, Michigan, USA, 1419-1998.

Ismaili, Imam Vehbi, *Jusufi i drejt*, botim'i parë, Michigan, USA, 1415-1994.

Kaleshi, Hasan, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, Prizren, 1411/1991.

Korça, Hafiz Ali, *Historija e shenjtë edhe të katër Halifetë*, Tiranë, 1931.

Korça, Hafiz Ali, *Jusufi me Zelianë a më e bukura e ngjarjeve (ahsen-ul-kasas)*, Elbasan, 1342-1923.

Krasniqi, Milazim, *Soneti në poezinë shqipe*, Prishtinë, 2005.

Kur'an Časni - prevod i tumač, Preveli i sredili Hafiz Muhamed Pandza i Đzemaluddin Čausevic, Sarajevë, 1937.

Kur'an s prijevodom znacenja na bosanski jezik, përktheu Besim Korkut, Rijad, pa vit botimi.

Kur'an s prijevodom značenja na bosanski jezik, preveo Besim Korkut, Arabia saudite, pa vit botimi.

Kur'an sa prijevodom na bosanski jezik, preveo Enes Karič, Sarajevë, 1995.

Kur'an-i - perkthim me komentim në gjuhën shqipe, përkthyes: Sherif Ahmeti, Medinë, 1413 h.

Kur'ani dhe hija e tij, përktheu: Feti Mehdiu, botimi II, Shkup-Stamboll, 1999.

Kur'ani i madhëruar, përktheu Hasan I. Nahi, Prishtinë, 1988.

Kutub, Sejjid, *Ilustrimi artistik në Kur'an*, Shkup, 2001/1421.

Latič, Đzemaludin, *Stil kur'anskoga izraza*, Sarajevë, 2001.

M. A. Kovač: <http://islam.dzemat.org/modules.php?name=News&file=article&sid=366>.

Mahmud, Mustafa, *Dialog me mikun ateist*, Prizren, 2000

Muftič, Teufik, *Arapsko-srpskohrvatski jezik*, I, Sarajevë, 1973.

Myderrizi, Osman, *Tekstet e Vjetra Shqip me Alfabetin Arab*, Tiranë, 1965.

Prijevod Kur'ana sa tefsirrom i komentarom na bosanskom jeziku, përkthimi i Ramo Atajič, libri 3, Munchen, 2001.

Qazimi, Qazim, *Jeta dhe vepra letrare e Muhamed Camit*, Prishtinë, 2002.

Qutb, Sayyid, *U okrilju Kur'ana*, libri XII dhe XIII, Sarajevë, 1998.

Ramič, Jusuf, *Povodi Objave Kur'ana*, Sarajevë, 1984.

Saadiu, *Gjulistani dhe Bostani*, Tiranë, 2003.

Salihu, Hajdar, *Poezia e bejtexhinjve*, Prishtinë, 1987.

Schimmel, Annemarie, *Odgonetanje Božijih znakova - Fenomenološki pristup islamu*, Sarajevë, 2001.

Sharofi, Haki, *Edukata fetare e morale*, pjesa IV, Tiranë, 1939.

Shpjegimi i kuptimeve të Kur'anit të lartë në gjuhën shqipe, përkthyesi i panjohur, Riadi, Arabia Saudite, pa vit botimi.

Spahič, Mustafa, *Povijest islama*, Travnik, 1997.

Suvejdan, Tarik, *Vjerovjesnici i njihovi narodi* (Kasas'ul-enbija', 1997), Zivinice, 2003.

Tefsir Ibn Kesir – Version i shkurtuar në gjuhën boshnjake, botimi II, Sarajevë, 2002/1423 h..

Topbash, Osman Nuri, *Vargu i profetëve në dritën e Kur'anit*, libri 2, Stamboll, 2001.

Yahja, Harun, *Jusuf a.s.*, Sarajevë, 2004.

VIII. Treguesi i emrave

- A**
 Abdulvehhab En-Nexhari, 30
 Abisinia, 45
 Ademi, 103
 Aishja r.a, 38
 All-llahu, 7, 10, 14-6, 18-1, 24-5,
 29, 37, 43-4, 46, 48, 51, 53, 56,
 58, 60-5, 67-8, 70, 73-5, 78,
 82-4, 88-99, 101, 104-10,
 134-6, 138, 140-5
 Attari, 114, 117
 Azizi, 45, 80, 81, 89, 94, 111, 139,
 142-3
- B**
 Bejheki, 28
 Belkis, 98
 Benjamini, 32, 39, 71, 83, 85-93,
 110, 123
 Bizanti, 45
 Buhariu, 28-9, 74
- Ç**
 Çajupi, 117
- D**
 Danteja, 114
- Dh**
 Dhiata e vjetër dhe dhjata e re,
 103
- E**
 Ebu Abbas Ibn Tejmije, 75
 Ebu Talibi, 18, 68
 Egjipti, 24, 39, 41, 43, 45, 62, 67,
 71, 75-6, 78, 81, 83-5, 93, 95-6,
 98-101, 104-5, 121-3, 136, 144
 Ejubi a.s., 20
 el-Maverdi, 38, 75
 el-Mewdudi, 51, 65
 Enes Kariq, 24
 Enesi r.a., 98
 Er-Rejjan El-Velid, 67
- F**
 Firdevsi, 114, 117
- G**
 Gëte, 114
- H**
 Hafiz Ali Korça, 117-8
 Haki Sharofi, 117
 Harun Jahja, 99
 Hasan Kaleshi, 113
 Hatixhja r. a, 18
 Hazreti Aliu r.a., 53
- I**
 Ibn Abbasi, 17, 19, 45, 52, 54, 60,
 62, 91, 95, 99, 114
 Ibn Arebiu, 114
 Ibn Hibbani, 38
 Ibn Isa'it, 89
 Ibn Kethiri, 19, 48, 75, 98, 114
 Ibn Mes'udi, 99
 Ibn Shexhereti, 89
 Ibn Xheriri, 17
 Ibn Xhevziu, 114

- Ibrahimi a.s., 20, 25, 31, 63, 76, 95, 133, 137
 Imam Vehbi Ismaili, 9, 37, 79, 118
 Is'haku a.s., 25-6, 31, 63, 76, 95, 133, 137
 Isai a.s., 20, 103
 Isak Ahmeti, 113
 Ismail Kadare, 113
- J**
 Jahja bej Dukagjini, 116
 Jakubi a.s., 14-5, 18, 25-6, 29, 31-7, 39-40, 44, 54, 63, 71, 76, 78, 80, 82-3, 85, 88, 90-3, 95-101, 110-1, 120, 122-4, 134-5, 138, 141, 143-4
 Jemeni, 45
 Jerusalemi, 37
 Josipi, 120-3
 Jusufi a.s., 7, 9, 11, 13-5, 17-9, 21-5, 27, 29, 31-2, 34, 37, 39-41, 43-4, 46-8, 50-3, 55-65, 67-9, 73-6, 78-80, 82-3, 85-9, 91-4, 96-102, 104-8, 110-2, 114-8, 120-2, 124, 134-40, 143
- K**
 Katade, 17, 85
 Këmisha e vërtetë e Jusufit, 97
 Kenani, 80, 92
 Kur'ani, 7-9, 13, 17-9, 21-2, 23, 30, 36-7, 43-5, 50-1, 53, 58, 61, 64, 68, 76, 78, 87, 89, 91, 102-3, 106, 108, 113-4, 116-8, 121-2, 134, 146
 Kurtubiu, 17, 19, 22, 24, 28-30, 33, 35-6, 39, 45, 49, 50-1, 53-4, 61, 66-8, 74-5, 77-8, 84, 89-91, 95, 98, 101
- M**
 M. A. Halefullahi, 24
 Mahlufi, 54, 75, 101
 malajët, 114
 Maverdi, 38
 Medina, 18
 Meka, 11, 17
 Meliku'l-Ekber Er-Rejjan El-Velid, 67
 Memfis, 45
 Ministri, 38, 48-9, 50, 55-7, 60, 74-5, 83, 95, 111, 137
 Muhamed Asadi, 14
 Muhamed Kuçuk Çami, 117
 Muhammed a.s., 7, 13, 17-9, 24, 28-9, 59, 74, 78, 102
 Musai a.s., 70
 Muslimi, 28-9
- O**
 Omeri r.a., 70
 Osman Myderrizi, 113
- P**
 Palestina, 80
 Pejgamberi, 13, 15, 18-9, 22, 24-5, 27-8, 30, 35, 43, 51-2, 54, 70, 92, 103, 106-7, 110, 116, 118, 122, 146
 persianët, 114, 116
- Q**
 Qytetërimi i Arabisë, 102
- R**
 Raziu, 23, 114
 Rejjan bin Velidi, 45
 Resulullahu, s.a.v.s., 28
 Rubeli, 36
- S**
 S. Kutbi, 48, 114
 Sabuni, 24

Sadiu, 114

Sari, 70

Siria, 45

Suhejli, 45

Sulejmani a.s., 20, 98

Sunneti, 51

T

T. Suvejdani, 22

Taberiu, 38, 114

Tefsiri i Rraziut, 17

U

urdët, 114

V

vëllezërit e Jusufit, 9, 13,

17-8, 23, 26, 27, 29-32, 34-7,

39, 40, 44, 71, 78-9, 88-9, 93-4,

96, 99-101, 110, 123, 134, 145

Xh

Xhamiu, 114, 117

Xhibrili, 54, 66-7

Z

Zamahsheriu, 58, 114

Zoti, 53, 59, 61, 63, 70, 80, 84,

102-3, 105, 107-8, 110, 121-2,

137, 141-2, 145

Zulejha, 45-6, 48, 52-6, 58, 75,

111, 114-8



Copyright©Logos-A, 2008

www.logos-a.com.mk



الر - elif-lam-ra

"Ne ty të rrëfejmë rrëfimet më të bukura duke ta shpallur këtë Kur'an, edhe pse para tij, me të vërtetë, ti nuk ke ditur asgjë." (12, 3).

Kur'ani është fjalë e All-llahut të madhëruar, i dërguar si udhëzues absolut për njerëzit. Në të gjenden udhëzimet dhe përgëzimet më të mira, qortimet dhe shtegdaljet më të drejta. Kur'ani është fjalë e All-llahut të madhëruar që së pari duhet të lexohet, për ajetet e tij të meditohet dhe të studiohet, dhe sipas tyre të veprohet. Çdo ajet, çdo sure është përplotë urtësi, përplotë margaritarë, që presin mendjen e njeriut dhe njëmendësimin e tij.

Nga një anë, Kur'ani duke shtruar pjesë nga fjalët dhe jeta e të dërguarve të All-llahut gjatë historisë, ofron urtësi dhe rrugë si të kuptohet e kaluara, si të jetohet e tashmja dhe si të mësohet për të ardhmen. Një nga këta të dërguar është edhe Jusufi a.s. dhe jeta, meditimi, misioni dhe vepra e tij. Shembulli i Jusufit a.s. është një univers në vete, perlë e mirëfilltë qo do të rrezatojë gjatë tërë historisë njerëzore. Nga ana tjetër, edhe perëndimorët pajtohen se kriza epokale e kohës së re dhe moderne ka filluar me shkretërimin metafizik, me redukimin e njohjes së njeriut në shkallën më të ultë, me zbritjen e supra-unit në ultësi të unit. Si datë merret epoka e renesansës, e cila edhe pse celebrrohet si epokë e orientimit drejt vetëvetes, paralajmëron "vdekjen e shumë gjerave". Në këtë periudhë filluan të zhduken dituritë tradicionale të Mesjetës, kurse galeritë të zëvendësojnë tempujt. Njeriu që me shekuj ka luftuar të lirohet nga autoriteti i të gjitha llojeve, në agimin e renesansës u rrënqeth nga frika prej lirisë individuale, që e arriti në turma drunjësh.

Kaptina Jusuf dhe pastërtia morale e personalitetit të Jusufit a.s. është shembulli më i mirë praktik dhe oferta më përmbajtësore për dalje nga kriza.

